



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Studime Psikosociale”

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Dr. Eris Dhamo Greca

Dr. Ortenca Kotherja

Nëntor/ 2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në “Studime Psikosociale”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Studime Psikosociale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr.409, datë 27.07.2016
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr 376, datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.61, datë 05.07.2019 ndryshuar me VBA Nr. 61/1 datë 05.10.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike, 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023 15 / 5 Viti akademik 2021-2022 14 / 4 Viti akademik 2020-2021 16 / 4
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 37 studentë; Viti akademik 2021-2022 53 studentë; Viti akademik 2020-2021 52 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit BSc “Studime Psikosociale” është një program studimi, i cili ofrohet prej vitit 2016 dhe ka si qëllim kompletimin e studentëve me kompetenca profesionale dhe personale, me njohuri dhe aftësi në orientime të ndryshme të fushës psiko-sociale, organizacionale, komunitare, etj. Vizioni i institucionit ku ofrohet ky program është krijimi i një programi të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron vlera qytetare dhe profesionalizëm nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor si dhe të përgatisë qytetarë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv. Kjo perspektivë e programit të studimit krijon mundësinë që studentët të jenë të orientuar sa më qartë në përzgjedhjen e rrugëtimit të tyre profesional si brenda dhe jashtë vendit. Ky program studimi është program i studimeve të ciklit të parë të studimeve universitare, i nivelit 6 të studimeve të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, me studime me kohë të plotë, me 180 kredite, duke formuar Psikologë dhe Sociologë të përgjithshëm. Njësia akademike që e ofron atë është njësia kryesore: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, si pjesë e institucionit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe njësia bazë është Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë. Kjo kurrikul kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin Shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen. Objektivi bazë i këtij programi studimi është pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e psikologjisë dhe në fusha të tjera sociale që e mbështesin dhe e plotësojnë atë duke ofruar kompetenca teorike dhe praktike në përputhje me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri dhe më gjërë.

Misioni i programit të studimeve të ciklit të parë “Bachelor”, “Studime Psikosociale” është: të ofrojë veprimtari krijuese në fushën e psikologjisë, shkencave sociale dhe politike që realizojnë synimet e tyre profesionale si brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë. Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet si brenda dhe jashtë vendit, formimin e studentëve të rinj në fushat e sipër përmendura nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore si në aspektin metodik e teorik. Gjithashtu thellimin e kualifikimit profesional, shkencor të specialistëve, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në profilizimin gjithnjë e më të dallueshëm e profesional të profesionit të psikologut në shoqërinë shqiptare.

Ky program studimi i nënshtrohet procesit të vlerësimit për akreditim për herë të dytë, i cili bazohet në dy grupe lëndësh të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Studime Psikosociale” për vitin akademik 2022 – 2023 është 37 studentë *(të dhëna të mara nga sekretaria mësimore)*




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Vlerësimi për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Studime Psikosociale”, identifikimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”¹, si dhe në përputhje me Vendimin Nr. 825, datë 24.12.2021 “Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017”, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”². Për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit “Bachelor”, “Studime Psikosociale” ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane të Universitetit Mesdhetar të Tiranës. ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit, **Dr. Eris Dharmo dhe Dr. Ortenca Kotherja**. Gjatë procesin të vlerësimit të jashtëm grupi i ekspertëve është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Anilda Beqiraj. Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm i zhvilluar në 2019, dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit “Bachelor” “Studime Psikosociale”, gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në data 8-9 shkurt 2024. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht Univeristetit Mesdhetar të Tiranës sipas parashikimeve të akteve rregullatorë të ASCAL. Gjatë vizitës dy ditore (8-9 shkurt 2024) në Univeristetin Mesdhetar të Shqipërisë u mbajtën takime me drejtuesin e njësive kryesore dhe drejtuesin e njësive bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, Sigurimit të brendshëm të cilësisë, me përfaqësues të Drejtorisë së kooordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, me përfaqësues të Drejtorisë së burimeve njerëzore, gjithashtu u zhvilluan vizita në mjedise të UMSH-së, FDSHH-së, si dhe në biblioteka, mjedise studimi, auditore, laboratorë, dhe në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj. GVJ ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme RVB-në dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përpara vizitave në institucion në mënyrë që të zhvillonte një takim të mirëinformuar paraprakisht me aktorët e programit të studimit. Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, Tiranë, MASR, publikun e gjerë dhe studentët e programit të studimit të ciklit të

¹ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJ1802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJ1802015+PER+ARSIMIN+E+LARTEDHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-09-2023).

² Vendimi Nr. 825, datë 24.12.2021 Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-825-date-24-12-2021-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-vendimin-nr-109-date-15-2-2017-te-keshillit-te-ministrave-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-agjencise-se-sigurimit-te-cil-2/>. (Aksesuar më 09-09-2023).



parë, bachelor “Studime Psikosociale” mbi përmbushjen e standardeve. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë pikat e forta të tyre duke bërë të mundur fokusimin mbi to për një zhvillim cilësor dhe me standarta konform aspektit profesional dhe tregut të punës si dhe standarteve përkatëse.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 61, datë 05.07.2019:

- 1) Institucioni të ndërmarë një studim tregu për të evidentuar nevojat e tregut të punës në profilin e Psikologut;
- 2) Institucioni të rrisë përfshirjen e studentëve të këtij programi studime në programe mobiliteti;
- 3) Institucioni të bëjë përpjekje për rritjen e numrit të bashkëpunimit për këtë program studimi;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për rekomandimin e parë, në vlerësimin e përmbushjes së shkallës për evidentimin e nevojave të tregut GVJ hulumtoi mbi këto komponentë:

- a) dokumentacionin e dërguar;
- b) përshkrimin e dhënë nga anëtarët e departamentit në RVB;
- c) takimit gjatë vizitës në institucion me anëtarët e grupit të RVB-së;

Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë ka kryer një analizë mbi tregun³ e punës duke analizuar të dhënat e INSTAT. Ato theksojnë se nisur nga këto të dhëna shihet se regjistrimi i studentëve në Shkencat Sociale ka pësuar rënie kjo bazuar në dy komponentë a) migrimin dhe b) plakjen e popullsisë. Por sipas anëtarëve të RVB-së interesi për Mirëqënien Psiko-Sociale është në nivel të lartë dhe nëse do kishte investim dhe zhvillim të politikave në këtë aspekt psikologjia si pjesë e shërbimeve Psikosocial do të çonte që interesi për profilin psikologjik do të ishte në rritje dhe kjo do të ccojë dhe në rritjen numrit të studentëve. Një element tjetër që ato analizojnë me tregun e punës është paga mujore ku sipas tyre për këtë profesion duke qënë se është një profesion i rregulluar synohet të jetë në rritje kjo sipas të dhënave nga INSTAT. Nga vlerësimi i kryer *GVJ* sygjeron se analiza e Tregut të Punës e kryer nga Departamenti Psikologjisë-Sociologjisë është zhvilluar në mënyrë të pjeshme pasi nuk ka kryer një analizë të bazuar mbi instrumente të aplikuar në terren për të dhënë një informacion më plotë dhe analizues. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

³ Evidencë 14 : Analiza e Tregut të Punës



Për rekomandimin e dytë, nga analiza e kryer nga GVJ mbi përmbushjen e shkallës së rekomandimit mbi përfshirjen e studentëve në programe mobiliteti nga dokumentacioni i dërguar, takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion dhe përshkrimi i punës në RVB-së, Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë thekson se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka në strategjinë e tij të Ndërkombëtarizimit⁴ si dhe të përkrahjes së bashkëpunimit me partnerë të tjerë në mbarë botën. Në lidhje me këtë komponent Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë zë një vënd të rëndësishëm në mobilitetin e pedagogëve, studentëve për t'i dhënë mundësi atyre për t'u pasuruar në aspektin profesional nëpërmjet trajnimeve apo dhënies në mësim duke lëvizur me Erasmus+. Në përshkrimin e tyre ato japin një sërë Universitetesh në të cilën studentët, pedagogët kryejnë dhe mund të kryejnë bashkëpunime, trajnime, dhënie mësimi nëpërmjet Erasmus+. Nga vlerësimi i kryer GVJ sygjeron se analiza e kryer nga Departamenti Psikologjisë-Sociologjisë është zhvilluar në mënyrë të detajuar dhe në pasqyrimin e dokumentacionit si listën e bashkëpunimeve⁵, listën e lëvizjeve të studentëve, pedagogëve⁶ shihet se niveli bashkëpunimit⁷ është rritur. Nga biseda me studentët u theksua fakti që dëshira dhe interesi është i madh kjo falë informimit të vazhdueshëm që marin nga Institucioni, departamenti. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.


Për rekomandimin e tretë, analiza e kryer nga GVJ mbi përmbushjen e shkallës së rekomandimit mbi përpjekjen për rritjen e numrit të bashkëpunimit për programin e studimit Bachelor në: "Studime Psikosociale", u fokusua në dokumentacionin e dërguar, takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion dhe përshkrimin e punës me anëtarët e RVB-së dhe me strukturat përkatëse. Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë thekson se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë falë bashkëpunimeve me Universitet homologe, institucionet private-jopriate, OJF-të, në nivel univeriteti shërbejnë institucionit dhe këtij programi studimi. Pra në këtë aspekt vlen të theksohet se në arritjen e këtyre objektivave është rritur numri bashkëpunimit jo vetëm me Universitete por edhe me institucione dhe OJF, kjo jo vetëm në nivel Universiteti por edhe vetë Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin profesional jo vetëm të pedagogëve por dhe studentëve. Ato theksojnë se kanë arritur të lidhin bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut të Shqipërisë në kuadër të zhvillimit të një sërë aktiviteteve. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.

⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/148/nderkombetarizimi>

⁵ Evidencë 10: Lista e bashkëpunimeve

⁶ 2: Dokumenta që japin numrin e lëvizjes së studentëve dhe pedagogëve

⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe>



GVJ shqyrtoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më poshtë po rendisim sqarimet tona për komentet e bëra prej institucionit.

1. Lidhur me komentin për shkallën e përmbushjes së rekomandimeve akreditimi i fundit, RVJ fq. 5/118, GVJ rishqyrtoi raportin në lidhje me rekomandimin e tretë bazuar në realizimin e tregut të punës, ku rithekson se në analizën e kryer nga stafi departamentit të programit “Studime Psiko-Sociale” dhe në komunikim verbal jepet e realizuar në mënyrë të detajuar, ku këto të dhëna janë të referuara nga INSTAT apo dhe nga “Plani i Veprimit për zhvillimin e Shërbimve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013-2022”, ndërsa në dokumentacion e DVV dhe në vizitën në institucion vërehet një analizë e tillë e pasqyruar por ka mungesë të shifrave konkrete të punësimit të studentëve mbi këtë program studimi edhe pse është theksuar fakti që mbahen kontakte me studentët e diplomuar. GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.

2. Lidhur me komentin për standartin 1.2, kriteri 3, Grupi i vlerësimit të jashtëm rishqyrtoi raportin e vlerësimit të jashtëm, duke e konsideruar pasqyrimin e listës së institucioneve specifike në të cilën zhvillojnë praktikat profesionale studentët e studimit Bachelor “Studime Psiko-Sociale” të pa specifikuar duke dhënë vetëm një udhëzues të punës si dhe një listë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të përgjithshme dhe jo të specifikuar konkretisht për studentet e këtij program studimi. Sqarohet se për programet Bachelor parashikohet që orët e praktikës të zhvillohen në auditor. GVJ, edhe në referencë të kuadrit ligjor ju kujton se VKM 41, datë 24.1.2018, gërma f, citoj “Praktikë”, një veprimtari formuese akademike, që vlerësohet me vlerësim pozitiv ose edhe me notë kaluese e me kredite, gjatë së cilës studentit i kërkohet të zgjerojë dhe të aplikojë njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisi praktik profesional ose artistik, në kuadër të një programi të caktuar studimi, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore, ndaj dhe kërkesa për vendosjen e studentit në një mjedis praktik profesional është mëse e përligjur dhe listimi i institucioneve të cilat plotësojnë standardet është një garanci për formimin akademik të studentëve. GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.

3. Lidhur me komentin për “Konkluzionet” e standardit 1.2, mbi mungesën e mobilitetit të studentëve për programin e studimit Bachelor “Studime Psiko-Sociale”.




GVJ pas rishqyrtimit të RVB-së, duke konsideruar dokumentin shtesë si dhe numrin e studentëve që ndjekin mobilitetin dhe komunikimit verbal nga stafi dhe studentët e Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit, merr në konsideratë objeksionin e institucionit.

GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.

4. **Lidhur me komentin për standardin 11.2, kriteri 2,** Grupi i vlerësimit të jashtëm rishqyrtoi raportin e vlerësimit të jashtëm në lidhje me standartin duke sjellë në vëmendje se GVJ është shprehur mbi këtë standart bazuar në emërtimin e programit mësimor “Studime Psikosociale”, ku në këtë program rezulton se % më e madhe e lëndëve është në aspektin psikologjik, duke lënë me përqindje më të ulët aspektin sociologjik dhe aspekte të tjera të ngjashme, kjo duke u bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion. Ky program studimi ka si qëllim formimin e specialistëve në fushën e studimeve psikologjike dhe sociale, të aftë për të punuar në sektorin publik dhe privat si: specialistë të psikologjisë dhe sociologjisë. Bazuar në sa më sipër dhe në emërtimin e programit të studimit shihet me rëndësi krijimi i një balance të lëndëve ndërmjet dy disiplinave ndonëse krahas njohurive në disiplinën karakterizuese të studimit ju ofrohen dije dhe kompetenca edhe në disiplina të përafërta. Në lidhje me emërtimin GVJ niset mbi % e lëndëve që ka ky program studimi. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

5. **Lidhur me komentin për standardin 11.3, kriteri 4,** GVJ ka arritur në këtë konkluzion bazuar, në analizën e bërë mbi bazën e evidencave të përcjella dhe përmbajtjes së tyre, duke konkluduar mbi rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

6. **Lidhur me komentin për standardin 11.4, kriteri 2,** dhe konkluzionin e përgjithshëm për këtë standard për një angazhim më të madh institucional, në drejtim të përmirësimit të kurrikulës së programit të studimit në linjë me standartet e cilësisë apo dhe rishikimin e njësive që përmbajtja e programit të studimit ka për të krijuar kushtet për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të nevojshme në linjë me profilin e psikologjisë, GVJ bazohet në dokumentacionet e vëna në dispozicion si CV-të dhe programin mësimor bazuar në % e lëndëve dhe peshën që zë secila disiplinë si dhe në përditësimin e kurrikulës bazuar në emërtimin që ka



programi. Referuar objeksioneve sjellim në vemendje se për lëndë të tilla si “Hyrje në Filozofi⁸”, ku titullar lënde nuk është kategoria profesor por Dr.A.C; në lëndën “Bazat biologjike të sjelljes”, sesioni IV Temat e lëndës, ku duhet të prezantohen temat me jo më pak se një paragraf sipas javëve dhe të shoqëruar me literaturën përkatëse, kjo nuk evidentohet në syllabus⁹; për lëndën “Hyrje në Sociologji” ju evidentoni si titullar lënde Msc.N.M., gjë e cila është totalisht e papranueshme dhe për më tepër literatura bazë e detyruar është “Sociologjia” e vitit 2007: për lëndën “Sjellje organizative”, titullar lënde rezulton sërish të jetë V.R. PhD, e cila gjithashtu nuk i përket kategorisë profesor, temat e lëndës nuk shoqërohen me paragraf sqarues dhe për më tepër literatura bazë e detyruar është sërish e vjetëruar (2011). Për sa më sipër por dhe për shumë raste të tjera të pacituara GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

7. **Lidhur me komentën për rubrikën “Konkluzione” standardi 11.4**, GVJ e vlerëson bashkëpunimin me Urdhrin e Psikologut të Shqipërisë dhe marrëveshjet me institucion. Në kuadër të këtij bashkëpunimi dhe të standardeve të cilat kërkon ky profesion dhe ky program studimi ka ardhur dhe ky sygjërim mbi balancimin e lëndëve ndërmjet disiplinave dhe përditësimin e syllabuseve. Vlerësimi në raport i GVJ-së reflekton faktin se Lëndët bazë të formimit të përgjithshëm dhe ato karakterizuese të formimit specifik duhet të kenë qëllime dhe aftësi të dedikuara specifikisht profesionisteve psiko-social dhe lëndët të kenë përmbajtje të cilat ju përkasin thellësisht këtyre disiplinave, duke orientuar përherë balancën psiko-sociale. Referuar planit mësimor¹⁰, Disiplina B nga 13 lëndë gjithsej vetëm 2 mund të cilësohen sociale. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

8. **Lidhur me komentën për rubrikën “Konkluzione”. standardi 11.5**, GVJ këtij konstatimi i referohet përmirësimit të vijueshëm të cilësisë dhe standardeve. Në këto kushte sygjerojmë që praktika aktuale të rishikohet dhe të sanksionohet në rregulloren e programit mënyra e miratimit dhe e formulimit të syllabuseve në mënyrë që të mos ketë as përsëritje temash dhe as aspekte të profilin psiko-social të paelaboruara dhe sigurisht të përmbushen dhe kriteret ligjore. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

⁸ Evidenca 13.2. Syllabuse 2.pdf

⁹ Evidenca 13.2. Syllabuse 2.pdf, fq. 13

¹⁰ Evidenca 13 dhe 13.1 Plani mesimor SPS.pdf



9. Lidhur me komentën për standardin III.1 kriteret 1 dhe 2, GVJ-bazuar në rishikimin e programit të Studimit, syllabuseve apo në rregulloren e departamentit evidenton elementë përshkrues mbi ecurinë e realizimit të mënyrës së vlerësimit të studentëve mbi lëndën si dhe punën aktivizuese të studentëve, format e realizimit të mësimdhënies dhe vlerësimi i studentëve edhe mbi provimeve të ndërmjetme midis temave duke bërë të mundur rifreskimin e njohurive dhe njohjen më të mirë të saj.


Bazur në këto argumenta GVJ konkludon se raporti ndryshon.

10. Lidhur me komentën për standardin III.1, kriteri 4, Objeksionet e IAL-së për këtë pikë mungojnë, ndaj **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

11. Lidhur me komentën për standardin III.2, kriteri 2, GVJ pas rishikimit të rregullores së programit, hartimit të syllabuseve konkludoi se vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë sistematike duke i dhënë mundësi mbi ripërsëritjen e informacionit dhe qartësimin dhe kuptimin e herëpashershme të tij nga studenti duke bërë të mundur rritjen dhe mbajtjen mënd të informacionit në mënyrën më të mirë të mundshme. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**

12. Lidhur me komentën për standardin III.3 kriteri 3, GVJ-gjatë rishikimit të dokumentacioneve të vëna në dispozicion dhe reflektimit të bisedave me stafin gjatë vizitës në institucion arrin në konkluzionin se kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave si dhe në rregulloren e programit të studimit apo në Statut vërehen elementë apo ngritje të komisioneve mbi survejimin e provimeve. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**

13. Lidhur me komentën për standardin III.4, rubrika “Konkluzione” Objeksionet e IAL-së për këtë pikë mungojnë, ndaj **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**



14. **Lidhur me komentën për standardin III.5 kriteri 3, dhe rubrikën ‘Konkluzione’**, GVJ duke rishqyrtuar dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe dokumentat shtesë vë re se ka specifika mbi procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së provimit final, mënyrës së ngritjes së komisioneve gjatë realizimit të provimeve ndonëse jo të dhëna specifike por theksohet fakti që elementë argumentues janë të dhëna në dokumentacione. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**

15. **Lidhur me komentën për standardin IV.1 kriteri 1**, GVJ ju bën me dije mungesën e stafit me formim sociologji apo në punë sociale, pasi referuar vlerësimit të CV-ve në këtë program gjendet stafi akademik i cili ka një nivel formimi në sociologji, por dhe staf me formim në ekonomi, filozofi dhe shkenca komunikimi. Nëse ju formoni specialistë të fushës psikologjike dhe sociale dhe ofroni program edukimi në këto drejtime dhe stafi akademik i angazhuar duhet t'i përkasi këtyre drejtimeve, të paktën në masën 50%. Referuar VKM 41, datë 24.1.2018, pika 2.5 ku sanksionohen kategoritë e veprimtarisë formuese që karakterizojnë një program studimi, ii) lëndët karakterizuese të cilat lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij dhe garantojnë përgatitjen për disiplinën shkencore, për ciklin e parë të studimeve bachelor duhet të jenë në ngarkesën 50-55 %, gjë e cila duhet të reflektojë dhe stafin akademik përkatës me gradat shkencore dhe titujt akademik në fushën specifike dhe jo në ato të përafërta të cilat si lëndë ndërdisiplinore nuk duhet të jenë më shumë se në masën 15 % dhe kjo vlerë gjithashtu duhet të referohet edhe në stafin akademik përkatës. Gjithashtu dhe ngarkesa mësimore e personelit akademik referuar Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018, Kreu II, pika 6, nuk mund të përmbajë më shumë se 3 lëndë semestrale, të shpërndarë në dy semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore, kufizim i cili orienton në një profilizim sa më specifik të personelit akademik. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

16. **Lidhur me komentën për standardin Standardi IV.1 kriteri 8** Objeksionet e IAL-së për këtë pikë mungojnë, ndaj **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**



17. Lidhur me komentin për standardin IV.1, rubrika “Konkluzione”, GVJ ju sjell në vëmendje se nëse në faqen ëeb të institucionit¹¹, por dhe në objektivat e programit dhe në qëllimin e tij, citojmë :-“Ky program studimi ka si qëllim formimin e specialistëve në fushën e studimeve psikologjike dhe sociale, të aftë për të punuar në sektorin publik dhe privat si: specialistë të psikologjisë dhe sociologjisë..” ndaj në vijim të sa më sipër balancimi i njohurive dhe aftësive akademike në të dy këto drejtime, dhe për më tepër ofrimi i tyre nga personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik në të dyja këto fusha do të garantonte cilësinë e diplomimit të studentëve. Gjithashtu, ashtu si dhe referohet ne objeksionet tuaja¹² fq.9, ju vetë shpreheni se lektorët tuaj janë kryesisht të formimit *Psikologjik* për të dyja nivelet Bachelor dhe MA dhe staf me formimin doktoral në psikologji të përvetësuar në institucione prestigjioze të botës, duke mos referuar të njëjtën gjë për stafin social. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

18. Lidhur me komentin për standardin IV.3, kriteri 1, Objeksionet e IAL-së për këtë pikë mungojnë, ndaj **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime** në raport, por, ju rikujtojmë se literatura në fushën psiko-sociale në shqip në këto vite është zhvilluar shumë, dhe ka dhe fjalorët¹³ e vet përkatës, të cilët mendojmë se duhet të jenë pjesë e domosdoshme e bibliotekës fizike të institucionit tuaj akademik.

19. Lidhur me komentin për standardin IV.3, kriteri 2; GVJ duke ju falenderuar për objeksionet ju rikujtojmë se e kemi vizituar bibliotekën dhe kemi aksesuar edhe listën e titujve të librave në dispozicion; gjithashtu dhe aksesin në bibliotekat online, por meqënëse programi i studimit është Bachelor dhe gjuha është shqip, si dhe duke pasur në konsideratë botimet e përkthimeve të cilat jo përherë kanë të njëjtën terminologji për koncepte dhe fenomene kryesisht të shoqërisë moderne, e këshillojmë fort përdorimin e literaturës në gjuhën shqipe për përmirësimin e aftësive dhe koncepteve të nevojshme të specialistëve të nesërm në këto fusha. Gjithashtu duke pasur në konsideratë rëndësinë që ka literatura shkencore dhe akademike dhe

¹¹ <https://www.umsh.edu.al/c/102/fakulteti-i-drejtësisë-dhe-shkencave-humane> Aksesuar më 11.10.2024

¹² Shkresa Nr.1097/1.Prot, datë 08.10.2024, fq.9

¹³ Todhri, F., Dhamo, E., Belshaku, S. & Muço, E. (2024) Fjalor i Punës Sociale (Dictionary of Social Work), westPrint 2024, Tirana Albania. ISBN 9789928363589



përdorimi i saj kemi sygjëruar që në aktet rregullative të jetë e reflektuar dhe përditësimi i saj dhe mënyra e përzgjedhjes dhe konfirmimit të literaturës së domosdoshme bazë konform garntimit të cilësisë. **GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.**

20. Lidhur me komentin për standardin IV.3, kriteri 2; Objeksionet e IAL-së për këtë pikë mungojnë, ndaj GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.

21. Lidhur me komentin për standardin IV.3, kriteri 8; Objeksionet e IAL-së për këtë pikë mungojnë, ndaj GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.

22. Lidhur me komentin për rubrikën “Konkluzione” standardi IV.3, GVJ sqaron se objeksionet tuaja të mbështetura te Evidenca 8, e cila është Rregullore departamenti.pdf nuk qëndrojnë, ndërsa referuar saktësimeve mbi pasqyrimet e literaturës bashkëkohore në syllabuset e reja, nga vlerësimi ynë i syllabuseve të vitit 2023-2024¹⁴, ju (ri)sjelim dhe një herë në vëmendje se masivisht ato nuk janë konform kriterëve dhe një pjesë e konsiderueshme e referencave nuk janë as konform standardit të citimit akademik dhe ka mangësira apo pasaktësi si në rastin e literaturës “Psikologjia” ISBN: 9789995672607, Viti i publikimit: 2008, i cili referohet nga ana juaj si botim i vitit 2018, referuar kjo syllabusit të programit “Psikologji e Përgjithshme, fq 40¹⁵, të Dr. E.T.; gjithashtu në progrmin e lëndës “Psikologji e Zhvillimit” me titullar lënde PhD. M.Ç¹⁶ literaturë e detyrueshme përveç prezantimeve të pregatitura nga lektori i lëndës gjenden dhe botime si Karaj, Th., (2004) “Psikologjia e zhvillimit të fëmijës” apo Karaj, Th., (2013) “Pikëpamjet mbi moshën e rritur”, të cilat gjithashtu nuk janë literaturë e përditësuar e pesë viteve të fundit; dhe kështu vijojmë dhe me literaturën bazë të detyrueshme për lëndën Shkrimi Akademik i cili është teks i vetëm i lëndës “Shkrim Akademik”¹⁷, dhe është i vitit 2000, lëndë kjo e pegadodëve Dr. H.H. Dr.M.,A. dhe PhD. I.K. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**

¹⁴ Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf

¹⁵ Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf, fq.40

¹⁶ Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf, Fq.31


¹⁷ Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf, , Fq.23.



23. Lidhur me komentën për standardin IV.5, kriteri 2; GVJ referuar objeksioneve nga ana juaj ku saktësohet për një qëndrueshmëri specifike për programin e studimit, pasi i shqyrtoi i pranon ato. Të dhënat janë në nivel institucional dhe për programin specifik garantohet vendimmarrje lidhur me situatën financiare konkrete, e cila është në përputhje me legjislacionin në fuqi. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**

24. Lidhur me komentën për standardin VI.2, rubrika “Konkluzione”; GVJ e konsideron ndërtimin e një strukture të mirëfilltë me detyra e përgjegjësi specifike për të gjithë njësitë e përfshira një garanci për cilësi, kjo duke pasur në konsideratë raportet e hartuara nga NJSBCZHK e cila ushtron veprimtari si në nivelin kryesor dhe në atë bazë e konsideron jo specifike dhe jo të detajuara vlerësimin e cilësisë së brendshme për këtë program. Referuar faktit që kjo IAL ka së paku katër fakultete dhe ofron studime në të tre nivelet Bachelor, Master dhe Doktoraturë, me një numër shumë të lartë programesh, referuar stafit në angazhuar në këtë njësi, por dhe raporteve të vëna në dispozicion, monitorimi dhe rritja e standardeve për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor mbetet në nivelin makro të vlerësimit duke mos na pasyruar me detaje elementët specifikë të cilësisë së programit “Studime Psikosociale”, i cili akreditohet. Vlerësimi i cilësisë mendojmë se duhet të vijë si rezultat i politikave dhe procese të cilat jo vetëm që duhet të krijojnë kulturën e brendshme të cilësisë por dhe të rrisin efektivitetin e programit të studimit si dhe të garantojnë arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. Kuadri rregullator na orienton në ndërtimin e një sistemi të brendshëm të sigurimit të cilësisë, jo vetëm të një njësie, sistem i cili duhet të zbatojë strategjitë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, promovimin e inovacionit dhe hartimin e udhëzuesve të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit për garantimin e promovimit të cilësisë së programit të studimit. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**

25. Lidhur me komentën për standardin VI.5, kriteri 2; RVJ-ja është njohur dhe ka vlerësuar raportet e monitorimit të NJSBCZHK, por në vijim të sa më sipër, sjellim në vëmendje të IAL-së se rezultatet e vlerësimit (nuk duhet të jetë raporte vlerësimi stafi) duhet të shoqërohen me plane masash specifike të cilat duhet të adresojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, dhe sikundër ju



vetëdeklaroni, edhe pse është akreditim për herë të dytë të programit nuk u evidentuan vlerësime specifike dhe plane masash konkrete për përmirësimin e cilësisë së programit bachelor “Studime Psikosociale”. Vlerësohen publikimet e raporteve si dhe njohjet me rezultatet e tyre të entiteteve të përfshira në procesin e monitorimit dhe të vlerësimit, por raporti nuk ju përgjigjet specifikave të programit për të referuar elementët e procesit mësimdhënës, mangësitë dhe dobësitë e evidentuara për këtë program specifik dhe masat e marra për t’i adresuar ato. **GVJ në lidhje me këtë pikë bën ndryshime në raport.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Studime Psikosociale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është institucion privat i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili në misionin e tij ka të përcaktuar qartë orientimin e veprimtarisë së tij për formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar duke kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare. Ky institucion është licensuar nga Qeveria, si institucion i arsimit dhe i kërkimit shkencor. Në Statutin¹⁸ e Universitetit Mesdhetar (2022), neni 4: Në misionin e tij deklarohet se: “Universiteti Mesdhetar si institucion i arsimit të lartë ka për mision të ofrojë veprimtari krijuese në fushën e informatikës, shkencave ekonomike, juridike, ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike që realizojnë synimet e tyre profesionale si brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë zhvillimin dhe mbrotjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet si brenda dhe jashtë vendit, formimin e studentëve të rinj në fushat e sipër përmendura nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar bashkëkohor si në aspektin metodik e teorik. Gjithashtu thellimin kualifikimit profesional, shkencor te specialistë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në planin strategjik institucional¹⁹ dhe me misionin e institucionit²⁰. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Studime Psikosociale”, i organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane është i përshtatur me interesat kombëtare dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.

¹⁸ Evidencë 1. Statuti i UMSH

¹⁹ Evidencë 4. Plani i zhvillimit strategjik UMSH

²⁰ Evidencë 1. Statuti UMSH Neni 4.

	80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë"²¹, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tjera që janë aplikuar në implementimin e tij si VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"²² dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019²³. Programi²⁴ i studimit të ciklit të parë Bachelor "Studime Psiko-Sociale" ka si synim pajisjen e studentëve me njohuri që i formon ato në fushën e shëndetit mendor dhe më specifikisht në shkencën e psikologjisë si dhe formimin e profesionistëve dhe specialistëve të përgjithshëm në fushën e psikologjisë. Ky program ka si qëllim të përgatisë specialistë të spikatur në sektorin privat, public, jo fitim prurës në shëndetin mendor nëpërmjet gjenerimit të ideve që ju japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave sociale aktuale dhe perspektive të zhvillimit kombëtar dhe rajonal.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së Njesisë bazë dhe Njesisë kryesore. Në dokumentat themelore të programit të studimit Bachelor "Studime Psikosociale" dëshmohet se programi është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me qëllimin dhe misionin e UMSH. Universiteti Mesdhetar ofron programe studime të cilat janë në përputhje me Ligjin "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë". Programi²⁵ i studimit të ciklit të parë Bachelor "Studime Psiko-Sociale" ka si synim pajisjen e studentëve me njohuri që i formon ato në fushën e shëndetit mendor dhe më specifikisht në shkencën e psikologjisë si dhe formimin e profesionistëve dhe specialistëve të përgjithshëm në fushën e psikologjisë. Këto parime dhe udhëzime janë shprehur në Statutin e UMSH, rregulloren e departamentit²⁶ si dhe në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Studime Psikosociale"²⁷. Gjithashtu, ky program ndjek të gjitha rregullat dhe ligjet e vendosura nga

²¹ Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri"

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBO TIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLE TORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-09-2023).

²² VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-datë-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

²³ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdj> (Aksesuar më 09-09-2023).

²⁴ Evidencw 5: Strategjia e Zhvillimit të Programit SPS.Pdf

²⁵ Evidencw 5: Strategjia e Zhvillimit të Programit SPS.Pdf

²⁶ Evidencw 8. Rregullore e UMSH (2022).

²⁷ Evidencw 7. Rregullore Bachelor Studime Psikosociale (2022)

	shteti në lidhje me arsimin e lartë. Programet e studimeve të ofruara nga UMSH, përfshirë programin e ciklit të parë Bachelor "Studime Psikosociale", kujdesen për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Këto synime janë në përputhje me Planin Strategjik të UMSH-së 2018-2023²⁸. Gjithashtu bazuar dhe në rregulloren e organizimit të UMSH-së²⁹ në nenin nr.4 Pika 1. Theksohet qartë liria akademike në a) organizimin e veprimtarisë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ato krijuese b) në hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e fushave të kërkimit c) organizimin e promovimit të personelit akademik.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka hartuar një sërë dokumentash të përcaktuara që synojnë ruajtjen e linjës akademike të tij dhe prioritetet kryesore të zhvillimit. Këto dokumente përfshijnë Strategjinë e Zhvillimit të ³⁰ Programit, dokumente të tjera si Statuti i UMSH³¹, rregullorja e SPS³², dhe rregullorja e Departamentit SPS etj. Rregullorja e UMSH-së³³ dhe Statuti UMSH-së³⁴ vijnë në të njëjtën linjë dhe përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike, si dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të tij. Në rregulloren UMSH-së Neni nr.1 theksohet qartë se rregullorja është në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit Mesdhetar të sanksionuar në Statutin e UMSH-së. Sipas Statutit të UMSH³⁵ (2022), neni 48 në Strukturën e UMSH bën pjesë Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ku ndodhet dhe njësi bazë e Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë e cila ofron edhe programin e studimit Bachelor "Studime Psikosociale". Programi i studimit ofrohet në përputhje me Statutin e UMSH neni 65 dhe rregulloren e studimeve në UMSH ku thuhet që programet e ciklit të parë organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të mesatares, e cila përcaktohet në rregullore. Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të ciklit të parë

²⁸ Evidencë 4. Plani strategjik UMSH 2018-2023.

²⁹ Evidencë 2. Rregullore e organizimit UMSH

³⁰ Evidencë 5. Strategjia e zhvillimit të programit

³¹ Evidencë 2. Statuti UMSH 2022.

³² Evidencë 7. Rregullore SPS.

³³ Evidencë 2. Rregullore e organizimit UMSH

³⁴ Evidencë 1: Statuti UMSH

³⁵ Evidencë 1. Statuti UMSH Neni 48

	Bachelor Studime Psikosociale ka mbështetur misionin dhe vizionin duke u bazuar hë forcimin e lidhjeve të tregut duke i dhënë mundësi studentëve që ky program studimi ti japë mundësi studentëve të licënsohen si psikolog duke e pasuruar programin³⁶ me një % më të madhe lëndësh në fushën e psikologjisë e cila ka krijuar aftësinë më të mirë në profesionin e psikologut duke bërë të mundur njohjen e saj nga Urdhri Psikologut. Në kontekstin e ndërkombëtarizimit të programeve të studimit³⁷, UMSH në qëllimet e Planit Strategjik specifikisht Qëllimi nr.3 është krijimi i mundësisë së bilingualizimit i cili do ti krijojë mundësi studentëve që të kenë në programin e tyre mësimor lëndë në gjuhë të huaj specifikisht në atë anglisht duke krijuar mundësinë e harmonizimit dhe standartizimit të terminologjisë në gjuhën angleze. Ky veprim synon të unifikojë programe të cilat janë në përputhje me standardet europiane, duke lehtësuar në këtë mënyrë mobilitetin e studentëve dhe kualifikimin e tyre për studime dhe punësim në vendet e Bashkimit Evropian.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe prirjet globale. Për të plotësuar nevojat e tregut, programi i studimit “Bachelor” “Studime Psikosociale” ofron lëndë mësimore³⁸ që ndikojnë në formimin e përgjithshëm të studentëve edhe pse % e tyre është e ulët ato ndikojnë duke krijuar rrugën që në të ardhmen, pas studimeve master, këta studentë të jenë një vlerë e shtuar në sektorët social dhe ekonomik të vendit. Gjithashtu rregullorja e studentëve me aftësi ndryshe³⁹ jep informacion të detajuar mbi konformitetin e ambientit fizik për të gjithë studentët. Rregullorja e programit të studimit është një dokument themelor për programin e studimit, i cili justifikon qëllimin e hartimit të programit dhe reflekton se programi i studimit përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe në fushën e profesioneve të rregulluara, sikurse është profesioni i psikologut. Kjo rregullore si në nivel universiteti⁴⁰, departamenti⁴¹ apo rregullore⁴² në nivel programi është në përputhje edhe me Statutin e Universitetit dhe i referohet çdo

³⁶ Evidencë 13 dhe Evidenca 13.1:Programi mësimor SPS

³⁷ Evidencë 44. Strategjia e Ndërkombëtarizimit UMSH.

³⁸ Evidencë 13 dhe Evidenca 13.1:Programi mësimor SPS

³⁹ Evidencë 18. Rregullore për studentët me Aftësi Ndryshe

⁴⁰ Evidencë 2:Rregullore e organizimit UMSH


⁴¹ Evidenca8: Rregullore Departamenti UMSH

⁴² Evidencë 7:Rregullore SPS

	hallke të programit.
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Studime Psikosociale" është Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, i cili është pjesë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Ky program i Studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë ka orientuar veprimtarinë e tij duke ofruar mësimdhënie cilësore, duke punësuar staf akademik të përkushtuar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe në projekte të ndryshme, si edhe ndërtimin e marrëdhënieve me organizata vendase dhe të huaja, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, kryerjen e projekteve/detyrave të kursit, studime kërkimi. Programi studimit është konform rregullave dhe direktivave kombëtare e evropiane. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme në fushën akademike të specializuar për të ofruar një program studimi në atë fushë. Ky fakt është i dëshmuar përmes personelit akademik të angazhuar në zbatimin e programit të studimit, të cilët kanë tituj akademikë dhe grade shkencore⁴³. Megjithatë, ndërsa personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" ka tituj akademikë dhe grada shkencore, është e rëndësishme të theksohet se aspektet që lidhen me angazhimin e stafit në profile të afërta ose të ndërmjetme me disiplinën e psikologjisë mund të paraqesin sfida në cilësinë e mësimdhënies⁴⁴. Këto sfida përfshijnë mundësinë që stafi me profile të ndryshme të ketë një përvojë të kufizuar në disiplinën e studimeve psikosociale dhe të jetë më pak i kualifikuar për të mbështetur nevojat e specifika të këtij programi studimi. Në këtë pikë duhet theksuar fakti se duke qënë se në program përqindja më e madhe e lëndëve është në aspektin psikologjik kjo kërkon një numër më të madh të petagogëve në këtë profil por gjithashtu nuk duhet neglizhuar dhe fakti që edhe në aspektin e sociologjisë sërish duhet të theksohet i njëjti fakt duke qënë se profili është studime psikosociale pasi ndikon drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të programit
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se referuar dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë rezulton se Universiteti i Mesdhetar ofron programe studimi në përputhje me misionin</i>

⁴³ Evidenca 13.2: Syllabuse

⁴⁴ Evidenca 13.3: Cv e stafit akademik




	dhe qëllimin e tij. Në hartimin dhe politikat e zhvillimit të programeve të studimit synohet zhvillimi i interesave dhe vlerave kombëtare si dhe ruajtja e tyre. Programi i studimit "Bachelor" në "Studime Psikosociale", ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të Universitetit të UMSH. Përbushja e standartit është e garantuar me dokumentacionin dhe mekanizmat që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Personeli akademik i programit Bachelor ka tituj akademikë dhe grade shkencore në përputhje me ligjet aktuale, megjithatë, mund të ndodhin kufizime në ekspertizën e tyre në disiplinën e studimeve psikosociale dhe që mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe përbushjen e objektivave programore. Për të garantuar cilësinë e mësimdhënies, UMSH duhet të përqëndrohet në rekrutimin e stafit akademik me kompetenca të specializuara në psikologji dhe sociologji. Gjithashtu, është e rëndësishme që njësi bazë të punojë në hartimin e moduleve dhe lëndëve duke rishikuar dhe një ndarje të profileve që përmban dega si studimeve psikosociale duke qënë se % më të madhe e katë fokusuar në aspektin psikologjik duke zbehur atë sociologjik edhe pse mund të ketë një aspekt justifikues për tu balancuar në njohjen dhe licensimin e degës nga Urdhri Psikologut.			
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësishtit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Organizimi akademik dhe administrativ i UMSH-së dëshmon rëndësinë e marrëdhënieve bashkëpunuese në nivele të ndryshme të organizimit brenda institucionit për mbarëvajtjen e programit të studimit. Fryma e bashkëpunimit shprehet nëpërmjet ndarjes së detyrave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	funksion të mbështetjes së punës së programit të studimit. Ndarja e detyrave mes njësive e personelit dhe marrja e përgjegjësive përkatëse planifikohet që në fillim të vitit akademik, duke siguruar realizimin me sukses të procesit mësimor, praktikave, udhëheqjeve të diplomave dhe veprimtarive të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor e kërkimor të programit të studimit. Nisur nga kjo pikëpamje duhet theksuar fakti se institucioni ka implementuar një strategji të përpiluar për të siguruar funksionimin e strukturave⁴⁵ të tij përbërëse. Ky koordinim i detajuar është bazuar në një gamë dokumentesh zyrtare, duke përfshirë: Statutin⁴⁶ dhe në Rregulloren e UMSH-së⁴⁷, që caktojnë rregullat dhe strukturën themelore të universitetit gjithashtu për të pasur një kordinim sa më të mirë të programit të studimit është përcaktimi i tutorit⁴⁸ që ka rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen, funksionimin këshillimin akademik jo vetëm në nivel program por dhe në lidhje me procesin akademik të studentëve⁴⁹. Njësitë bazë dhe personeli akademik i tyre ofrojnë ekspertizë dhe mundësinë akademike në përmbushje të kuadrit të veprimtarisë në programin e studimit bachelor "Studime Psikosociale" si në aspektin teorik dhe atë praktik. Në rregulloren e njësive kryesore dhe bazë⁵⁰ e cila ofron udhëzime të nevojshme për të ndihmuar njësitë në zbatimin e detyrave të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Identifikimi i rregullave, neneve në rregulloren e programit të studimit⁵¹, ndihmon në përcaktimin dhe menaxhimin sa më efektiv të procesit mësimor. Në të njëjtën kohë, rregullorja e sekretarisë mësimore⁵², rregullorja e funksionimit të Këshillit studentor⁵³ dhe njësia e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës⁵⁴ (ZKSK) kanë rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e një procesi akademik të një niveli cilësor, produktiv dhe profesional.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni	Në kuadër të bashkëpunimit me institucione synohet: "të rritet bashkëpunimi duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me interes të përbashkët me të gjitha institucionet e arsimit të lartë public apo privat, kolegje universitare si në Shqipëri ashtu

⁴⁵ Evidenca 3.Organigrama

⁴⁶ Evidenca 1. Statuti UMSH 2022.

⁴⁷ Evidenca 2. Rregullore e UMSH

⁴⁸ 17.Vendim për zgjedhjen e Tutorit

⁴⁹ 17.Vendim për zgjedhje të Tutorit neni 7 & 8

⁵⁰ Evidenca 8. Rregullore e Departamentit Psikologji dhe Sociologjisë.

⁵¹ Evidenca 7. Rregullore Bachelor "Studime Psikosociale".

⁵² Evidenca 46. Rregullore e Sekretarisë mësimore

⁵³ Evidenca 48. Rregullore e Funksionimit të Këshillit Studentor.

⁵⁴ Evidence 49. Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës

vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	dhe në Universitete të tjera jashtë vendit. Përmes shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga UMSH, i cili është konfirmuar më pas gjatë takimeve të mbajtura me drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë, si dhe përmes konsultimeve me studentët, evidentohet se në institucion ekzistojnë rreth 94 marrëveshje institucionale⁵⁵ të lidhura me institucione në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Numri i marrëveshje që ka UMSH janë si më poshtë: A) 19 marrëveshje me Universitetet me karakter publik dhe jopublik; B) 23 marrëveshje me zyrën me marrëdhënien me Jashtë Erasmus+; C) 16 marrëveshje me biznese private; D) 5 marrëveshje me Institucione shtetërore; E) 2 marrëveshje me Organizata OJF; F) 29 marrëveshje me institucione ndërkombëtare. Këto marrëveshje janë të orientuara në arritjen e qëllimit dhe objektivave në tre faza afatshkurtër, afatmesme apo afatgjatë që kanë karakter formues, përmirësues dhe praktik. Vlen të theksohet se këto marrëveshje janë shfrytëzuar me sukses për të promovuar praktikat profesionale, aktivitete ekstrakurrikulare, leksione⁵⁶ të hapura me lektorë të ftuar, sesione pune, dhe shanse të ndryshme për mobilitet të stafit⁵⁷, lëvizje të stafit akademik dhe administrativ⁵⁸ dhe studentëve⁵⁹. Në lidhje me një evidencë me lëvizje të studentëve me mobilitet nga 2021-2023 është 7 studentë por në sistemin Bachelor studimeve Psiko-Sociale nuk është pasqyruar kjo për faktin se edhe pse kanë egjistuar mundësitë për aplikim nga Institucioni studentët u shprehën se për arsye të ndryshme personale nuk kanë mundur të zhvillojnë një eksperiencë të tillë por në të ardhmen e shohin si një mundësi shumë të mirë për t'u zhvilluar në procesin akademik nisur dhe nga informimet që kanë marrë nga pedagogët e tyre. Por nga dokumentacioni vihet re se në nivel masteri ka studentë që janë me mobilitet. Vlen për t'u theksuar fakti se ky model bashkëpunimi ka një ndikim pozitiv në arritjen e objektivave të procesit mësimor dhe formues si në aspektin teorik dhe praktik të studentëve apo dhe pedagogëve.
---	--

⁵⁵ Evidenca 10: Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit

⁵⁶ Evidenca 19: Leksione të hapura

⁵⁷ Evidenca 33: Lëvizje e Stafit Akademik.

⁵⁸ Evidenca 6.1: Lëvizje stafit akademik dhe administrativ (document i atashuar te dokumentat shtesë)

⁵⁹ 2.: Dokumenta që japin numrin e studentëve, stafit akademik që kanë lëvizur me mobilitet

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale për të cilat gjatë diskutimeve u theksua por departamenti ka institucionalizuar aktualisht praktika dhe ka të pasqyruar një listë konkrete me institucionet përkatëse, në të cilat studentët mund të kryejnë praktikat profesionale. Këto marrëveshje sigurojnë një burim të vyer për përvojën e studentëve dhe i japin atyre një shans të vërtetë për të njohur kontekstin specifik të punës së një profesionisti psikosocial. Përmes këtij bashkëpunimi, studentët mund të fitojnë përvojë profesionale praktike, të njohin më mirë sfidat dhe mundësitë e fushës së tyre dhe të kuptojnë rolin, funksionin dhe përgjegjësitë në shoqëri e më gjërë. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti SPS se në veprimtaritë e tyre kërkimore shkencore bashkëpunojnë⁶⁰ në mënyrë të vazhdueshme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushave të ndryshme. Disa veprimtari kërkimore të realizuara në bashkëpunim janë të evidenduara në listën e leksioneve⁶¹ të hapura si trajnime me stafin, konferenca studentore, konferencat e organizuara nga UMSH ndër vite apo ⁶²programi i trajnimeve. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme mobiliteti nga të cilat përfitojnë personeli akademik dhe studentët. UMSH dhe DSPS dëshmojnë se si programin kryesor me anë të të cilit mundësohet mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik është ⁶³ERASMUS+.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, ku ofrohet programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto të dhëna pasqyrohen në dokumeta si raporti vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, raporti për veprimtarinë e programit të studimit, analiza vjetore e departamentit⁶⁴, udhëzues⁶⁵ i studentit, mbledhje të departamentit që shoqërohet dhe shënohen dhe në bllokun procesverbalit të mbledhjeve të tjerë. Vlen për tu theksuar fakti se si pasojë e mungesës së pasqyrimit të dumentacionit si analizë vjetore e departamentit, raport vjetor i vetvlerësimit të

⁶⁰ Evidencë 10:Lista e bashkëpunimeve

⁶¹ Evidencë 19:Lista e zhvillimit të leksioneve të hapura

⁶² Evidencë 26: Programi i trajnimit

⁶³ Evidencë 10:Lista e bashkëpunimeve

⁶⁴Evidencë 3.:Analiza vjetore e departamentit

⁶⁵ Evidenca 2: Udhëzues i Studentit

⁶⁶ Evidencw 9.1:Procesverbali mbledhjeve te departamentit (dokument i aattashuar te dokumentat shtese)

	programit mund të nuk mund të japim një përshkrim të qartë të nivelit të përfshirjes së studentëve por nuk mund të anashkalohet fakti që nëpërmjet listës së bashkëpunimit, listë së programit të trajnimeve ⁶⁷ evidentohen raste të tilla e cila u përforcua edhe në takimet dhe bisedat e zhvilluara me stafin dhe studentët.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Departamenti nxit dhe punon në drejtim të rritjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit dhe Universiteti i UMSH ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me	Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë ka të përcaktuar në rregulloren e Programit të tij, “Studime Psikosociale” ⁶⁸ përveç të tjerash edhe aspektet që lidhen me elementët përbërës të strukturës së programit Bachelor në “Studime Psikosociale”, duke u përpjekur të jenë konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁶⁹ duke ofruar programe

⁶⁷ Evidencw 26:Programi i trajnimit

⁶⁸ Evidencw 7:Rregullore e SPS Kreu IV,neni 15,16,17

⁶⁹Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

<https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAE>

legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	studimi të organizuara në module dhe vlersuar në kredite, në përputhje me Sistemin European të Trasferimit të Krediteve (ECTS) dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁷⁰, ⁷¹. Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu VII, neni 71 pika 2 dhe 3 shprehet si më poshtë: “Pika 2; Elementet që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” “Pika 3; Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statut dhe rregullore elemente të hollësishme për programet e studimeve që ato ofrojnë.” Sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, duhet të jenë sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2, shprehet se: Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në: a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale; d) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; e) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; f) planin mësimor; g) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; h) programin lëndor (Syllabus-et); i) profilin e programit;
---	--

OTIMEVEZYRTARE LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLE TORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE djvu.txt(Aksesuar më 09-09-2023).

⁷⁰VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/çp-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 04-02-2023).

⁷¹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viccer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyYËx8ZnNobnxncDo3NzYxM2UëZËNhMËEIYjdj> (Aksesuar më 09-09-2023).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	j) diplomën dhe suplementin; Programi i studimit është i hartuar dhe licensuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programet e studimit në ciklin e parë janë të organizuar në lëndë/module sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ato realizohen në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total. Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Studime Psiko-Sociale” është i organizuar dhe ofrohet me të gjithë elementët e tij në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi sipas niveli 6 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve kjo e pasqyruar në planin^{72 7374}mësimor.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Hartimi i programit të studimit, syllabusve të lëndeve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit burojnë nga kuadri ligjor për Arsimin e Lartë; Statuti⁷⁵ dhe Rregullore të Universiteti⁷⁶t të Mesdhetar. Të Tiranës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e psikologëve. synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në fushën e psikologjisë. Kjo është në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe vizionin e zhvillimit të programit⁷⁷, që synon të sigurojë njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme, si dhe aftësi të caktuara në një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Programi i studimit BSc Studime Psikosociale në UMSH/Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Humane/Departamenti Psikologjise-Sociologjisë Psikologji ka si qëllim kompletimin e studentëve me kompetenca profesionale dhe personale; me njohuri dhe aftësi në orientime të ndryshme të fushës së psikologjisë, psikosociale, organizacionale, komunitare, si psikologji sociale, etj. Kjo perspektivë e programit të studimit krijon mundësinë që studentët të jenë të orientuar qartazi në përzgjedhjen e karrierës së tyre të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. Kjo kurrikul e Studimeve në Ciklin Bachelor i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit

⁷² Evidencë:13/13.1: Plani mësimor

⁷³ 8: Syllabuse:1,2,3,4

⁷⁴ Evidencë 13.2: Syllabuse, 2,3,4

⁷⁵ Evidencë 1: Statuti UMSH

⁷⁶ Evidencë 2: Rregullore e organizimit të UMSH-së

⁷⁷ Evidencë 5: Strategjia e zhvillimit të Programit

	pasuniversitar, duke bërë të mundur një informim sa më profesional me shprehi konform profesionit dhe zhvillimin sa më profesional në zhvillimin akademik. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të planit mësimor⁷⁸ të këtij programi studimi, ka një angazhim të njësise për të përmirësuar këtë program studimi në vijim. Kjo është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe të ndërkombëtarizimit të programeve, me qëllim të unifikimit me standardet e vendeve të Bashkimit Europian. Për të lehtësuar mobilitetin e studentëve për studime dhe punësim në BE, Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë ka kërkuar unifikimin e programeve me standardet e EuroPsy. Kjo është një nevojë e vazhdueshme dhe kërkon angazhim të të gjitha palëve të përfshira në procesin e përmirësimit të strukturës dhe përmbajtjes së këtij programi studimi. Nisur dhe nga diskutimi me stafin akademik dhe studentët u vu re se angazhimi për përmirësim ishte i dukshëm kjo duket qartë dhe në planin mësimor që edhe pse Programi mësimor është “Studime Psikosociale”, % përqindja më e madhe e lëndëve është në aspektin psikologjik duke lënë me përqindjetë ulët aspektin sociologjik dhe kjo për arsye që fokusi të jetë në drejtim psikologjik dhe studenti të licensohet në profesionin e psikologut. Gjithashtu vlen për tu theksuar se studentët, krahas njohurive në disiplinën karkterizuese të studimit ju ofrohen dije dhe kompetenca edhe në disiplina të përafërta duke synuar kultivimin e kompetencave të nevojshme për të përgatitur profesionistë të specializuar. <i>Nisur nga sa u citua me sipër GVJ sugjeron riorganizim të programit të studimit Bachelor “Studime Psikosociale” duke gjetur një balancë midis emertimit të programit dhe kurrikulës që përmban programi.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit ka të përcaktuar qartë se dijet dhe njohuritë e përvetësuar në të janë të orientuara drejt përvetësimit të koncepteve bazë psikologjike, teorive klasike dhe analizave kryesisht makro e mikropsikologjike bazuar mbi paradigmen e zhvillimeve psikosociale të qenies njerëzore në disa drejtime si dhe të fokusuar në atë sociologjik. Duke iu referuar planit mësimor⁷⁹ kemi të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore bazuar në Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit

⁷⁸ Evidencë 13.13.1: Programi mësimor, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

⁷⁹ Evidencë 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁸⁰; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁸¹ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019⁸² dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021⁸³, përgjithësisht duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe shoqëruar me kredite përkatëse. Ky program studimi është i organizuar në lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, si dhe lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Pjesë e programit është edhe provimi final ose punimi i temës së diplomës, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë si më poshtë vijon⁸⁴:

Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor
A	Lëndë bazë	15–20% (kredite)	19% (kredite)
B	Lëndë karakterizuese	50–55% (kredite)	52% (kredite)
C	Lëndë ndërdisiplinore	12–15% (kredite)	12.7% (kredite)
D	Lëndë plotësuese	10–15% (kredite)	11% (kredite)
E	Detyrime përmbyllëse	3–5% (kredite)	4% (kredite)

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të

⁸⁰ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-09-2023).

⁸¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

⁸² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”
<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxncDo3NzYxM2UcZËNhMËËIYjdI> (Aksesuar më 09-09-2023).

⁸³ Vendim Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofuara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë”, Të Ndryshuar.
<https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofuara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/> (Aksesuar më 09-09-2023).

⁸⁴ Evidencë 20. Tabelat ASCAL, Tabela 9, faqja 31.

	programit të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” të paraqitura në Planin Mësimor 2022-2023⁸⁵ dhe kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM Nr.185, datë 25.03.2021⁸⁶, për programet e ciklit të parë, nxjerr në pah se pjesa më e madhe e të dhëna përafrohen me vendimin në fjalë. Thuajse të gjitha lëndët e këtij programi në nivel universitar janë të pajisura me tekstet⁸⁷ përkatëse origjinale ose të përkthyer ose leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës⁸⁸. Në to studentët gjejnë parashtrimet themelore për lëndën. Përpos teksteve, studentëve iu referohet literaturë plotësuese në gjuhën Shqipe ose në shumë pak raste në gjuhën angleze. Programi i studimeve të ciklit të parë “Bachelor” në “Studime Psikosociale” është me 180 kredite dhe me klasifikimin sipas komponentëve mësimorë për secilën lëndë të planit mësimor.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planin mësimor⁸⁹ të programit të studimit rezulton se në programin e studimit Bachelor “Studime Psikosociale” ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës 6 kredite në planin mësimor, të emërtuar Praktikë e cila zhvillohet në vitin e tretë semestri dytë dhe 6 orë në javë.
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Studimet në programin e ciklit të parë Bachelor në “Studime Psikosociale” të ofruar nga UMSH mbështeten në 4 dokumente kryesore që janë: a) Planin mësimor^{90,91} b) Syllabuset e lëndëve mësimore^{92,93} c) Rregullorja e programit të studimit⁹⁴ Programi Bachelor⁹⁵ “Studime psikosociale” është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane në UMSH dhe ka një kohëzgjatje prej tre vitesh e cila gjithsej ka 180 ECTS dhe është e organizuar sipas programeve të studimit me

⁸⁵ Evidencë 13.13.1: Planin mësimor

⁸⁶ Vendim Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit Të Ofuara Nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofuara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/> (Aksesuar më 09-09-2023).

⁸⁷ Evidencë 8.Syllabuse 1,2,3,4

⁸⁸ Evidencë 13.2:Syllabuse 2,3,4

⁸⁹ Evidencë 20: Tabelat ASCAL, Tabela 10, faqja 16

⁹⁰ Evidencë 13,13.1: Planin mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

⁹¹ Evidencë 20:Tabela ASCAL, Tabela 9, faqja 14

⁹² Evidencë 13.2. Syllabuse 2,3,4.

⁹³ 8.:Syllabuse 1,2,3,4

⁹⁴ Evidencë 8: Rregullore Departamentit Psikologji-Sociologji.

⁹⁵ Evidencë 7: Rregullore Programi e Programit të Studimit Kreu 1, neni 3.

	kohë të plotë dhe gjuha e përdor është në gjuhën e shqipe. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara nga studenti me kohë të plotë përgjatë një viti akademik është 60 ECTS. Tërësia e veprimtarive formuese gjendet e shprehur në Planin Mësimor, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit në të cilën parashtrihen emërtimi i programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve, tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave, kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas aktiviteteve formuese të saj (leksione/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, karakteristikat e tezës së diplomës. Pranimi⁹⁶ i kandidatëve në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Studime psikososiale” bazohet në përmblidhjen e kriterëve të Ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe kriteret që vendos Universiteti në bazë të secilit vitit akademik. Kuotat⁹⁷ dhe kritret e pranimit të studentëve në studime të ciklit të parë propozohen nga njësi bazë sipas akteve ligjore dhe administrative dhe miratohen nga Senati akademik.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Lëndët⁹⁸ në këtë program studimi kanë ngjashmëri edhe me programet e tjera në universitete brenda dhe jashtë vendit. Kjo krijon më shumë mundësi për transferime apo mobilitet të studentëve. Ky program studimi i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë ka në përmbajtjen e tij lëndë module që synojnë të japin njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca në linjë me profilin përkatës por më shumë në apsketin psikologjik edhe emërtimi i programit është “Studime Psikososiale” dhe në planin⁹⁹ mësimor % më e madhe e lëndëve është në profilin psikologjik duke zbehur atë me karakter social, ku % e lëndëve është në nivel të ulët. Duke iu referuar këtij profili ka një mospërputhje midis komponentëve kryesorë që e përbëjnë atë si në strukturë, përmbajtje dhe emërtimin e programit të studimit edhe pse synimi është licensimi i profesionit në këtë profil.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe	Bazuar në Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022 për “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, pika 12 theksohet se: “Për programet e studimit ekzistuese të

⁹⁶ Evidencë 7: Rregullore e Programit të Studimit, Kreu III, neni 11 dhe 12

⁹⁷ Evidencë 2: Rregullore e organizimit të UMSH, Kreu VII, neni 51

⁹⁸ Evidencë 13.13.1: Planet mësimore

⁹⁹ Evidencë 13.13.1: Plani mësimor

klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre”. Nga shqyrtimi dokumentacionit ¹⁰⁰¹⁰¹¹⁰² vihet re që programet janë të gjitha sipas kodeve përkatëse.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Në Statutin ¹⁰³ e UMSH, Plani i zhvillimit strategjik ¹⁰⁴ , Strategjinë e zhvillimit të Programis SPS ¹⁰⁵ , parashikohet edhe rëndësia e programeve të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi specifikisht me Universitetin e Bolonjës ku qëllimi është të përmirësojë procesin e mësimdhënies dhe përvetësimit e dijes në nivel cilësor duke synuar që UMSH të zërë në nivel elitare brenda Hapësirës Shqiptare të Arsimit të Lartë. Universiteti Mesdhetar në Statutin e UMSH, neni 71 thekson se “Universiteti ofron programe bashkëpunimi nëpërmjet një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara dhe legjislacionin në fuqi”. Kjo bën që në përfundim të studimeve të lëshohet një diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse ¹⁰⁶ . Pra Universiteti Mesdhetar ofron programe studime që mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.			
Konkluzione	Referuar kurrikulës dhe emërimit të programit të studimit GVJ gjykon rishikimin e emërimit të programit bazuar në peshën e lëndëve që përmban kurrikula. Ky standard <u>përmbushet kryesisht.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore

¹⁰⁰ Evidencë 15: Tabela Ascal, Plani mësimor fq.15

¹⁰¹ Evidencë 15 :Tabela Ascal ,Plani mësimor bazuar në Veprimtaritë formuese Tabela nr.9;fq.16

¹⁰² Evidencë 13.1: Plani mësimor

¹⁰³ Evidencë 1: Statuti UMSH

¹⁰⁴ Evidencë 4: Plani strategjik UMSH

¹⁰⁵ Evidencë 5: Strategjia e zhvillimit të programit

¹⁰⁶ Evidencë 1: Statuti UMSH, neni 71

dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë¹⁰⁷ dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë përcaktohen qartë detyrimet e njësisë kryesore dhe njësisë bazë në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike si më poshtë vijon: Në nenin 23 të Ligjit përcaktohet se: “Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë”. Në nenin 25 të ligjit përcaktohet se Departamenti: “Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për strukturën akademike dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga 4 departamente: 1- Departamenti i së Drejtës; 2- Departamenti Shkencave Politke dhe Marëdhënieve Ndërkombëtare; 3- Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë; 4- Departamenti Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave; Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane në vitin

¹⁰⁷ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Akseuar më 04-09-2023).

akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (51 pedagogë PAE) dhe 16 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane	
	PAE	PAK
Prof.Dr	4	1
Prof.Asoc	6	1
Dr/PhD	28	8
Msc	13	6
Total	51	16
Gjithsej	67	

Rezulton se çdo njësi bazë e Fakultetit plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor. Njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:


Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1	-	1
Prof. Asoc.	1	-	1	1	1	-
Dr./PhD.	6	1	7	1	8	2
Msc.	4	-	2	-	2	1
Totali	12	2	11	3	11	4

Bazuar në përcaktimet e mësipërmë GVJ konstaton se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Studime Psikosociale" përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi e cila është e dukshme dhe për përmbushjen e detyrimeve për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë¹⁰⁸.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse

Programi i studimit Bachelor në "Studime Psikosociale" ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë në planin e tij

¹⁰⁸ Evidenca 15:Tabela Përmbledhës ASCAL, Tabeli nr.1 fq.1.2




për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	mësimor ka të përcaktuar zhvillimin e praktikës institucionale të emërtuar si Praktikë. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel akademik efektiv për realizimin e praktikave institucionale. Praktikrat institucionale janë të rregulluara gjithashtu nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit¹⁰⁹ me Institucione me fushë veprimi në dobi të programit të studimit. Vlerësimi praktikës¹¹⁰ bazohet në disa element së pari duhet të frekuentohet pasi konsiderohet si lëndë dhe vlerësimi bazohet në bazë të raportit të cilin studenti e paraqet para komisionit për mbrotjen e praktikës dhe vlerësimi bëhet me notë. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me studentët e stafin akademik vuri re se realizimi i praktikave në mënyrë profesionale dhe të supervizuar nga pedagogë të kualifikuar të licensur në profesionin e Psikologut, e cila krijonte mundësinë që njohuritë e marra në bazë teorike t'i zhvillojnë në mënyrë profesionale në praktikrat që zhvillonin.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në rregulloren e departamentit¹¹¹ të Psikologjisë dhe Sociologjisë, në nenin 7 të saj parashikohet përgjegjësi i departamentit si autoritet drejtues akademik për këtë program studimi. Ai është përgjegjës për ndarjen e ngarkesës mësimore ndërmjet antarëve të departamentit në bazë të normave, ngarkesës mësimore, kualifikimeve përkatëse. Drejtuesi departamentit duhet të ketë Titullin Profesor ose të ketë gradën (Phd) të fituar pranë Universiteteve të vendeve anëtare të OECD ose të BE-së. Referuar ngarkesës që ka përgjegjësi departamentit për të drejtuar dhe bashkërenduar veprimtarinë e kërkimit në aspektin shkencor përzgjidhet një kordinator¹¹² i cili duhet të ketë gradën Doktor ose të jetë në process doktrature. Kordinatori propozohet nga njësia bazë dhe miratohet nda decani. Në realizimin e detyrave të tij ai bashkëpunon dhe me kordinatorë të njësive të tjera bazë. GVJ rekomandon që në cilësinë e koordinatorit të programit të studimit i cili është i mirëpërcaktuar për lehtësimin e punës së kërkimit shkencor të njësisë bazë në Rregulloren e departamentit u vu re që nuk ishte përzgjedhur një anëtar por duhet theksuar fakti që Programi “Studime Psikosociale” kishte një pedagog në funksionin e Tutoriatit¹¹³ profesionit në këtë

¹⁰⁹ Evidencë 15: Tabela Përmbledhëse ASCAL, Tabela nr.5 fq.9

¹¹⁰ Evidencë 45: Udhëzues për Praktika, Pika 11

¹¹¹ Evidencë 8: Rregullore e Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë neni 7

¹¹² Evidencë 8: Rregullore e departamentit neni 13

¹¹³ 17. Vendim të zgjedhjes së Tutoriatit

	fushë dhe shumë bashkëpunues me studentët dhe kjo u vu re dhe nga biseda me stafin dhe studentët për punën dhe bashkëpunimin që zhvillonte me studentët e cklit të Parë Bachelor duke zbatuar me përpikmëri të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që kishte ky pozicion; si të mbështesë dhe nxitë studentët në zhvillimin akademik, trajtimi i vështirësive që studentët përballen gjatë viteve studentore, vështirësive që mund të hasë gjatë procesit mësimor, etj.			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë si njësi përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Studime Psikosociale" përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Ndërkohë për këtë program studimi ndonëse sipas ligjit kërkohet kordinator u vu re nga bisedat me stafin, studentët që për programin e studimit në funksion të realizimit të objektivave të tij dhe të drejtimit të praktikave profesionale nga personel akademik zhvillohet nga Tutoriati, pedagogë Dr.F.SH.</i> <u>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm</u> bazuar në informacionet e paraqitura në këtë standard gjykon se përgjithësisht ky program ka të përmbushura kriteret konform kërkesave ligjore në fuqi dhe në linjë me direktivat e manualit të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3


Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti luan një rol të madh dhe është përgjegjës në organizimin e stukturës, përmbajtjen e programeve të studimit ndarjen e ngarkesës mësimore. Njësia disponon informacione nëpërmjet ngarkesës mësimore, planit të punës dhe programin e aktiviteteve të programit "Bachelor" në "Studime Psikosociale". Departamenti Psikologjisë dhe Sociologjisë ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ku organizimi, struktura dhe përmbajtja e këtyre programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimet akademike si edhe në përputhje të plotë me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës. Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjësen e departamentit apo zyrën e këshillimit të studentëve dhe karrierës u vu re se burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi studimi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal, në përputhje me statutin e tij të brendshëm¹¹⁴, rregulloren e organizimit UMSH¹¹⁵ e cila është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore¹¹⁶ bazë¹¹⁷, si dhe atë të programit të studimit¹¹⁸.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë harton plane mësimore ku përfshihen informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor, mënyrat e vlerësimit të dijës etj. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Studime Psikosociale përmban planin mësimor ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor /jashtë auditorit. Ky plan mësimor¹¹⁹ është i bazuar në dy grupe lëndësh¹²⁰ a) lëndë të detyrueshme dhe b) lëndë me zgjedhje. Në dokumentin e Rregullores së programit¹²¹ të studimit Bachelor në Studime Psikosociale përcaktohen të gjitha modalitetet dhe rregullat e informacionet e nevojshme për programin e studimit, që nga kriteret e pranimi dhe deri në detaje mbi literaturën e lëndëve, shlyerjen e detyrimeve dhe të tjera kushte për frekuentimin e programit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjërë informativ, në të cilin paraqiten elementë si: kreditet për çdo veprimtari formuese, ngarkesa në auditor dhe ajo jashtë auditorit. Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlersuar në kredite (ECTS) duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse^{122, 123}.

¹¹⁴ Evidencë 1: Statuti UMSH 2022.

¹¹⁵ Evidencë 2: Rregullore e organizimit UMSH

¹¹⁶ Evidencë 6: Rregullore FDSHH.

¹¹⁷ Evidencë 8: Rregullore e Departamentit Psikologji-Sociologji.

¹¹⁸ Evidencë 7: Rregullore Bachelor SPS.

¹¹⁹ Evidencë 13.1: Plani mësimor

¹²⁰ Evidencë 8 :Rregullore e Departamentit

¹²¹ Evidencë 7:Rregullore Bachelor SPS

¹²² Evidencë 13.13.1. Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

¹²³ Evidencë 15:Tabela Përmbledhëse Ascal, tabela 9 fq.15

Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas mësimor	planit
A	Lëndë bazë	15–20% (kredite)	19% (kredite)	
B	Lëndë karakterizuese	50–55% (kredite)	52% (kredite)	
C	Lëndë ndërdisiplinore	12–15% (kredite)	13% (kredite)	
D	Lëndë plotësuese	10–15% (kredite)	11% (kredite)	
E	Detyrime përmbyllëse	3–5% (kredite)	4% (kredite)	

Bazuar në planin mësimor të programit të studimit rezultojnë se kurrikula e programit të studimit është e organizuar në lëndë, module, praktika, laboratore, orë të studimit individual, projekte etj, të cilat janë të shtrira në 3 vite akademike dhe të ndara në 2 semestra për çdo vit akademik. Përqindjet sipas tipologji të lëndëve mësimore të përlogaritura bazuar në Planin mësimor 2022-2023, të cilat krahasuar me përcaktimet në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”¹²⁴ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019¹²⁵, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021¹²⁶, përgjithësisht janë konform tyre, dhe përgjatë viteve akademike ka një angazhim të UMSH për ta përafëruar me standardet e kërkuara duke ruajtur masën e 20 % të lejuar. Kjo është e dukshme dhe në shqyrtimin e lëndëve në planin mësimor dhe të cituara dhe në planin mësimor¹²⁷ ku lënda me emërtim (a) “Konjicion Social” në vitin e dytë Bachelor është etiketuar “Psikologji Konjitive” me 7 kredite në të dy rastet, (b)

¹²⁴ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

¹²⁵ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UêZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

¹²⁶ Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, “Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/>. (Aksesuar më 09-09-2023).

¹²⁷ Evidencë 13.13.1: Plani mësimor tab.nr.2 dhe Veprimtaria formulese tab.nr.1

	Janë hequr lëndët me zgjedhje në vitin e tretë Bachelor “Marketing dhe Komunikim” dhe “Ergonomi” duke u zëvendësuar me lëndët “Sociologji e Lëvizja Emigratore”, Sociologji Politike” dhe “Sociologji Ekonomike” me 5 kredite ku dhe në këtë rast nuk ka ndryshuar numri i krediteve gjithashtu lëndët që kaluan nga lëndë të detyrueshme në lëndë me zgjedhje në vitin e tretë si “Sociologji e Lëvizja Emigratore”, Sociologji Politike” dhe “Sociologji Ekonomike” u zëvendësuan me lëndë si “Hyrje në Etikë”, “Psikologji Ligjore” dhe “Psikologji Anormale” po me 5 kredite. Siç shihet lëndët janë kryesisht të fokusuara dhe në fokusin e degës së studimit duke i dhënë më shumë studentëve të marin njohuri specifike në aspektin psikologjik dhe sociologjik ashtu si është dhe profili për të cilin ato studiojnë. Këto ndryshime gjithashtu paraqiten dhe me vendim¹²⁸ i cili propozohet nga departamenti Psikologjisë-Sociologjisë i cili më pas miratohet nga dekani.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” nëpërmjet dokumentacionit që shoqëron bazën materiale të këtij programi studimi siç janë Rregullorja e Programit¹²⁹, Relacioni i verifikimeve pritëse të UMSH¹³⁰, Rregullore e FDSHS, neni 44 procedura e transferimeve të studentëve¹³¹, Rregullore e FDSHS, neni 34 procedura e transferimeve të studentëve¹³² etj përshkruhen qartë procedurat e procesit të rekrutimit, aplikimit, regjistrimit, transferimit për aplikantët për ndjekje të një programi studimi, programi të dytë studimi. Në rregulloren mësimore të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ka të specifikuar kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit¹³³. Kjo rregullore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të përcaktuara në Strategjinë e zhvillimit¹³⁴ të programit të studimit, me planin e tij mësimor¹³⁵ si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Transferimi ndërmjet programeve kryhet në përputhje me politikën e Universitetit Mesdhetar, Statutin¹³⁶ dhe Rregulloren

¹²⁸ 7. Vendime që japin ndryshime të lëndëve në program

¹²⁹ Evidenca 7. Rregullore B.

¹³⁰ Evidenca 52. Relacioni i verifikimeve të godinës, 2023.

¹³¹ Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, neni 44 *Procedurë për Transferim Studimesh*

¹³² Evidenca 6: Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. neni 34 *rregjistrim për Program të Dytë Studimit.*

¹³³ Evidencë 7: Rregullore SPS Kreu III neni 11,12

¹³⁴ Evidencë 5: Strategjia e zhvillimit të programit SPS

¹³⁵ Evidencë 13, 13.1: Plani mësimor tabela nr.2

¹³⁶ Evidencë 1: Statuti UMSH neni 76

	e Universitetit Mesdhetar dhe Rregulloren e FDSHH¹³⁷. Studentët që ndjekin Programin “Bachelor në “Studime Psikosociale” mund të transferohen në një program të tjetër me kërkesë të tyre nëse është e lejueshme në varësi të kriterëve dhe rregullave të çdo programi studimi.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Studime Psikosociale” është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sitemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS. Bazuar në Planit Mësimor¹³⁸ të programit të studimit dëshmohej se komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite, sipas sistemit vendas e evropian, të ndara në tre vite dhe dy semestra për çdo vit akademik ku lëndët që zhvillohen janë të ndara në dy grupe¹³⁹ a) lëndë të detyrueshme dhe b) lëndë me zgjedhje. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike edhe në syllabuset e lëndëve mësimore. Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë nëpërmjet dokumentacionit pasqyron dokumentacionit shoqërues të RVB-së se mban në mënyrë sistematike dosjen e programit të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” në të cilën gjenden informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, seminarët apo leksionet, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me VKM 41, të ndryshuar. Programi i studimit përmban të gjitha syllabuset e detajuara si dhe formatet e miratuara. Sipas Statutit¹⁴⁰, rregullores së organizmit të UMSH, departamenti është përgjegjësia e njësisë bazë si dhe referuar rregullores së UMSH¹⁴¹, Kreu II, neni 4 mbi të drejtat dhe liritë themelore akademike si dhe titullarit të lëndës përkatëse që ka ngarkesën në programin respektiv për të vlerësuar dhe përditësuar syllabusin e programit për vitin e ri akademik. Por duhet theksuar se : <i>Në lidhje me këtë kriteri GJV nga verifikimi i syllabuseve vuri re se në syllabuset e lëndëve të vëna në dispozicion praktikantëve</i>

¹³⁷ Evidencë 6:Rregullore e FDSHH

¹³⁸ Evidencë 13.1:Plani mësimor

¹³⁹ Evidencë 8:Rregullore e departamentit neni 14

¹⁴⁰ Evidencë 1:Statuti UMSH

¹⁴¹ Evidencë 2:Rregullore e organizimit të UMSH, Kreu II, neni 4

	ndryshimit për vitet e depozitimit të dokumentacionit janë të pjesshme si në përmbajtje, ashtu edhe në propozim literature e cila duhet të rifreskohet me literaturë të viteve të fundit dhe të ketë referim të faqeve të literaturës në të cilën është marë literatura.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Institucioni ndjek procedura në drejtim të përmirësimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore ¹⁴² dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Studime psikosociale” duket se është objekt monitorimi nga njësia bazë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie nga Zyra e Këshillimit ZKSK ¹⁴³ , nëpërmjet fokus grupeve ¹⁴⁴ , gjithashtu përmirësimi i përmbajtjes së programit mësimor bazohet dhe në formularin e vlerësimit të pedagogut ¹⁴⁵ si dhe nga formulari i vetvlerësimit ¹⁴⁶ të pedagogut.			
Konkluzione	GVJ konstaton se nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion bazuar në përditësimin e syllabuseve me literaturë bashkohore ky standart përmbushet kryesisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

¹⁴² Evidenca-72-VKM nr.418, “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin e Programeve.

¹⁴³ Evidencë: 49:Rregullore e ZKSK

¹⁴⁴ Evidencë 30:Metodologjia e fokus grupeve të Departamentit të Studimeve Psikosociale

¹⁴⁵ Evidencë 24:Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studenti


¹⁴⁶ Evidencë 39:Aneksi A:Vetvlerësimi pedagogut

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi mësimor i Bachelor “Studime Psikosociale” është një program i kompletuar dhe i përgjithshëm që synon t’i japë studentëve të gjitha njohuritë e nevojshme për të zhvilluar e synuar zhvillimin e tyre të specializuar. Lëndët janë të përcaktuara dhe të shpërndara në mënyrë që të mundësojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve. GVJ pas njohjes me planin¹⁴⁷ mësimor të programit të studimit, programet lëndore sipas tipeve të veprimtarive konstaton se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për tu specializuar më tej si një ekspert në fushën e psikologjisë pasi % më e madhe e lëndëve është në aspektin psikologji se në atë social ashtu si është dhe etiketimi i këtij programi studimi. Këto aftësi do të bëjnë të mundur orientimin e studentëve drejt tregut të punës si psikologë dhe licesojnë ato në këtë drejtim por do të mundësojnë edhe orientimin e tyre drejt studimeve të thelluara të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Plani mësimor¹⁴⁸ i programit të studimit Bachelor në “Studime psikosociale” është i organizuar në tre vite me 60 kredite secili vit, në lënde të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje, praktikë e cila sipas vizitës në institucion u dëshmuua që zhvillohet jashtë në institucione dhe konsiderohet si lëndë e detyrueshme që vlerësohet me notë. Gjithashtu ky program reflekton një koherencë me parashkimet e akteve ligjore referuar planit mësimorë përsa i përket numrit të krediteve 180 ECTS, me 60 kredite për cdo vit akademik, duke respektuar ndarjen e ECTS me nga 30 ECTS në semestër, me kohëzgjatje normale në 3 vite akademike, tipologjia e lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregullores së UMSH¹⁴⁹. Shpërndarja e lëndëve në përgjithësi i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë, sociologjisë praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit në përgjithësi të japin mundësi për qartësi brenda fushës dhe thellim të njohurive dhe kompetencave praktike. Një balancë e ngjashme është bërë përpjekje të respektohet edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese.

¹⁴⁷ Evidencë 13.1:Plani mësimor, tabela nr. 2

¹⁴⁸ Evidencë 13.1:Planë mësimore, tabela nr.2

¹⁴⁹ Evidencë 2:Rregullore e organizmit të UMSH




	Gjithashtu lëndë si "Hyrje në ekonomi" dhe Histori e mendimit ekonomik" shihen si tepër të ngjashme kështu mund të rishihet si mundësi për rishikim. Gjithashtu bazuar në evidencat e mësipërme gjykojmë se vijimi i punës në lidhje me përshtatjen e kurrikulës së programit me standartet e cilësisë por edhe me ato ndërkombëtare (EuroPsy) kërkon një angazhim më të madh institucional. <i>në drejtim të përmirësimit të kurrikulës së programit të studimit në linjë me standartet e cilësisë.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Në strukturën e programit të studimit lëndët organizohen sipas tipeve të veprimtarive formuese: ndara sipas komponentëve mësimore përgjithësisht janë konform ligjit për arsimin e lartë¹⁵⁰ dhe duke u përpjekur të respektojnë elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Ndarje¹⁵¹ të tipit të komponentëve mësimorë sipas kategorisë: - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 19% (35 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 52 % (90 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 13 % (25 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 11 % (23 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 4 % (7 ECTS); Programi përfshin njohuri dhe shprehje që zhvillojnë aspektin teorik dhe praktik të rolit dhe funksionit profesional kryesisht në fushën e psikologjisë.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit Bachelor "Studime Psikosociale" është i organizuar në lëndë dhe module sipas veprimtarive formuese, në orë teorike dhe praktike që mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe në të cilin lëndët janë të vlerësuara sipas "Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve" (ECTS) duke mundësuar transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve. Nga vizita në institucion në sekretarinë mësimore rezulton se në programin e studimit ka patur transferime studimesh për periudhën 2020-2023 si: Viti akademik 2023-2023 numri transferimeve 15;

¹⁵⁰ Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri.

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBO TIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLE TORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-09-2023).

¹⁵¹ Evidencë 13: Plani mësimor tabela nr.1

	Viti akademik 2021-2022 numri i transferimeve 16; Viti akademik 2020-2021 numri i transferimeve 13; Viti akademik 2019-2020 numri i transferimeve 3; Ndërsa për mobilitetet gjatë bisedës me studentët ato pohuan se janë të informuar dhe ju janë ofruar shumë mundësi studimi në Erasmus+.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në Rregulloren e organizmit të UMSH ku theksohet liria mbi veprimtaritë kërkimore, programet e studimit ku kjo thekson faktin që përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve është përgjegjës për përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të programit të studimit, duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të pesë viteve të fundit”. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve në përmbajtjen e tyre synojnë marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, dhe institucioni ka të instaluar procedura e praktika për ndryshime të pjesshme brenda kaudrit rregullativ si për përmbajtjen, ashtu edhe për propozim literature bazë dhe ndihmëse.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në analizë të gjithë dosjes së programit të studimit, GVJ konkludon se përmbajtja e programit të studimit Bachelor “Studime Psikosociale” garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Programi synon të pajisë studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm edhe pse programi studimit është “Studime psikosociale” Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve duhet tu japin mundësi studentëve për fitimin e shprehive shkencore dhe profesionale në aspektin psikologjik dhe atë sociologjik. Aktivitete të ndryshme janë zhvilluar në këtë drejtim si Konferenca studentore¹⁵², tavolina të rrumbullakta¹⁵³ me të ftuar, aktivitete të realizuara nga Qendra e Mesdheut¹⁵⁴, etj. Vlen për t’u theksuar fakti që duke iu referuar disa elementëve që bazohen në disa lëndë apo në një mosbalancim të lëndëve bazuar në profilin e studimit apo dhe lëndë që kanë një literaturë të hershme mund të ndikojnë punën që realizhet në aspektin praktik falë aktiviteteve të ndryshme që zhvillon në rang Universiteti apo departamenti.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e	Programi i studimit “Studime Psikosociale” ofron një gamë të përgjithshme dhe karakterizuese, integruese duke i lidhur të gjitha këto me shumë disiplina të tjera apo edhe disiplina që

¹⁵² 11: Dokumenta mbi Konferencën studentore

¹⁵³ 10: Tavolina e Rrumbullakët me të ftuar

¹⁵⁴ 12: Aktivitete të Qendrës së Mesdheut

mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	formojnë aftësim. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe kriteret për licensimin e psikologëve sipas Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Nëse i referohemi planit mësimor ¹⁵⁵ kemi një ndarje midis veprimtarive formuese të ndërthurura me aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale gjithashtu mbështet nevojat e programit për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme përmes njohjes së terrenit të punës. Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit që janë si brenda dhe jashtë vendit ndihmon studentët të rriten profesionalisht si dhe i jep mundësi studentëve për të përzgjedhur institucionet e praktikës në linjë me interesat e tyre kërkimore dhe profesional. Duke iu referuar përmbajtjes së programit, ai mundëson vijimin e studimeve në ciklin e dytë të studimeve. Për të gjithë të diplomuarit në Bachelor "Studime Psikosociale" kërkohet edhe përfundimi i ciklit të dytë të studimeve me qëllim vijimin e procedurave për licesim dhe më pas punësimin e tyre.			
Konkluzione	<i>GVJ nisur nga verifikimi dokumentacionit dhe vizitës në institucion se ky standard përmbushet plotësisht, dhe përmbajtja e programit të studimit krijon kushtet për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të nevojshme në linjë me profilin e psikologjisë-sociologjisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për	Në shqyrtimin e dokumentacioneve dhe gjatë takimeve në institucion GVJ evidenton se DSPS se njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor "Studime Psikosociale" është

¹⁵⁵ Evidencë 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë, i cili duhet të konsultohet dhe mbështetet në përmirësimin e këtij programi studimi dhe në përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës në strukturën e ngritur nga UMSH sic janë marrëveshje bashkëpunimi¹⁵⁶ duke mbajtur zhvilluar takime me institucione dhe subjekte të ndryshëm mban takime periodike me aktorë të ndryshëm të përfshirë në realizimin e programit të studimit si: personeli akademik me kohë të pjesshme, fokus grupe¹⁵⁷ rrjeti ALUMNI,¹⁵⁸ institucionet partnere të praktikave dhe aktorë të tjerë të tregut të punës. Për realizimin e misionit të tij si në aspektin e përmbushjes së aspekteve kurrikulare edhe të angazhimit me profil shoqëror, Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë zhvillon <i>marrëveshje bashkëpunimi</i> në funksion të programit të studimeve të ciklit të parë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ në takimin me studentët konstatoi se studentët kishin një informi të mirë për Zyrën e Këshillimi të Studentit dhe Karrierës e cila akoma përforcohej dhe nga roli i Tutorialit.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në takimin me studentë të programit të studimit bachelor në "Studime Psikosociale" gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët mbajnë kontakte të rregullta me Departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë të cilët nëpërmjet fokus grupeve¹⁵⁹, formulari i vlerësimit të pedagogut¹⁶⁰ dhe kanë hapësirat e tyre të shprehjes së mendimeve rreth kurrikulës së programit të studimit, programeve lëndore dhe formave të vlerësimit. Departamenti nxit përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve për t'u angazhuar në dhënien e sugjerimeve që do të përmirësonin programin e studimit sin ë aspektin teorik dhe praktik. Në funksion të përmirësimit të programit të studimit, si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹⁶¹, Zyra e ZKSK¹⁶², fokus grupet, Tutoriatit, pyetësorëve me studentët¹⁶³ në lidhje me lëndën dhe pedagogët apo dhe nga vlerësimi i pedagogut nga autoritet¹⁶⁴ realizohet monitorimi dhe përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor dhe përmirësimi i syllabuseve dhe programit të studimit.

¹⁵⁶ Evidencë 10:Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimeve

¹⁵⁷ 18:Metodologjia e fokus grupeve DSPS

¹⁵⁸ Evidencë 47:Formulari Studenti Alumni

¹⁵⁹ Evidencë 30:Procedura e punës me fokus grupe

¹⁶⁰ Evidencë 24:Formulari vlerësimit të pedagogut nga studenti

¹⁶¹ Evidencë 34:Plani punës së NjSBCZHK

¹⁶² Evidencë 49:Rregullore e ZKSK

¹⁶³ Evidencë 24:Formular vlerësimi i pedagogut nga studenti

¹⁶⁴ Evidencë 28:Formular vlerësimi i pedagogut nga autoriteti drejtues

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Programi i studimit Bachelor “Studime Psikosociale” është një program i ciklit të parë të studimeve në fushën e Psikologjisë-Sociologjisë. Profesia e psikologut është në listën e profesioneve të rregulluara dhe rregullohet nëpërmjet Urdhrit të Psikologut. GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin ekzistues lidhur me ndryshimet në plan¹⁶⁵ program, evidenton që ka ndryshime një pjesë e tyre në emërtim por në numër krediti ky ndryshim nuk ka ndodhur. Ky ndryshim synon përshtatjen e kurrikulës me tregun e punës si dhe duke siguruar këtë program që studenti të këtë mundësi licensimi.			
Konkluzione	<u>GVJ</u> duke iu referuar dokumentave GVJ për këtë standard bazuar në rishikimin e programit evidenton se stafi akademik ka punuar në plotësimin dhe përshtatjen, si edhe me kreditet përkatëse bazuar në rëndësinë që lëndët kanë konform degës që ato ofrohen, por për të garantuar cilësinë e dëshiruar sygjerohet rritja e përfshirjes së studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Në lidhje me përmbushjen e këtij standardi GVJ gjykon se ky standard <u>përmbushet kryesisht.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

¹⁶⁵ Evidencw 13.1:Plani mwsimor, tabela nr.2




Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në shqyrtimin e dokumentacionit nga syllabuset¹⁶⁶ se programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës dhe paraqiten për miratim në fillim të çdo viti akademik në Departament. Plani mësimor i programit të studimit përmban peshën specifike të orëve të leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave institucionale dhe orëve individuale për çdo lëndë të programit të studimit. Nga ana tjetër, programi i lëndës përmban objektivat, konceptet themelore të lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, detyrimet e studentit për punime individuale si ese ose detyra kursi, detajimin e përmbajtjes së lëndës sipas orëve në dispozicion për cilindo komponent mësimor si leksione, seminare, praktika e laboratore. Rregullorja e programit¹⁶⁷ ka të paraqitura “Format e mësimdhënies” si leksione, seminare, praktika mësimore apo profesionale, laboratorë që zhvillohen në grupë mësimore me numër studentësh, numri i të cilëve miratohet nga Ministri përgjegjës për arsimin dhe rregulloren e universitetit. Në vijim të saj “Praktika profesionale¹⁶⁸” synon krijimin e kushteve për njohjen e një mjedisi real ku student të aplikojë njohuritë e tij teorike dhe ti jepet mundësia për orientimin për sigurimin e një vendi pune dhe mbi tregun e punës. Në Rregulloren¹⁶⁹ e organizmit të Departamentit theksohet se praktika profesionale sipas specifikimit të degës dhe departamenti sëbashku me dekanin e fakultetit janë përgjegjës për realizimin e praktikës profesionale të studentit të cilët e bashkëpunojnë me njësinë ndihmëse të UMSH dhe zyrën e Këshillimit të Karrierës. Për të pasur informacione më të detajuar mbi funksionimin dhe realizimin e praktikave është hartuar Udhëzuesi i praktikës¹⁷⁰. Në udhëzuesin e praktikës theksohet që praktika ndiqet nga pedagogët këshillues të karrierës të cilët ndjekin ecurinë e zhvillimit të praktikës konform zbatimit të kërkesave të programit të praktikës. Në këtë udhëzues citohet se njësia bazë është përgjegjëse për ndërtimin dhe respektimin e programit të praktikës si dhe granton kontaktin me institucionet që shihen më afër programit të studimit dhe më pas i jepet studentëve lista e institucioneve që UMSH ka marrëveshje ishtitucionale¹⁷¹, e cila i jep mundësi studentëve të kryejnë praktikën. Zyra e këshillimit të karrierës informon studentët për mënyrën e zhvillimit të praktikës ku pedagogë të trajnuar nga UMSH dhe ekspertë të ftuar nga njësia bazë zhvillon orë
---	---

¹⁶⁶ Evidencë 13.2: Syllabuse 2,3,4

¹⁶⁷ Evidencë 7: Rregullore Bachelor “Studime Psikosociale” neni 17

¹⁶⁸ Evidencë 12: Udhëzues për praktika

¹⁶⁹ Evidencë 8: Rregullore e departamentit neni 26

¹⁷⁰ Evidencë 12: Udhëzues për praktikën

¹⁷¹ Evidencë 15: Tabela Përmbledhëse Ascal, tabela 5 fq.9

	praktike në auditor. Studenti në fund të seancave në auditor dorëzojnë dosjen e plotë të pedagogu përgjegjës vlerësimi, i të cilët realizohet nga komisioni për mbrojtjen e praktikës duke qënë se ajo vlerësohet me notë. Në plotësimin e dosjen studenti në studimet Bachelor duhet të ketë : a) Përshkrimi i dijeve që ka përvetësuar gjatë orëve në auditor b) Hartimi i një letre interesi për një vend pune c) Një interviste pune (improvizuar ose reale) me shkrim d) CV në formatin Europass Gjithashtu në rregulloren¹⁷² e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane është përcaktuar dhe mënyra e diplomimit të studentëve e cila finalizohet nëse ka marrë 180 ECTS (kredite) dhe më pas ka të drejtë të pajiset me Diplomë Bachelor. Diplomimi realizohet me provim përfundimtar formimi ose me mbrojtje temë. Udhëheqësi¹⁷³ i temës përcaktohet nga njësia bazë dhe miratohet nga Dekani. Në fund pas përfundimit studenti pajiset me¹⁷⁴ Diplomë "Bachelor" "Studime Psikosociale". <i>GVJ evidenton se në programin e studimit dhe në rregulloren e departamenti ka një detajim të elementëve përshkruar mbi ecurinë e realizimit të mënyrës së vlerësimit të studentëve mbi lëndën.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi programet e lëndëve GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit bazuar në lirinë akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara. Edhe në programet e lëndëve pasqyrohen disa forma aktivizimi të studentëve, që nga vlerësimi i ndërmjetëm deri të aktivizimi dhe demonstrimi i aftësive në role-play, detyra individuale dhe në grup apo dhe prezantime. Në bisedat e zhvilluara gjatë takimit u konfirmua një larmi formash mësimdhënieje për të trajtuar materialin mësimor në mënyrë të larmishme, duke e diferencuar edhe sipas nevojave të studentëve duke evidentuar zbatimin praktik të mënyrave të shumta të mësimdhënies si tryeza të rrumbullakëta¹⁷⁵, punë në grup, diskutime, punimi i një detyre kursi, ese etj.

¹⁷² Evidencë 6: Rregullore FDSHH, Kreu X, neni 51

¹⁷³ Evidencë 6: Rregullore e FDSHH: Kreu X neni 52

¹⁷⁴ Evidencë 37: Diploma

¹⁷⁵ 10: Dokumenta që vërtetojnë aktivitetet, tavolina të rrumbullakta

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike kjo shihet me anë të përgatitjes së dokumentave përkatëse si udhëzues për praktika¹⁷⁶, udhëzues¹⁷⁷ për procedurat dhe afatet e provimeve, udhëzues për studentin¹⁷⁸ duke dhënë me detaje të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që ka studenti si në nivel institucional dhe në atë mësimor. Gjithashtu në Rregulloren¹⁷⁹ e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Rregulloren¹⁸⁰ e departamentit tregohet qartë se institucioni ka organizuar një strukturë organizative në mënyrë të tillë që të inkurajojë, lehtësojë dhe për të qënë sa më produktiv dhe profesional brenda departamentit grupe mësimore, shkencore dhe monitoruese. Këto grupe mësimore të cilët kanë një përgjegjësi që zgjidhet nga përgjegjësi departamentit dhe miratohet nga decani FDSHH përbëhen nga dy persona ku këtu mund të bëjnë pjesë dhe pedagogë të departamenteve të tjera meren me hartimin dhe bashkërendimin e programeve mësimore, hartimin e palneve të programeve të punës shkencore, hartimin e temave të diplomës etj. Gjithashtu institucioni mbështet personelin akademik edhe përmes strukturave monitoruese si fokus grupeve¹⁸¹, formularëve¹⁸² të vlerësimit të pedagogut nga studentët, leksioneve të hapura etj.¹⁸³, trajnimeve¹⁸⁴, manualeve të platformës elektronike¹⁸⁵ etj.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues,	Duke iu referuar CV-së¹⁸⁶ së personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie kanë kualifikime dhe kontribute univeristare, artikuj të botuar në revista shkencore vendase e të huaja, pjesëmarrje në konferenca e kongrese shkencore, sipas fushave të ekspertizës së angazhimeve të tyre në procesin mësimor. Kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik, të cilët shprehen me nota pozitive. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës, profili i tyre duhet të integrohet më mirë me nevojat e programit të studimit dhe me rregullat e fushës së kompetencës së personave të angazhuar¹⁸⁷ në lëndë

¹⁷⁶ Evidencë 12:Udhëzues për praktika

¹⁷⁷ Evidencë 22:Udhëzues për procedurën dhe afatet e sezonit të provimeve

¹⁷⁸ Evidencë 21:Udhëzues për studentin

¹⁷⁹ Evidencë 6:Rregullore e FDSHH

¹⁸⁰ Evidencë 8: Rregullore e departamentit neni, 11,12

¹⁸¹ Evidencw 30:Procedura e fokus grupeve

¹⁸² Evidencw 24: Vlerwsimi pedagogut nga studenti

¹⁸³ Evidencw 19:Leksione tw Hapura

¹⁸⁴ Evidencw 26:Programi i trajnimeve

¹⁸⁵ Evidencw 31:Manual i platformws elektronike

¹⁸⁶ Evidencw 13.3:CV e stafit akademik

¹⁸⁷ Evidencw 13.2:Syllabuse

atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	dhe module specifike, pasi profili i tyre del jashtë fushës së psikologjisë në disa raste, duke qenë në profile të përafërta. Vlen të theksohet fakti që gjatë bisedës në institucion me stafin akademik dhe me studentët gjithashtu rezultojnë që edhe teknologjia luan një rol të rëndësishëm, duke mundësuar prezantimin e materialeve mësimore audio-vizive, të cilat sigurojnë një mjedis të qëndrueshëm të nxënë të orientuar me në qëndër studentin dhe të udhëhequr e mbështetur nga pedagogu në mënyrë që studentët të krijojnë argumenta dhe analiza të qëndrueshme teorike, duke respektuar mendimin e lirë dhe duke konsoliduar respektin ndaj njëri-tjetrit. por kjo tregohet dukshëm nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënieve pedagog –student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë bashkëpunimi pozitiv, profesional duke krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e njohurive, fitimin e elekuencës e cila mundësohet nga dhënia e mundësisë nëpërmjet diskutimeve mbi tematika të ndryshme si dhe stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit. <i>GVJ rekomandon njësinë bazë dhe UMSH që përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë në një profil kualifikimi të psikologjisë-sociologjisë me qëllim që të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe shprehi punë tek studentët në linjë me profilin për të cilin po studiojnë. Kjo qasje pritët të ketë një ndikim pozitiv në mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndëve mësimore si dhe pasqyrimi i aspektit praktik dhe në syllabuse mbi realizimin e procesit mësimor, realizimit të prezantimit të detyrave të kursit si dhe temave të diplomës.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me stafin e, Departamentit Psikologji dhe Sociologjisë vërehet se elementët e vlerësimit të punës së departamentit mësimdhënia dhe cilësia e saj është një nga komponentët bazë. Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së zhvillimit të karrierës¹⁸⁸, nga funksioni dhe roli i tutorit¹⁸⁹, përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces, bazohet në realizimin e fokus grupeve¹⁹⁰, vlerësimin e pedagogëve nga studentët¹⁹¹ ka

¹⁸⁸ Evidencë 49: Zyra e ZKSK

¹⁸⁹ 17: Vendim për zgjedhje e Tutorit

¹⁹⁰ Evidencë 30: Procedura e punës me fokus grupe

¹⁹¹ Evidencë 24: Vlerësimi pedagogut nga studenti

dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	një dhe komisionit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional ¹⁹² si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie përmes një sër formash monitorimi ^{193,194,195, 196} . Përfshirja e studentit në vlersimin periodik ¹⁹⁷ të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët e cila realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies ku përvec pyetësorëve realizohet edhe përmes fokus grupeve, bisedave me tutorin etj.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes mundësisë për të marrë pjesë në konferenca të ndryshme, krijimit të bashkëpunimeve ¹⁹⁸ me institucione të tjera të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë Vendlit si dhe bashkëpunime me programin ERASMUS +. Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës ¹⁹⁹ , Alumni dhe Karrierës, Grupet mësimore brenda departamentit, Tutorit ²⁰⁰ . Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, RVB-së dhe vizitës në institucion, konstaton se Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë garantojnë</i>

¹⁹² Evidencë: 34-Plani i Punës së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBCZHK.

¹⁹³ Evidencë 28:Formulari i vlerësimit të pedagogut nga organet drejtuese.

¹⁹⁴ Evidencë 47: Formular Studentë Alumni.

¹⁹⁵ Evidencë 39:Aneksi A:Formulari i vetvlerësimit individual

¹⁹⁶ 18:Metodologjia e fokus grupeve DSPS.

¹⁹⁷ Evidencë 24:Formular i vlerësimit të pedagogut nga studenti

¹⁹⁸ Evidencë 10:Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit

¹⁹⁹ Evidencë 49: Rregullore e ZKSK

²⁰⁰ 17:Vendim të zgjedhje së Tutorit

	<i>krijimin e strukturave, politikave dhe mundësive që krijojnë kushte të përshtatshme për mësimdhënie cilësore dhe në koherencë me zhvillimin si në apsketin teorik dhe praktik si në marjen e informacioneve dhe teknikave, strategjive që duhen përdorur në aspektin profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në Rregulloren ²⁰¹ e departamentit, Rregulloren e Programit të Studimit ²⁰² , në Rregulloren e organizimit të UMSH ²⁰³ në Rregulloren FDSHS ²⁰⁴ në të cilën pasqyrohet sistemi i vlerësimit të studentit, formatin e punimit të diplomës dhe provimit të formimit të përgjithshëm. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale. Edhe në syllabusin e lëndëve përcaktohet mënyra e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet që ata kanë në secilën lëndë. Aty thuhet qartë që në vlerësimin e arritjeve të studentit, pedagogu mbështetet në përfundimet e vlerësimit të vijueshëm, në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, detyra kursi.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në hartimin e lëndëve të detyrueshme dhe me zgjedhje të programit të studimit “Bachelor “Studime Psikosociale”, në Rregulloren ²⁰⁵ e programit të studimit si dhe në syllabuset e lëndëve jepet një informacion i qartë mbi procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët. Nga materiali i prezantuar në RVB dhe nga takimet me studentë rezultoi se në javën e parë të çdo semestri studentëve ju prezantohen nga pedagogët e lëndës syllabuset e lëndëve duke pasqyruar objektivat dhe qëllimet lëndore,

²⁰¹ Evidencë 8:Rregullore e departamentit neni 19

²⁰² Evidencë 7: Rregullore SPS Kreu V neni 20, 21 Kreu VI neni 23

²⁰³ Evidencë 2:Rregullore e organizimit të UMSH neni 61, 63,68 Kreu X neni 73

²⁰⁴ Evidencë 6:Rregullore e FDSHH Kreu III, neni 37, 38, 39 Kreu X neni 51 pika 3

²⁰⁵ Evidencë 7:Rregullore e SPS

	rezultatet e të mësuarit, metodat e mësimdhënies, metodologjinë dhe komponentët e vlerësimit të studentit dhe dijeve të tij profesionale në përfundim të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe e rekomanduar për studim. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet detyrave të kontrollit që zhvillohen 2-3 herë në javë, detyrës së kursit dhe provimit përfundimtar duke e përcaktuar vlerësimin me notë në disa elementë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecursisë së kursit gjatë semestrit²⁰⁶. GVJ lidhur me vlerësimin e studentit konfirmon se ajo bëhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet detyrave të kontrollit, apo dhe testeve të ndryshme që zhvillohen 2-3 herë në javë, detyrës së kursit dhe provimit përfundimtar.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive²⁰⁷ përmes vlerësimit nga kontrole të pjeshme për 2-3 tema (50%), detyrat e kursit (20%) dhe provimi përfundimtar (30%). Formati i tezës²⁰⁸ së hartuar për matjen e njohurive bazohet në pyetje përshkruese, shpjeguese dhe vlerësuese. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimimet e ndërmjetme, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma, për programin e studimit.
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të studimit në studimeve psikologji-sociologjike. UMSH dhe njësia kryesore/bazë përmes strukturave të saj synon të angazhohet në monitorim dhe nxitje të stafit në drejtim të vlerësimit dhe përmirësimit të formave të mësimdhënies. Në lidhje me këtë kriter kemi takimet me fokus grupet²⁰⁹, bisedat e zhvilluara me Tutorin²¹⁰, Zyra e Këshillimit të Karrierës²¹¹ edhe përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti²¹² ku ky pyetësor zhvillohet në fund të cdo semestri dhe rekomandimet që dalin prej tij dorëzohen në Rektorat dhe zyrës së Burimeve Njerëzore dhe formulari i vlerësimit të performances nga organet drejtuese²¹³, formular

²⁰⁶ Evidencë 13.2: Syllabuset Bachelor "Studime Psikosociale"

²⁰⁷ Evidencë 13.2: Syllabuset Bachelor "Studime Psikosociale"

²⁰⁸ Evidencë 23: Model teze

²⁰⁹ Evidencë 30: Puna me fokus grupe

²¹⁰ 17: Vendim të zgjedhjes së Tutorit

²¹¹ Evidencë 49: Rregullore e ZKSK

²¹² Evidencë 24: Formular për vlerësimin e pedagogut nga studenti

²¹³ Evidencë 28: Formular për vlerësimin e pedagogut nga organet drejtuese

	vetvlerësimi ²¹⁴ që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe zhvillimin, përmirësimin kurrikular dhe përmirësimin sa më cilësor të procesit mësimor.			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit. UMSH duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka zhvilluar një gamë aktivitete dhe është angazhuar në krijimin e hapsirave të nevojshme për stafin akademik por edhe të studentëve në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie ²¹⁵ , gjithashtu në këtë drejtim një rol ndihmës japin larmia e aktiviteteve psh; aktivitete të krijuara nga Qendra e Mesdheut ²¹⁶ , tavolina të rrumbullkta ²¹⁷ , konferenca, trajnime ^{218,219} , mobilitete të stafit ^{220,221} , leksione të hapura ²²² . Të cilat sigurojnë me studentët frymën e bashkëpunimit dhe përfshirje të vazhdueshme të partnerëve për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies të stafit akademik dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj. GVJ konstatoi se marrëdhëniet pedagogë – studentë, karakterizohen nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi që lehtësohet nga numri jo shumë i lartë i studentëve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të punës dhe të respektit të ndërsjellë mes tyre.			
Konkluzione	GVJ konstaton se UMSH, FDSHH në rregulloren e studimeve dhe DSPS në rregulloren e programit të studimit për Bachelor në "Studime Psikosociale" kanë hartuar dhe zbatojnë procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²¹⁴ Evidencë 39: Aneksi A: Vetvlerësimi individual

²¹⁵ 3: Analizë vjetore të Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë.

²¹⁶ 13: Aktivitete të organizuara nga Qendra e Mesdheut

²¹⁷ 10: Dokumenta që tregojnë realizimin e tavolinave të rrumbullkta

²¹⁸ Evidencë 26: Programi i trajnimeve

²¹⁹ 10: Dokumenta që tregojnë trajnime

²²⁰ 6: Evidencë e levizjes së stafit akademik dhe administrativ

²²¹ 14: Dokument i certifikimit të Erasmus Charter.

²²² Evidencë 19: Leksione të hapura DPS

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës dhe vlerësimi në provën përfundimtare provim/ testim. Elementët, pesha specifike në përqindje të notës përfundimtare, dhe format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe testimit përfundimtar shprehen në mënyrë eksplicite në programet e lëndëve. Vlerësimi përfundimtar i shprehur në notë i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë semestrit, bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit si pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi i studentit në DSPTS bëhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet detyrave të kontrollit që zhvillohen 2-3 herë në javë, detyrës së kursit dhe provimit përfundimtar duke e përcaktuar vlerësimin me notë në disa elementë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit²²³. Llojet e vlerësimit si: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve. Provimi në DSPTS sipas Rregullores së departamentit, Rregullores së SPS zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar²²⁴ ku vlerësimi bëhet me pikë prej 10 notash ku nga 0-4 është notë jokaluese dhe nga 5-së e lart notë kaluese.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet e ndërmjetme, detyra kursi, provimi përfundimtar Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive të studentëve ku pyetjet që testimi përmban janë me natyrë përshkruese, shpjeguese dhe vlerësuese e cila zhvillon aspektin e njohurive si në aspektin teorik dhe atë praktik²²⁵. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit Bachelor në “studime psikosociale”. Nëpërmjet platformave të ndryshme elektronike pedagogët zhvillojnë dhe quize të ndryshme.

²²³ Evidencë 13.2: Syllabuset Bachelor “Studime Psikosociale”

²²⁴ Evidencë 8 :Rregullore departamenti SPS neni 18

²²⁵ Evidencë 23:Model teze




Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në rregulloren e UMSH, në rregulloren e DSPS, programit SPS theksohet se vlerësimi²²⁶ është ekuivalenca sipas vlerësimit të njohurive apo dijeve të grumbulluara nga student dhe të materializuara në tezën e provimit dhe nota është rezultat i kombinimit të elementëve të procesit mësimor. Tezat e provimit hartohen nga titullari lëndës sëbashku me pedagogun që zhvillon mësimin dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe në mungesë të tij firmoset nga përgjegjësigruplëndës. Pasi ka filluar provimi në sallë nuk mund të hyjë askush përveç Dekanit ose Rektorit për të kryer një kontroll²²⁷. <i>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, por edhe nga takimet që GVJ zhvilloi në institucion, konstatohet se ka procedura mbi monitorimin e vlerësimit përfundimtar të lëndës në përputhje me syllabusin, me qëllim që të shmangen abuzimet.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i vazhdueshëm dhe provimet e ndërmjetme u evidentuan nga takimet me studentët dhe personelin akademik si element të rëndësishëm të procesit të “korrigjimit” të mangësive nëpërmjet shkëmbimit të komenteve të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e rezultateve të studentit në provën finale dhe në të ardhmen. Në rregulloren e departamentit²²⁸ çdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlerësim të notës. Nëse studenti ka ankesë për notën ai bën një ankimimim me shkrim të cilën e dorëzon në sekretarinë mësimore drejtuar dekanit. Nëse dekani verifikon se ka vlerësim të gabuar ngrihet komisioni posaccëm, i cili bën rivlerësimin e tezës ose rimer studentin në provim. Realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar dhe në mënyrë të strukturuar që t’u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxënës.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Kodin e Etikës²²⁹ përcaktohet qartë se studenti nuk duhet të kopjojë gjatë procesit mësimor. Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave të zhvillohet me përpikmëri provimi.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale	Rregullorja e organizimit në UMSH²³⁰ parashikon të drejtën për ankimim të rezultatit dhe procedurës së vlerësimit dhe realizimit të provimit nga ana e studentit, duke garantuar të

²²⁶ Evidencë 8:Rregullore e Departamentit SPS neni 19, neni 20

²²⁷ Evidencë 8:Rregullore e Departamentit neni neni 21

²²⁸ Evidencë 8:Rregullore e Departamentit neni 23

²²⁹ 5. Kodi etikës neni 7 pika f

²³⁰ Evidencë 2:Rregullore e organizimit të UMSH

bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e departamentit²³¹ dhe në syllabusin e lëndës²³². Gjithashtu kontrolli i cilësisë realizon kontrole lidhur me trasparencën në vlerësimin me notë duke monitoruar komponentët e caktuar të krahasimit të vlerësimit të realizuar nga stafi akademik për lëndë specifike. Në praktikën e komunikimit të vlerësimit në programin e studimit evidentohen aspekte të komunikimit pozitiv që ju mundësojnë studentëve të jene ballë për ballë me pedagogun e lëndës në momentin e komunikimit të vlerësimit dhe të konsultimit të menjëhershëm të çdo pakënaqësie të mundshme mbi vlerësimin.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlerësim të notës. Ankimi kryhet me shkrim dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore drejtuar dekanit i cili bën një vlerësim dhe nëse është gabuar në vlerësim ngrihen komisione të posaçme. konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe nga takimet e zhvilluara në ambjentet e UMSH me stafin akademik dhe studentët u vu re se Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit²³³. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi Bachelor "Studime Psikosociale" nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të rregullores së posaçme të studimeve në UMSH siguron një mjedis ndërveprimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve që mundëson dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</i>

²³¹ Evidenca 8. Rregullore Departamentit Psikologji-Sociologji.

²³² Evidencë 13.2-Syllabuset Bachelor Studime Psikosociale.

²³³ Evidenca 7. Rregullore Bachelor Studime Psikosociale.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi studimeve Bachelor “Studime Psikosociale” është pjesë e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, i cili është i organizuar sipas studimeve me kohë të plotë dhe në tre vite si dhe mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe ²³⁴ . Objektivat formuese të këtij program formues janë sa teorik dhe praktik dhe synon formimin e specialistëve në fushën e sociologjisë dhe psikologjisë ²³⁵ . Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një kurrikule të pasur si në aspektin teorik edhe në atë praktik. Ai garanton thellimin e njohurive, aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Për thellimin e dijeve në praktikën profesionale në vitin e tretë studentëve ju ofrohet Praktika e cila zhvillohet nga pedagogët përgjegjës dhe nga hulumtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit shihet një gamë e gjerë institucionesh ku studentët kanë mundësi të kryejnë praktikën. Aftësitë shkencore dhe dijet në fushën e kërkimit studentët i testojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të lëndëve nëpërmjet kontrolleve të pjeshme, detyrës së kursit dhe provimit përfundimtar.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Teknologjia e informacionit rezulton të jetë një ndihmesë e informacioneve ndihmëse në funksion të programit të studimit, por edhe në funksion të zhvillimit të aftësive të komunikimit digjital. Në programet lëndore fondi i literaturës së detyrueshme dhe më shpesh literaturës së rekomanduar është në gjuhë shqipe por edhe në gjuhë të huaj, kryesisht gjuhën angleze, duke krijuar kështu një mundësi të shtuar për studentët e programit të studimit për të zhvilluar aftësitë e tyre edhe gjuhë të huaj në përputhje me fushën e studimeve duke qënë se në Universiteti Mesdhetar në Statutin e UMSH, neni 71, thekson se Universiteti ofron programe bashkëpunimi nëpërmjet një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë

²³⁴ Evidencw 7:Rregullore e Studimeve Psikosociale neni 2,3

²³⁵ Evidencw 7:Rregullore e Studimeve Psikosociale neni 4

	Brenda ose jashtë vendit në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara dhe legjislacionin në fuqi. Kjo bën që në përfundim të studimeve të lëshohet një diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse ²³⁶ .
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës përmes udhëzimeve të vecanta dhe vlersimit të njohurive në përfundim të semestrit përkatës. UMSH dhe njësia kryesore/bazë përmes strukturave të saj synon të angazhohet në monitorim dhe nxitje të stafit në drejtim të vlerësimit dhe përmirësimit të formave të mësimdhënies. Në lidhje me këtë kriter kemi takimet me fokus grupet ²³⁷ , bisedat e zhvilluara me Tutorin ²³⁸ , Zyra e Këshillimit të Karrierës ²³⁹ edhe përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti ²⁴⁰ ku ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri dhe rekomandimet që dalin prej tij dorëzohen në Rektorat dhe zyrës së Burimeve Njerëzore dhe formulari i vlerësimit të performances nga organet drejtuese ²⁴¹ , formular vetvlerësimi ²⁴² që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe zhvillimin, përmirësimin kurrikular dhe përmirësimin sa më cilësor të procesit mësimor. Raporti i punës semestrale analizohet nga ana e çdo pedagogu në përfundim të lëndës së tij duke u ndalur në në sër aspektesh që kanë të bëjnë me mësimdhënien, mësimnxënien, rezultatet e dala nga feedbacku i studentëve, të cilat më tej përmbledhen në analizën vjetore të departamentit ²⁴³ .
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që u jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë dhe zhvillimin e shprehive duke prekur aspektet praktike në një gamë lëndësh të detyruara dhe me zgjedhje. Kjo u bazua në bisedat e zhvilluara nga stafi dhe takimi me studentët. Përsa i përket referimit të syllabuseve të lëndëve mësimore ²⁴⁴ ku një pjesë e madhe të tyre nuk përmbajnë elementë praktik të zhvillimit të leksioneve si prezantim në power-point, role play, punë në grupe etj. Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me

²³⁶ Evidenca 1: Statuti UMSH, neni 71

²³⁷ Evidencë 30: Puna me fokus grupe

²³⁸ 17: Vendim të zgjedhjes së Tutorit

²³⁹ Evidencë 49: Rregullore e ZKSK

²⁴⁰ Evidencë 24: Formular për vlerësimin e pedagogut nga studenti

²⁴¹ Evidencë 28: Formular për vlerësimin e pedagogut nga organet drejtuese

²⁴² Evidencë 39: Aneksi A: Vetvlerësimi individual

²⁴³ 3: Analizë e punës vjetore Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë.

²⁴⁴ Evidencë 13.2 Syllabuset Bachelor Psikologji -Sociologjise.

punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	institucionet e tjera ka nisma me institucione si brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga UMSH si konferenca, ëorkshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie²⁴⁵ Gjithashtu ka një klimë pozitive të ndërveprimit midis stafit dhe studentëve për çështjet mësimore. Procesi i mësimdhënies bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënies në tërësi.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i programit të studimit Bachelor “Studime Psikosociale” është vazhdimisht i interesuar për të qënë pjesë e diskutimeve shkencore mes profesionistëve të fushës duke marrë pjesë në²⁴⁶ aktivitete shkencore si brenda edhe jashtë vendit, duke u informuar mbi zhvillimet e reja në fushën e tyre të ekspertizës dhe në fushën e studimeve psikosociale duke qënë se pjesë e stafit janë dhe pjesë eksperte apo anëtarë të Urdhrit të Psikologut ku me informimet për t’u bërë psikolog i licensuar studentët janë në koherencë të vazhdueshme. Universiteti UMSH për personelin akademik, efektiv dhe me kontratë ka zhvillur dhe zhvillon mobilitete²⁴⁷ të stafit dhe studentëve përmes projekteve dhe ²⁴⁸marrëveshje të ndryshme institucionale si brenda dhe jashtë vendit. Përgjatë vitit akademik janë realizuar një sër aktivitetsh akademike e shkencore si trajnime, konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar vendas apo të huaj, veprimtari promovuese Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari. Personeli akademik i programit të studimit dëshmon të jetë një urë lidhëse ndërmjet informacioneve më të fundit të shkencës dhe teknologjisë dhe studentëve të programit të studimit. Personeli akademik i integron këto dije në strukturën e programeve lëndore dhe temave mësimore ose i shpërndan këto njohuri nëpërmjet orëve të hapura të zhvilluara edhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke qënë të angazhuar vetë si lektorë ose edhe duke ftuar kolegë vendas e të huaj ekspertë në fusha të ndryshme që

²⁴⁵ 3:Analizë e punës vjetore e Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë.

²⁴⁶ 3:Analizë e punës vjetore e Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë

²⁴⁷ 2:Dokumenta mbi levizjen e stafit për mobilitet

²⁴⁸ Evidencë 15:Tabela Përmbledhëse Ascal , tabela nr.5

	lidhen me programin e studimit.			
Konkluzione	GVJ bazuar në sa më sipër, konkludon se programi i studimit Bachelor në "Studime Psikosociale" garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke realizuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët dhe institucioni ka ngritur strukturat në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e organizimit të Universitetit të UMSH-së ²⁴⁹ theksohet se në përfundim të ciklit të parë të studimeve ku studenti mer 180 kredite duhet të diplomohet ku diploma mbrohet me temë ose me provim formimi. Në Rregulloren e Programit të Studimeve Psikosociale ²⁵⁰ theksohet se studenti në përfundim të këtij programi mësimor diplomohet ku diplomimi zhvillohet me provim formimi ku studentët pajisen me Diplomë Bachelor "Studime Psikosociale". Në rregulloren e UMSH nuk ka të përcaktuar notën mesatare për të cilën studenti ka të drejtë të mbrojë temë diplome si dhe në listën e dokumentacioneve përkatëse si dhe nuk ka një rregullore specifike të diplomimit por ka udhëzues.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane si struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit siguron që personeli akademik të asistojë në mënyrë të vazhdueshme diplomantët duke ju vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. Kjo realizohet nga Tutori, përgjegjësi grupeve mësimore ose dhe grupët mësimore.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin	Nga vizita në institucion me stafin akademik në lidhje me administrimin e provimit final u pasyrua mbështetja konform

²⁴⁹ Evidencë 2: Rregullore e organizimit të UMSH Kreu X, neni 51 pika 3

²⁵⁰ Evidencë 7: Rregullore e SPS Kreu VI, neni 23




e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	me procedurat e njësishë bazë mbi administrimin e provimit final komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterit ku për secilën kategori mund të ofrohen një numër i ndryshëm pyetjesh. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Në Statut²⁵¹ theksohet se shefi departamentit ngre një komision të cilën ia propozon dekanit për të qënë në provim formimi ose mbrojtje teme diplome. <i>GVJ në shqyrtimin e dokumentacionit dhe në rregulloren e departamentit dhe programit mësimor konstaton se ka elementë tregues mbi procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së provimit final, mënyrës së ngritjes së një komisioni duke përfshirë të gjitha lëndët që ofron programi.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga takimi me stafin akademik u vu re se stafi akademik ofron mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta në provimin e formimit. Ato i pajisin studentët me pyetje orientuese²⁵². Kjo përfshin ndihmë si dhe realizimin në mënyrë rigoroze të mbështetur në procedurat e njësishë bazë mbi administrimin e provimit final ku komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterereve. Në hartimin e pyetjeve përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jashtë institucionit, janë dhënë dokumenta si listë marrëveshje bashkëpunimi por duhet theksuar se ka shumë pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me një bashkëpunimin të tillë. Përsa i përket bashkëpunimit brenda kemi një sërë komponentësh si aksesimi në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të	Nga biseda me anëtarët e stafit të Departamenti të Psikologjisë-Sociologjisë u theksua fakti që Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Përbërja e komisionit të vlerësimit

²⁵¹ Evidencë 1: Statuti UMSH, neni 38 pika f.

²⁵² Evidencë 17: Pyetje orientuese për provimin e formimit

mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	dhe kryetari i tij propozohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i përcillet Dekanit të Fakultetit për miratim. Komisioni në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës/provimit të formimit bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat regjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohen studentëve. Nota përfundimtare si rregull përcaktohet me pëlqimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Studime Psikosociale” është konform ligjeve dhe procedurave të QSHA-së për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave. Forma e paraqitjes së diplomës është konform profilit dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listë notash dhe suplementin e diplomës; në programin e studimit “Bachelor në “Studime Psikosociale” ²⁵³ . Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin e tij. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave kërkimore e profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë referuar nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga bisedat me stafin akademik Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studentit, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti i Mesdhetar i Shqipërisë, Fakulteti i Shkencave të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departmenti Psikologjisë dhe Sociologjisë ka të përcaktuar elementë mbi vlerësimin e provimit të formimit dhe të mënyrës se si ngrihet komisioni. Theksohet fakti se në dokumentacionet shoqëruese dhe udhëzimet e vazhdueshme vërehen edhe elementë mbi notën specifike të studentëve që kanë të drejtë të</i>

²⁵³ Evidencë 37,38 :Modeli diplomës dhe suplementi diplomës




	<i>hyn në provim me temë apo me diplomë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në	Referuar vlerësimit të dokumentacionit ²⁵⁴ (Statuti i Institucionit, Kreu VII) rezulton se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi ²⁵⁵ dhe nga për këtë program studimi Bachelor në “Studime Psikosociale” ^{256, 257, 258} personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës ²⁵⁹ . Përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në program lidhur me lëndët që mbulojnë ²⁶⁰ , gjykojmë se të dhënat bazohen vetëm në CV ²⁶¹ e stafit PAE/PAK të angazhuar në këtë program studimi dhe nga dosjet e personelit të shqyrtuara gjatë vizitës ²⁶² ditore pranë BNJ. Nga CV e shqyrtuar rezulton se një pjesë e konsiderueshme e stafit akademik ka kualifikimin akademik në drejtimin Psikologjik, dhe në fushat specifike të

²⁵⁴ <https://www.umsh.edu.al/media/618bc57039d44.pdf> ;

²⁵⁵ Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 45, Pika 3.

²⁵⁶ Evidencw 7. Rregullore SPS.pdf

²⁵⁷ Evidencw 8. Rregullore departamenti.pdf

²⁵⁸ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

²⁵⁹ Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 59, pika 6.

²⁶⁰ Evidencw 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

²⁶¹ Evidencw 13.3. Cv e stafit akademik.pdf

përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

saj, me kualifikimet dhe ekspertizat përkatëse, por jemi të mendimit se stafi me formim Social, është në numër i ulët, gati i papërfillshëm. Vetë orientimi i programit “Studime Psikosociale”, orienton për një fushë studimi të balancuar ndërmjet asaj psikologjike dhe asaj sociale dhe formimi i studentëve nga staf akademik me profile specifike (vetëm të fushës së psikologjisë mund të ketë impakt negative në fokusin e cilësisë së mësimdhënies. Shqetësim për t’u adresuar është dhe fakti se janë evidentuar raste kur pedagogë, të cilët i përkasin kategorisë “Msc” ose “Doktor”, janë titullarë të lëndëve dhe moduleve (Msc. N.M., Dr.V.T., etj) ^{263, 264, 265}.

Bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” për tre vite akademike është si më poshtë vijon:

Tituj/grada	2020 – 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE
Prof.Dr	1	1	1	1	1	1
Prof.As.Dr	-	-	-	-	-	1
Dr/PhD	3	10	2	9	3	8
Msc		5	1	4	1	5
Nëtotal	4	16	4	14	5	15

Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik:

- Për 2020-2021, 75 % e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 25% janë Msc;
- Për 2021-2022, 73% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 27% janë Msc;
- Për 2022-2023, 70% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 30% janë Msc;

Spektori i Burimeve Njerëzore²⁶⁶ i cili ka si mision të siguroj menaxhim efektiv të burimeve njerëzore kanë të dhënat për personelin e angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Ky sektor sipas rregullores kujdeset për kushtet e punës, merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me

²⁶³ Evidencë 13.2. Syllabuse 2.pdf

²⁶⁴ Evidencë 13.2. Syllabuse 3.pdf

²⁶⁵ Evidencë 13.2. Syllabuse 4.pdf

²⁶⁶ Evidencë 1. Statuti UMSH.pdf, Kreu VII Punësimi në UMSH

	kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik, kontratat e punës²⁶⁷. Përpilon dokumentacionin për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe bën shënimet përkatëse në këto librezat. Përgjigjet për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit, mban dokumentacionin e plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon. Të dhënat mbi kualifikimet dhe arritjeve akademike ruhen në Departament, dhe të aktivitetit mësimor-shkencor. Nga vizita²⁶⁸ në institucion dhe përzgjedhja rastësore e dosjeve të stafit akademik efektiv dhe të jashtëm rezultojnë se dosjet personale me të dhëna të plota ruhen dhe administrohen sipas parashikimeve ligjore. <i>GVJ duke u bazuar në disa të dhëna të plota mbi stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi gjykon se si çështje e cila ka nevojë të adresohet është evidentimi i përfshirjes së stafit akademik me kualifikim akademik social, dhe më specifikisht Punë Sociale dhe Sociologji, për realizimin e disa lëndëve dhe moduleve në këtë program studimi si dhe hartimi i syllabuseve të lëndëve nga anëtarët e stafit të cilët nuk kanë kualifikimin e duhur (formimin përkatës, social psikologjik apo titujt shkencor) për të hartuar e miratuar programin e lëndës. Të dyja këto aspekte shihen me impakt negativ në implementimin e njohurive të thelluara dhe kompetencave profesionale tek studentët e këtij programi studimi.</i>												
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga analiza e informacionin të deklaruar në tabelat 12.1-12.3 të RVB²⁶⁹, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë: <table><tr><th>Viti Akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>80 %</td><td>20 %</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>80 %</td><td>20 %</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>85 %</td><td>15 %</td></tr></table> Personeli akademik me kohë të pjesshme mbulon gjithsej 285 mësimore (15%) orë (tabela 12.3) nga 1895 orë total në auditor (tabela 10)²⁷⁰ dhe pjesa tjetër mbulohet nga personeli akademik	Viti Akademik	PAE	PAK	2020-2021	80 %	20 %	2021-2022	80 %	20 %	2022-2023	85 %	15 %
Viti Akademik	PAE	PAK											
2020-2021	80 %	20 %											
2021-2022	80 %	20 %											
2022-2023	85 %	15 %											

²⁶⁷ Evidencë 40. Kontratat e Punës tip.pdf

²⁶⁹ Evidencë 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

²⁷⁰ Evidencë 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

	me kohë plotë, Referuar standardeve për personelin akademik të IAL-së, ai duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës²⁷¹ mësimore për çdo program studimi dhe nga përlllogaritja e orëve në auditor rezulton se për këtë program rezulton se gërma b) e pikës 2 të udhëzimit zbatohet plotësisht. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor në IAL dhe specifíkisht orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë²⁷² dhe me raste specifike ka të përcaktuar procedurën, ndërkohë nga analiza e dokumentacionit të paraqitur (tabela 4) rezulton se stafi PAE i angazhuar në këtë program mbulon orë mësimore që variojnë nga minimum 195 (Msc.N.F.) orë mësimore në maksimumin 285 orë mësimore (Dr.K.R) duke respektuar kriteret ligjore dhe mos e kaluar mbingarkesën e 200 orëve suplementare. Përsa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, ai mund të mbulojë ngarkesën vjetore 120 orë në auditor dhe nuk mund të ketë orë suplementare²⁷³ dhe në këtë program mësimor janë të angazhuara tre PAK me nga 105 në 120 ²⁷⁴ orë mësimore në auditor duke mos tejkaluar parashikimet e pikës 2 të Udhëzimit 29. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në 2 semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore²⁷⁵. Masivisht i gjithë stafi është me 2-3 lëndë semestrale²⁷⁶. <i>GVJ gjykon se ngarkesa si e PAE ashtu dhe PAK është konform parashikimit ligjor të VKM-së "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë".</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (kontratat, mbështetja me projekte afatgjata, etj.) institucioni përgjithësisht garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv²⁷⁷, ²⁷⁸, ²⁷⁹ që janë pjesë e njësisë bazë. Lidhur me stafin e angazhuar në programin e studimit²⁸⁰, për të gjithë periudhën e akreditimit

²⁷¹ Vendimit Nr. 418, datë 10.5.2017, Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre, pika 2, gërma b)

²⁷² Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, II, pika 1

²⁷³ Udhëzimi 29, datë 10.09.2018, pika 2

²⁷⁴ Evidencë 15. Permbledherse e Tabelave.pdf

²⁷⁵ Udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018, pika 6.

²⁷⁶ Evidencë 15. Permbledherse e Tabelave.pdf

²⁷⁷ Evidencë 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

²⁷⁸ Evidencë 3. Organigrama.pdf

²⁷⁹ Evidencë 13.3. Cv e stafit akademik.pdf

²⁸⁰ Evidenca 40. Kontratat e Punes tip.pdf

programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	vlerësojmë këtë si aspekt pasi të dhënat përgjithësisht dëshmojnë qëndrueshmërinë e personelit akademik²⁸¹ efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore²⁸². Edhe nga takimi me pedagogët gjatë vizitës në institucion²⁸³ na u konfirmua si qëndrueshmëria shumë vjeçare e tyre por dhe plotësimi i dokumentacioneve ligjore mbi punësimin. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata paafat dhe është i punësuar pranë IAL prej vitesh. Nga vizita në institucion dhe konsultimi me materialet e DVV u konfirmua se dhe prej vitesh UMSH kishte të njëjtat marrëdhënie me stafet. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë të reflektuara në aktet normative e rregulative të institucionit²⁸⁴, ²⁸⁵ dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015²⁸⁶, Kodin e Punës në RSH dhe aktet ligjore e normative në fuqi. Gjithashtu edhe sektori i burimeve njerëzore ka të standartizuar politikat dhe procedurat për qëndrueshmërinë dhe statusin e personelit²⁸⁷.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Institucioni ndjek një procedurë rekrutimi²⁸⁸ për personelin akademik transparente²⁸⁹, të bazuar në merita²⁹⁰ dhe me angazhimin e disa sektorëve²⁹¹. UMSH²⁹² shpall konkursin për vënde të lira punë, referuar kërkesave të cilat ju vijnë nga Departamenti, sipas nevojave të evidentuara, dhe njoftimi bëhet jo vetëm në faqen Web të Institucionit, por dhe në të rrjetete sociale apo dhe në portale të tjera të ndryshme punësimi, si dhe në rrjetin e bashkëpunëtorëve²⁹³ ²⁹⁴. Zyra e burimeve njerëzore pranon aplikimet, verifikon dokumentacionin e paraqitur, nëse është në përputhje me dokumentacionin e shpalur në thirrjen

²⁸¹ Evidenca 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

²⁸² Shënime nga vizita në institucion.

²⁸³ Shënime nga vizita në institucion.

²⁸⁴ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

²⁸⁵ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

²⁸⁶ Evidenca-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.pdf

²⁸⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

²⁸⁸ Evidenca 35. Procedura e rekrutimit.pdf

²⁸⁹ <https://www.umsh.edu.al/d/386/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise> ; <https://www.umsh.edu.al/d/387/konkurs-per-vende-pune-prane-qendres-mesdheu>

²⁹⁰ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Kreu VII, (punësimi në UMSH)

²⁹¹ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, Kreu V.

²⁹² Evidenca 35. Procedura e rekrutimit.pdf

²⁹³ <https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise>

²⁹⁴ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 39,40 & 41.

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	për aplikimi dhe njofton Departamentin përkatës për përmbylljen e kësaj faze. Më pas është një komision <i>ad hoc</i> i cili ka në përbërjen e tij një shumicë të përfaqësuesve të departamentit, i cili vijon me procedurat, siç janë intervistat dhe vlerësimet e tjera. Sipas dokumentacionit të dorëzuar ky komision ka përgjegjësinë të kujdeset për rekrutimin e stafit me aftësi, njohuri dhe ekspertizë e eksperiencën e duhur për të ndihmuar UMSH dhe Departamentin në arritjen e objektivave të tij (verifikim i një procedure)²⁹⁵. Kjo zyrë kujdeset që njësia bazë të marr vendimin në bazë të kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik²⁹⁶, Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj. Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të UMSH-së janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të Institucionit dhe përzgjedhja bëhet me dy faza. Faza e parë është vlerësimi i dosjes, pasi secili kandidat paraqet personalisht kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, ku komisioni i ngritur nga Rektori bën vlerësimin paraprak të kandidaturave sipas kërkesave. Faza tjetër është ajo e intervistimit të kandidatëve, në përfundim të së cilës komisioni dërgon në formë propozimi për miratim në Rektorat kandidatin e përzgjedhur. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur, duke garantuar një process transparent, të paanshëm dhe objektiv²⁹⁷. Duke iu referuar përzgjedhjes së stafit akademik në linjë me modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit duhet të kihet parasysh dhe përzgjedhja e stafit me kualifikim akademik brenda profilit social, pasi ai psikologjik dhe i fushave të përafërta është mëse i mjaftueshëm. <i>GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me</i>
---	---

²⁹⁵ Shënimet gjatë vizitës në Istitucion

²⁹⁶ Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf

²⁹⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

	<i>rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vizita në institucion si dhe referuar strukturës akademike dhe ndihmës akademike, numrit të studentëve dhe të infrastrukturës në shërbim të këtij programi²⁹⁸, gjykojmë se UMSH plotëson më së miri nevojat e studentëve të këtij programi studimi duke garantuar angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të kësaj dege. Në lidhje me këtë kriter dhe duke analizuar mjediset në dispozicion, laboratorin e psikologjisë edhe kurrikulën e programit të studimit²⁹⁹ konstatojmë se nuk ka orë laboratorike, por institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore dhe të laboratorit, i cili përdoret në ndihmë të procesit mësimor. Institucioni ka ndërtuar një strukturë të tërë ndihmës akademike dhe sektorë mbështetës³⁰⁰ të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e mjediseve në përdorim të studentëve³⁰¹. Komunikimi me stafin e pranishëm në takim gjatë vizitës në institucion³⁰² na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedurë që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjëse për infrastrukturën dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të studentëve e stafit të angazhuar.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, nëpërmjet strukturave të tij dhe konkretisht nëpërmjet Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë ³⁰³ dhe Zyrës të Burimeve Njerëzore ³⁰⁴ garanton menaxhim efektiv të personelit të angazhuar në programin e studimit “Studime Psikosociale”. Zyra e burimeve njerëzore ³⁰⁵ është struktura përgjegjëse për organizimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e procedurave të punësimit të personelit të ri, si dhe atë të promovimit të personelit efektiv. Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për ndjekjen e procesit të matrikullimit për të gjithë studentët e UMSH-së; monitoron databazën elektronike qendrore të UMSH-së; kontrollon e mban përgjegjësinë për hedhjen e të dhënave në Regjistrin

²⁹⁸ Evidenca 3. Organigrama.pdf

²⁹⁹ Evidenca 13 dhe 13.1 Plani mesimor SPS.pdf

³⁰⁰ Evidenca 13 dhe 13.1 Plani mesimor SPS.pdf

³⁰¹ Evidenca 25. Relacion i Verifikimit të godinës.pdf

³⁰² Shënime gjatë vizitës në institucion

³⁰³ Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf

³⁰⁴ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 38

³⁰⁵ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, & <https://www.umsh.edu.al/media/64590637c8d80.pdf>

të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e lëshimit të diplomave; merr masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit sipas legjislacionit; përpilon statistikën dhe të dhënat rreth studentëve; mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon.; ndjek daljet në pension të të gjithë personelit sipas legjislacionit dhe kryen veprimet përkatëse; nxjerr të dhënat e personelit që i nevojiten drejtuesve të institucionit, si dhe strukturave të tjera në kuadrin e studimeve të aktiviteteve të miratuara nga Rektorati; nxjerr të dhëna mbi personelin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, kur këto i kërkojnë nga drejtuesit e institucionit apo drejtoritë të tjera të Administratës së Rektoratit³⁰⁶. Zyra e burimeve njëzëre³⁰⁷ merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik si dhe plotësor dhe ruan dosjet personale të personelit të UMSH-së; gjithashtu organizon dhe ruan evidencat e vlerësimeve periodike. Departamenti dhe ky sektor dhe mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër³⁰⁸. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik^{309, 310} si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosjet e personelit akademik dhe vërejtje se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të	UMSH ka nënshkruar marrëveshje me një sërë institucionesh dhe organizatash të tjera me qëllim krijimin e gjithë infrastrukturës së nevojshme për realizimin e praktikave profesionale, përmbylljen e studimeve të diplomës dhe të aktiviteteve të tjera formuese për programin e studimit “Studime Psikosociale”^{311, 312}. Rregullorja e praktikës profesionale përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve. Praktikën mësimore³¹³ profesionale realizohen në

³⁰⁶ Evidenca 46. Rregullore e sekretarisë mesimore.pdf

³⁰⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 38

³⁰⁸ Evidenca 15. Permbledhese e tabelave.pdf

³⁰⁹ Evidenca 15. Permbledhese e tabelave.pdf

³¹⁰ Evidenca 13.3. Cv e stafit akademik.pdf

³¹¹ Evidenca 10. Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf

³¹² <https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe>; <https://www.umsh.edu.al/c/182/erasmus->

³¹³ Evidenca 12. Udhezues për praktikën.pdf

kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	institucione të ndryshme private ose publike me të cilët universiteti ka marrëveshje³¹⁴ dhe për këtë proces ka dhe një udhëzues të dedikuar³¹⁵. Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. UMSH-ja ka angazhuar personel, personel akademik dhe kërkues, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ. Personeli akademik me gradë shkencore “Doktor i Shkencave” dhe “Master Shkencor” janë angazhuar në role të ndryshme si atë të kordinatorit, udhëheqësit për temën e diplomës supervizorit të praktikës dhe veprimtarish të tjera specifike sipas nevojave dhe natyrës të këtij programi studimi.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	UMSH-ja ka nënshkruar një sër marrëveshjes institucionale³¹⁶ të lidhura me institucione dhe organizata në funksion të realizimit të filozofisë së tij, e cila është ndërtimi i një komuniteti, mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës. Ashtu siç dhe na u konfirmua nga vizita në institucion, këto marrëveshje janë gjithashtu dhe një mundësi më tepër për përmbushjen e objektivave formuese në funksion të procesit mësimor për programin “Studime Psikosociale”. Mbështetja e studentëve është e pakushtëzuar nga ana e UMSH-së duke ju mundësuar atyre një sër kontaktesh³¹⁷, ndërsa duke qene se ky program nuk ka një fokus të mirëfilltë aplikativ, ende nuk ka strukura të mirëfillta për të garantuar praktikën profesionale të studentëve të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale <i>GVJ i sygjeron institucionit të ndërtojë politika specifike për organizimin e praktikës për Programin “Studime Psikosociale”, duke përcaktuar në to dhe mënyrën e përzgjedhjes së personelit mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, me detyrimet përkatëse të studentëve për t’u përmbushur gjatë praktikave dhe me kriteret e vlerësimit</i>
Konkluzione	GVJ referuar dokumentacionit në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë programi studimi na lejon që të shprehemi se ai përmbush standardet sasiore, ndërsa përsa i

³¹⁴ Evidenca 10. Lista e Marreveshjeve te bashkepunimit.pdf

³¹⁵ Evidenca 12. Udhëzues per praktikat.pdf

³¹⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe>

³¹⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/124/kontakte-te-nevojshme>

	përket kualifikimit të posaçëm akademik gjykojmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë kualifikimin akademik në profilin psikologjik dhe vetëm një pjesë e vogël në disiplina të përfaqësuara, jo veçanërisht sociale (sociologji apo sociologji a punë sociale) duke mos qenë të barazpeshuar me profilin e këtij programi studimi "Studime Psikosociale", e cila mendojmë se ndikon në garantimin e standardeve të mësimdhënies së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është një institucion që siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse³¹⁸. Aktiviteti i tij ushtrohet në dy kampuse në 2 godina, ku i Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, i cili ofron programin e studimit "Studime Psikosociale" e përmbushin këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse³¹⁹. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhjeje dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka janë të akomoduara në mjediset e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre³²⁰. Mësimi në Programin e studimit Bachelor në "Studime Psikosociale" ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra

³¹⁸ Evidenca 15. Permbledhje e Tabelave.pdf (Tabela 16)

³¹⁹ Evidenca 25. Relacion i Verifikimit te godines.pdf

³²⁰ Evidenca 25. Relacion i Verifikimit te godines.pdf

	dhe një sallë laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënësve ³²¹ .
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në institucion konfirmojmë se të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, whiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike ³²² . Mjediset mësimore në dispozicion të programit të studimit "Studime Psikosociale" janë salla për leksion; klasa për seminare; sallë për aktivitete promociionale; një laborator për lëndët me orë praktike, ku realizon takimet "Klubi i Mirëqënie";, të cilat janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet), që mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Vlen të përmendet fakti se institucioni ka një vëmendësim ndaj të gjithë nevojave të studentëve, duke ju krijuar akses në të gjithë mjediset e tij edhe studentëve me nevoja të veçanta ³²³ .
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit DVV rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga IAL janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme ³²⁴ , të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Programi i studimit kryen aktivitetin e tij në Godinën Kryesore ku institucioni siguron hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit ³²⁵ . Mjediset mësimore, auditorët, janë të mirëpajisura me tabela dhe dërrasa dhe në çdo klasë ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si PC, videoprojektor, TV, kamera dixhitale dhe pajisje CD /DVD/VHS) ³²⁶ . Rrjeti i internetit është shtrirë në të gjithë mjediset e universitetit, në mjediset mësimore dhe në të gjitha mjediset e tjera rrethuese. Në institucion ndodhet dhe zyra e IT, e cila asiston me teknologjinë e informacionit në të gjithë rastet e nevojshme, por gjithashtu asiston dhe studentët me nevoja të veçanta dhe ushtron veprimtari sipas manualit përkatës ³²⁷ . Në universitet funksionon dhe Sistemi i Menaxhimit të Studentëve ³²⁸ , i cili

³²¹ Shënime gjatë vizitës në institucion

³²² Shënime gjatë vizitës në institucion

³²³ Evidenca 18. Rregullore për studentet me aftësi ndryshe.pdf

³²⁴ Evidenca 25. Relacion i Verifikimit të godinës.pdf

³²⁵ Evidenca 15. Përmbledhje e Tabelave.pdf

³²⁶ Shënime gjatë vizitës në institucion

³²⁷ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformës elektronike.pdf

³²⁸ http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar

	është një sistem IT i ndërveprimit mes institucionit dhe studentëve. Klasat dhe auditoret e UMSH-së janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies, sisteme që mundësojnë përditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor. Më shumë se 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave ku realizohet mësimi është me dritare, duke garantuar ndriçim natyror dhe ajrosje të mjaftueshme.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Kur flasim për profesionistë të fushës psiko-sociale dhe programin e studimit i cili i referohet këtij dimensionit profesional, jemi në një fushë të shkencës të aplikuar dhe si e tillë ndikimi laboratorik nuk është aq i rëndësishëm sa ndikimi praktik, i cili këshillohet të realizohet nëpërmjet seminareve ose në mënyrë më të drejtpërdrejtë nëpërmjet praktikës profesionale në institucione³²⁹. Në mjediset e institucionit ka një mjedis laboratorik, pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve³³⁰ sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Labororet e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij program studimi³³¹, janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe janë të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sërë aplikacionesh dhe programesh teknologjike si SPSS, Jetstore, ESC apo dhe Exceller, T-Translator, Ginger. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovozove, interenti apo edhe tabelat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e

³²⁹ Evidenca 7. Rregullore SPS.pdf

³³⁰ Evidenca 25. Relacion i Verifikimit të godines.pdf

³³¹ Evidenca 15. Permblodhje e Tabelave.pdf

	objektivave formues të programit të studimit punonjës social.			
Konkluzione	<i>GVJ konkluton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe fushës së studimit në psikologji, duke gjykuar se ky standart përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë në gjuhën shqipe³³², e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin tekste të cilat nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore të vënë në dispozicion krijojnë hapsira për përmirësim. Një pjesë e literaturës bazë gjykohej si literaturë akademike, dhe pse jo e 5 viteve të fundit, jo e përditësuar duke mos plotësuar marrjen e dijeve bashkëkohore nëpërmjet leksioneve të vënë në dispozicion nga pedagogu i lëndës. Por duhet balancuar literatura psikologjike me atë sociologjike si dhe duhen referuar botime të viteve të fundit, ashtu dhe autorë vendas. Përsa i përket literaturës në formë elektronike³³³ në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online³³⁴ rezulton se për nevojat e studentëve janë vënë në dispozicion një sër platformash elektronike si Open Dissertation dhe Directory of Open Access Journals, të cilat mund të lehtësojnë aksesin në burime bibliografike të viteve të fundit dhe që janë publikime shkencore të indexuara dhe me faktor impakti. Sfidë për studentët e këtij programi studimi mbetet niveli i njohurive në gjuhën angleze me qëllim që të përfitojnë nga këto mundësi që u krijohen nga insititucioni, të cilat vijnë të përmirësohen³³⁵. <i>GVJ sugjeron se ky aspekt garantohet, por ka ende hapsira për</i>

³³² Evidenca 13.2. Syllabuse 2.pdf ; Evidenca 13.2. Syllabuse 3.pdf & Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf

³³³ Evidenca 42. Material per biblioteken.pdf

³³⁴ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

³³⁵ Evidenca 43. Kerkese per libra.pdf

	<i>përmirësim duke rishikuar programet e studimit me përmirësime mbi literaturën bazë dhe të detyruar të përditësuar me tekste akademike psikologjike dhe veçanërisht ato sociale të 5 viteve të fundit.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Duke iu referuar dokumentacionit të DVV-së të shqyrtuar, një tjetër aspekt lidhet me kërkesën e fundit për tituj nga ana e njësisë bazë për vitin 2022-2023 sipas të cilës ka dhe metodologji për përzgjedhjen e teksteve për këtë department³³⁶. Duke iu referuar burime të literaturës në format libër, të depozituar dhe të aksesueshëm lirisht nga stafi dhe studentët e këtij programi studimi kemi³³⁷ të dhëna të përgjithshme të numrit të kopjeve në bibliotekën e institucionit, të cilat janë kryesisht në gjuhën shqipe dhe disa në gjuhë huaj. • Numri i titujve fizikë në fondin e bibliotekës: 4200; • Numri i kopjeve: 26424; • Numri i teksteve elektronike: 327000. Nga vizita në bibliotekë sezulton se aty ka investime për mënyrën e aksesimit të librarive online, por dhe hapësirë fizike, vendqëndrime për lexime, kompjutera me akses të drejtëpërdrejtë në literaturë, apo për infrastrukturën në përgjithësi³³⁸. Një pjesë e konsiderueshme e botimeve të përditësuara të bibliotekës së UMSH janë botime të vetë stafit akademik. <i>GVJ sygjeron që të adresohet sa më herët pasurimi me literaturë të përditësuar në gjuhën shqipe me tekste akademike psikologjike dhe sociale. Të përpilohen rregullore dhe të forcohen politikat e institucionit të cilat të përcaktojnë procedurat për përditësimet e literaturës të silabuseve dhe reflektimin e tyre në fondin e bibliotekës dhe aksesimin nga studentët e programit studime psikosociale.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UMSH-së³³⁹ është në dispozicion të studentëve dhe operon pa pagesë për të gjithë studentët e universitetit. Në këtë Institucion³⁴⁰ gjenden gjithsej 4 salla biblioteke, me një sipërfaqe prej 157 m², gjë e cila garanton akses dhe mundësi të barabartë shfrytëzimi për të gjithë studentët e këtij institucioni, përfshi dhe ata të programit të studimit “Studime Psikosociale”. Biblioteka e vizituar nga GVJ-ja ndodhej në

³³⁶ Evidencë-121-Metodologjia e përzgjedhjes së teksteve Departamenti Psikologji.pdf

³³⁷ Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf

³³⁸ Evidenca 42. Material për bibliotekën.pdf

³³⁹ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

³⁴⁰ Evidenca 15. Permbledhje e Tabelave.pdf, Tabela 16

	katin 0 të godinës qëndrore të universitetit, me mbi 50 vende leximi dhe 20 poste për shfrytëzimin e bibliotekës on-line³⁴¹. Biblioteka mbulon një sër shërbimesh si arkivim të çdo kopje të libri të ri fizik që hyn, dixhitalizim të skedarëve, arkivim të punimit të diplomës, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen me literaturën mësimore³⁴², kërkimore dhe ekstrakurrikulare, me një fond mbi 4000 titujsh në gjuhë të huaj dhe në shqip³⁴³. Orarat për ditët e javës dhe gjatë fundjavës janë 8.00-16.00. Si një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, ajo mundëson kërkim të informacionit “online”, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. GVJ konfirmojnë që ambjenti ishte i përshtatshëm me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Studentët kanë të drejtë të huazojnë libra dhe të përdorin shërbimet e bibliotekës gjatë gjithë kohës.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë funksionon sipas Ligjit Nr. 8576, datë 3.2.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve rregullative të institucionit. Literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin një literaturë e vënë në dispozicion paraqet disa mangësi në shumëllojshmëri, kryesisht atë sociale dhe të punës sociale. Janë bërë investime mbi hapësirat fizike dhe mbi infrastrukturën në përgjithësi. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online. Gjithashtu ka shërbime në platforma dhe link-et për aksesimin e bibliotekave ndërkombëtare online³⁴⁴. Biblioteka është pjesë e EIFL – Electronic Information for Libraries dhe platformës elektronike Edëard Elgar Publishing si pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit ashtu dhe me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Prej vitit 2022 kjo bibliotekë është anëtare e

³⁴¹ Shënime gjatë vizitës në institucion

³⁴² Shënime gjatë vizitës në institucion

³⁴³ Shënime të vizitës në institucion

³⁴⁴ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

	Cobiss.net, një ndërtues sistemesh bibliotekare të informacionit³⁴⁵. <i>GVIJ sygjeron që të merren masat e nevojshme nga organet drejtuese të Universitetit në mënyrë që për të gjithë modulet e veprimtarive mësimore të programit "Studim Psikosociale" në bibliotekë të gjenden, tekstet mësimore bazë, literatura ndihmëse, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të përditësuara referuar specifikës së programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Kapacitetet e bibliotekës garantojnë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë e pa pagesë nga të gjithë studentët e programit të studimit dhe nga i gjithë stafi akademik. Biblioteka përfaqësohet në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë "COBISS.AL", dhe koleksioni i saj përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU. Institucioni ofron platformën e bibliotekës digjitale ULibrary në linkun http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php me kredencialet e vete universitetit. Shërbimi i informacionit elektronik ofrohet me e-mail/katalog elektronik. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesit të platformat online.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka në godinën një hapsirë të konsiderueshme, lehtësisht të aksesueshme dhe me mbi 20 vende leximi. Biblioteka gjithashtu është e pajisur me programet kompjuterike të shërbimeve të bibliotekës dhe me pajisjet teknike si kompjutera me akses në internet³⁴⁶. Në këtë bibliotekë mundësohet shfrytëzimi i sistemeve me bazë "kod në burim të hapur", si modul i sistemit të integruar për menaxhimin e fondit të Bibliotekës katalogu online.uamd.edu.al³⁴⁷; njëkohësisht regjistrimet gjenden edhe pranë Bibliotekës Virtuale të Shqipërisë https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search?db=udu Studentët para se të aksesojnë librarinë online duhet të jenë të regjistruar në sistemin e menaxhimit të informacionit të UMSH-së. Për përdorimin e bibliotekës online në dispozicion të studentëve dhe të të interesuarve janë në dispozicion punonjëset e bibliotekës për lehtësimin dhe asistimin në

³⁴⁵ Evidenca 42. Material per biblioteken.pdf

³⁴⁶ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

³⁴⁷ <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>

	shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë literaturën e nevojshme, si dhe një manual për shfrytëzimin e të gjithë fondit online të vënë në dispozicion nga institucioni për studentët ³⁴⁸ . Dhe për çdo pyetje apo paqartësi studentët nxiten të kontaktojnë në Bilbioteka Dafina Meshi dafinameshi@umsh.edu.al ³⁴⁹ .
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 08.00 – 16.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Oraret e shërbimit janë të shpallura në hyrje të bibliotekës, e cila ka një hapësirë të dedikuar. Nga vizita në bibliotekë konfirmohet se punonjëset e saj ishin duke kryer procese pune, të gatshme t'i shërbenin të interesuarve. Sipas punonjësve të bibliotekës ky orar krijon kushte optimale për akses tek fondi i librave. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar. Të gjithë të interesuarit mundet gjithashtu që të vihen në kontakt me punonjësit e bibliotekës dhe të kërkojnë shërbime dhe informacione edhe më të specializuara. ³⁵⁰ .
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të	Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion në DVV ³⁵¹ , ³⁵² , ³⁵³ , ³⁵⁴ , ³⁵⁵ , ³⁵⁶ , ³⁵⁷ për programin e studimit “Studime Psikosociale”, dhe vizitës në institucion ³⁵⁸ u informuam se njësia përgjegjëse për programin dhe biblioteka periodikisht kanë hartuar kërkesat për përditësimin e fondit fizik, të cilat janë përmbushur nga institucioni, nga ku rezultojnë se falë Qendrës Mesdheu, një qendër kërkimore shkencore e themeluar në Qershor 2007 nga studiues të shkencave ekonomike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare prej vitit 2016 rezultojnë se është pasuruar fondi i librave, por nga një analizë e shpejtë e titujve reflektohet mungesa e literaturës dedikuar specifikisht dimensionit social, por gjenden literatura bazë dhe ndihmëse të fushës sociale. Përsa i përket fondit të librave online ai është rritur dhe

³⁴⁸ Evidenca 42. Material per biblioteken.pdf

³⁴⁹ <https://www.umsh.edu.al/c/124/kontakte-te-nevojshme>

³⁵⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/124/kontakte-te-nevojshme>

³⁵¹ Evidenca 42. Material per biblioteken.pdf

³⁵² Evidenca 42. Material per biblioteken.pdf

³⁵³ Biblioteka Online- <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

³⁵⁴ Evidenca 43. Kerkese per libra.pdf

³⁵⁵ <https://usia.al/e-library/> (Qendra Mesdheu)

³⁵⁶ <https://www.umsh.edu.al/d/181/botime-umsh-press>

³⁵⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 30

³⁵⁸ Shënime gjatë vizitës në institucion

studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	përditësuar, kjo dhe falë bashkëpunimeve dhe projekteve; kështu biblioteka dixhitale Edward, Cobiss, The Company of Biologists numëron akses në një mori platformash online³⁵⁹ me një fond të pakushtëzuar dhe të përditësuar. Gjithashtu edhe aksesit i pakushtëzuar në https://usia.al/ garanton akses në më shumë se 1000 revista shkencore, mijra libra, qindra raporte në fushën e psikosociale, por kjo literaturë është kryesisht në anglisht dhe në gjuhë të tjera të huaja, por jo në shqip. <i>GVJ propozon shtimin e fondit të librave veçanërisht të fushës sociale në ndihmë të studentëve e të personelit akademik të kësaj dege studimi.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në këtë standard gjykon se institucioni ka vënë në dispozicion mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën dhe mjediset e tjera mbështetëse, por përsa i përket literaturës konstatojmë se dy aspektet që lënë hapsirë për përmirësim janë të lidhura me kërkesat për blerje të rezultojnë nga një analizë dhe përputhshmëri me modulet e programit, të jenë minimalisht tituj e të pakten 5 viteve të fundit, si dhe të jenë të fokusuara kryesisht në gjuhën e programit (shqip), të ketë një balancim në fushën sociale dhe atë psikologjike, si dhe të përmbushin kriteret për tekste akademike me ISBN.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me	Sipas dokumentacionit të DVV-së institucioni ³⁶⁰ përdor sistemin e menaxhimit të studentëve (SMS) ³⁶¹ , i cili është një platformë elektronike ³⁶² nëpërmjet të cilit kryhen veprime të ndryshme nëpërmjet funksionaliteteve që ofron sistemi për çdo student, pas logimit në sistem me kredencialet e institucionit.

³⁵⁹ Evidenca 15. Permbledherse e Tabelave.pdf, Tabela 17

³⁶⁰ Evidenca 3. Organigrama.pdf

³⁶¹ http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar

³⁶²

http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar/PAGE_logimi/~C8AAKOcDDk4ALUVIIQjZjBFxlc

studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nëpërmjet këtij sistemi krijohen, ruhen, përditësohen dhe saktëson të dhëna për studentët³⁶³ e regjistruar në këtë universitet nga faza e regjistrimit, ruajtja e vlerësimeve dhe diplomimi. Për çdo paqartësi ose pyetje studentët këshillohen të kontaktojnë me Administratorin e Sistemit. Zyra IT³⁶⁴ është përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të përgjithshëm elektronik të UMSH-së, mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjithë sistemit dhe pajisjeve kompjuterike të vendosura në laboratorë, zyra e mjedise të tjera; asistencën për pajisjet elektronike dhe shërbimet e internetit si dhe për ruajtjen e arkivës elektronike të të gjithë sistemit kompjuterik. Nëpërmjet këtij sistemi studentët mund të aksesojë në llogarinë personale të tij të dhënat akademike dhe të dhëna të tjera sensitive, siç janë ato financiare, po ashtu dhe stafi administrativ³⁶⁵ ka akses vetëm në të dhënat përkatëse të sektorit, duke ofruar mundësi përdormi të dhënash vetëm për përmbushjen e funksioneve. Gjithashtu për çdo pamundësi apo shqetësim studentët kanë të mundur të kontaktojnë në çdo kohë institucionin dhe t'u ofrohet ndihmë edhe për sistemin³⁶⁶. Sistemi është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Sistemi ofron informacione të ndryshme për vijueshmërinë e vitit aktual akademik.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar statutit³⁶⁷ të universitetit, planit të zhvillimit strategjik³⁶⁸ dhe rregullores së tij³⁶⁹, administrimi i informacionit menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit. Ky informacion ruhet në formën hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit, siç janë: Fakulteti³⁷⁰, Departamenti³⁷¹, Universiteti, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria mësimore³⁷², IT³⁷³ dhe një sërë Zyrash të tjera të cilat secila sipas funksionit është e mandatuar të menaxhojë, monitorojë, krijoj apo auditoj aktivitete të ndryshme të personelit akademik, ndihmës akademik administrativ apo dhe të tjera veprimtari jashtë universiteti. I gjithë komunikimi në

³⁶³ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³⁶⁴ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 36.

³⁶⁵

http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar/PAGE_logimi/5BYAAELDGjkGAL~pM2DcO9yTaho

³⁶⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/12/kontakt>

³⁶⁷ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

³⁶⁸ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

³⁶⁹ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

³⁷⁰ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf

³⁷¹ Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf

³⁷² Evidenca 46. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf

³⁷³ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UMSH mundësohet përmes rrjetit të brendshëm të tij dhe sistemit SMS³⁷⁴, i cili garanton ndarjen në mënyrë të sigurt të informacioneve univeristare dhe burimet kompjuterike prej nga nisen këto informacione. Institucioni zbaton me rigorozitet detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që lindin nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 dhe gjithë akteteve të tjera ligjore³⁷⁵ mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve të sektorit privat. Sistemi SMS³⁷⁶ siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin e menaxhimit të të dhënave.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Bazuar në të vetmin dokument të dorëzuar në DVV³⁷⁷ dhe vizita në institucion³⁷⁸, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin e brendshëm interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformën SMS, që prej vitit 2017 dhe në vitin 2020 kjo platformë edhe është përmirësuar me module të tjera shtesë si Zoom Cloud Meeting dhe G-Suite. Sistemi i menaxhimit komfirmohet edhe nga studentët se ju ofron akses në një fushë të gjerë informacioni si regjistrimi i në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin dhe në informacionet shtesë dhe ndihmëse, vlerësimet e vijueshme nga pedagogu, vlerësimet përfundimtare të lëndës. Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Gjithashtu departamenti komunikon edhe me platforma të tjera³⁷⁹, të hapura e publike, kryesisht në rrjetet sociale me informacione më të përgjithshme e në kohë reale. Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacion dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me punën, sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës. GVJ nga vizita në institucion³⁸⁰ dhe takimet me stafin akademik dhe studentët e konfirmuan shkëmbimin në kohë reale të informacioneve dhe të njoftimeve që realizoheshin nëpërmjet sistemeve të

³⁷⁴ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³⁷⁵ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³⁷⁶ http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar

³⁷⁷ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³⁷⁸ Shënime gjatë vizitës në institucion

³⁷⁹ https://www.facebook.com/mesdhetari/?locale=sq_AL; <https://www.linkedin.com/company/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise>; <https://www.4icu.org/reviews/17938.htm>; <https://www.instagram.com/keshillistudentorumsh/> <https://regjistrir.urdhriipsikologut.al/members/detail/irva-rama>

³⁸⁰ Shënime gjatë vizitës në institucion

	menaxhimit dixhital.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta³⁸¹. Të dhënat me më tepër frekuencë janë listat emërore të studentëve, raportimet statistikore mbi kurset, notat, aplikimet për bursë³⁸², por dhe të dhëna të tjera si oraret dhe frekuentimet dhe kërkesat e tjera ligjore³⁸³. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si dhe u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre dhe platformave sociale. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht gjatë takimit me studentë konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafi akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. Sistemi i menaxhimit u siguron atyre informacione të përditësuara.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të UMSH-së https://www.umsh.edu.al/ paraqitet një informacion i plotë mbi historikun, misionin dhe filozofinë, partnerët, stafin drejtues dhe administrimin, guidat për studentët e ardhshëm si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, institucioni promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht³⁸⁴. Faqja Web paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët³⁸⁵, si jeta studentore, klubi studentor, këshillat, financimet, projektet dhe shërbimet për studentë. Kjo faqe është lehtësisht e aksesueshme dhe programi i studimit "Studime Psikolosociale³⁸⁶", gjithashtu ka faqen e vet të

³⁸¹ <https://www.umsh.edu.al/> - Të Dhënat nga Web

³⁸² <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfptPtxKFXauEJQ8YRA1Q3PCcaANjVpLg86qNHgDgi2eRstd/veeform>

³⁸³ <https://www.umsh.edu.al/c/213/orari-mesimor>

³⁸⁴ <https://www.umsh.edu.al/>

³⁸⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>

³⁸⁶ <https://www.umsh.edu.al/media/65188ddf8ef23.pdf>

	internetit https://www.umsh.edu.al/media/65188ddf8ef23.pdf. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm dhe në të gjendet informacion i përgjithshëm mbi pranimin³⁸⁷ e regjistrimin, objektivat e programit dhe kurrikulat. Universiteti jep informacion të dedikuar për studentët e tj dhe jetën akademike, por i kushton vëmendje dhe aspekteve të tjera zhvillimore rinore nëpërmjet faqes së dedikuar studentëve³⁸⁸, kërkimit shkencor³⁸⁹, ndërkombtarizimit³⁹⁰. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se informacionet e publikuara në faqen e internetit ishin të përdorshme e të nevojshme për studentët.			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në institucion gjykon se UMSH disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional SMS dhe e ka vënë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për të gjithë universitetin, ashtu dhe për programin e studimit "Studime Psikosociale", ndaj ky standart përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një	Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga GVJ, në materialet e DVV-së informohemi se IAL-ja ka hartuar planin e financimit për të cilin ka marrë në konsideratë sa më poshtë³⁹¹; ndërsa përse i përket specifikisht programit të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” nuk mund të gjenerojmë dot të dhëna. <table><tr><th>Të dhëna Financiare UMSH</th><th>2020-2021</th><th>2021-2022</th><th>2022-2023</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Të dhëna Financiare UMSH	2020-2021	2021-2022	2022-2023				
Të dhëna Financiare UMSH	2020-2021	2021-2022	2022-2023						

³⁸⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

³⁸⁸ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>

³⁸⁹ <https://www.umsh.edu.al/c/147/kerkimi-shkencor>

³⁹⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/148/nderkombetarizimi>

³⁹¹ Evidenca 16.1 16.2 16.3. Tabela e raportit financiar.pdf

cikël të plotë studimi.	Të ardhura nga Tarifat	351,979	409,982	427,554
	Të ardhura nga Projektet	53,217	45,858	69,680
	Të ardhura nga burime të tjera	13,112	700	8,000
	TOTALI	418,309	456,540	505,234
	Shpenzime page për mësimdhënie dhe administrim	134,505	139,532	146,475
	Shpenzime page për punën kërkimore shkencore	57,146	51,796	53,116
	Pagesa për projekte kërkimi	46,415	39,400	43,341
	Shpenzime administrative dhe të përgjithshme	132,171	151,306	166,436
	Shpenzime për kërkim zhvillimin	4,991	6,944	7,639
	Shpenzime për investime dhe teknlogji	22,929	6,067	25,000
	TOTALI	398,157	395,045	442,007
	Këto të dhëna financiare për tre vitet e fundit mbi institucionin na informojnë se UMSH-ja ka një rezervë burimesh për investime dhe kontigjencë respektivisht:			
	Rezerva	20-21	21-22	22-23
	Rezervë burimesh për investime dhe kontigjencë	20,151	61,495	63,227
Një pjesë e rezervave është përdorur nga institucioni për mbështetjen me bursa studimi në vlerat respektive:				
Bursa		Vlera		
2020-2021		138,445		
2021-2022		161,120		

	2022-2023	142,518
	Institucioni, referuar planit të zhvillimit strategjik³⁹² krijon rezerva me qëllim investimin për ambiente dhe teknologji bashkëkohore dhe 30 % e fondit për investime dhe kontigjencë planifikohet për ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare. GVJ nuk arriti të evidentoj pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave e shpenzimeve të Departamentit dhe specifikisht planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, si dhe nuk evidentoi raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “Studime Psikosociale” dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi nga universiteti. Por sikundër dhe institucioni deklaroi në objeksionet e tij politikat e tij financiare janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.	
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra	Referuar akteve ligjore e nënligjore³⁹³ Administratori i Universitetit është autoriteti më i lartë administrative dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrative të UMSH-së, i cili harton projektbuxhetin dhe propozon kriteret e administrimit të burimeve financiare dhe material, të cilat marrin miratimin e Bordit të Administrimit. Administratori i njësisë kryesore³⁹⁴ organizon administrimin e veprimtarisë së përditshme të njësisë kryesore dhe zbaton udhëzimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nga DVV³⁹⁵ e shqyrtuar arritëm të evidentonin tabelat e raportit financiar për të gjithë periudhën, që nga çelja e IAL-së, pasqyrat financiare dhe raporte të auditit, por nuk u evidentua plani i financimit të të njësisë bazë përgjegjëse (Departamenti i të cilës nuk evidentohet, por ofrohet nga Fakulteti i drejtësisë dhe shkencave humane) për programin e studimit “Studime Psikosociale”. <i>GVJ evidentoi auditime të pavarura nga kompani të certifikuar, auditime të përvitshme si dhe auditime të brendshme, të cilat ishin të reflektuara në raportet përkatëse vjetore të auditimit. Këto raporte certifikojnë qëndrueshmërinë dhe mjaftueshmërinë financiare të Institucionit, duke siguruar</i>	

³⁹² Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

³⁹³ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 23

³⁹⁴ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 24

³⁹⁵ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf; Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf; Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit SPS.pdf; Evidenca 16.1_16.2_16.3, Tabela e raportit financiar.pdf; Evidenca 15. Permblendhese e tabelave.pdf Tabela 18




të tjerë.	dhe mbarëvajtjen e aktivitetit për periudhën pasardhëse.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UMSH-ja kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe nga shqyrtimi i DVV-së, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm, dhe për këtë referohen edhe raportet dhe pasqyrat financiare dhe raportet e audit³⁹⁶. Raporti vjetor i institucionit hartohet nga njësia e auditimit të brendshëm³⁹⁷. Auditi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu në respektim të kuadrit ligjor mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, çdo vit auditohet nga një kompani auditimi e certifikuar, e cila miraton pozicionin financiar të IAL-së dhe konfirmon përputhshmërinë ligjore të shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti i fundit i auditit të jashtëm është hartuar nga “Crowe AL” shpk më 30 mars 2023. Me anë të këtij dokumenti në informohemi se UMSH plotëson të gjithë standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktiviteteve duke siguruar plotësimin e të gjithë kriterëve ligjore të Standardave të Cilësisë³⁹⁸.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Referuar DVV-së, Zyra e financë kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit³⁹⁹. Një nga detyrat e kësaj zyre është dhe nxjerrja e të gjitha të dhënave që u duhen titullarëve të institucionit për raportime dhe studime të ndryshme dhe mbi bazën e të dhënave që disponon bën dhe studime dhe propozime për plotësimin e strukturave financiare dhe metodave të punës⁴⁰⁰. Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion⁴⁰¹ ata na informuan se ishin pjesë e analizave vjetore të punës së institucionit, dhe në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “Studime Psikosociale” dhe informoheshin mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Nga shqyrtimi i DVV-së evidetohet raporti financiar për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara për vitet 2017-2023⁴⁰², gjenden raportimet në nivel universiteti, duke mundësuar kuptueshmërinë mbi realizimin e buxhetit dhe duke garantuar vijueshmërinë financiare edhe për këtë program

³⁹⁶ Evidenca 16.1_16.2_16.3. Tabela e raportit financiar.pdf

³⁹⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 32

³⁹⁸ Evidenca 16.1_16.2_16.3. Tabela e raportit financiar.pdf

³⁹⁹ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 31

⁴⁰⁰ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 31, pika 2, gërma j.

⁴⁰¹ Shënime gjatë vizitës në institucion

⁴⁰² Evidenca 16.1_16.2_16.3. Tabela e raportit financiar.pdf

	studimi.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion ⁴⁰³ në raportin e GVB-së dhe vizitës pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, GVJ ka konkluduar se raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara, por jo të specifikuara për të gjithë programet e studimit të aktivizuara në këtë institucion. Hartimi i një raporti në lidhje me raportimet financiare të deritanishme dhe më specifikuara dhe me planifikimet financiare për periudhën pasardhëse dhe me transparencën financiare i jep mundësi institucionit të këtë një opinion ligjor të pavarur mbi pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit dhe me qëndrueshmërinë financiare. Bordi i Administrimit, ⁴⁰⁴ i cili është organi më i lartë kolegjal administrative, siguron përbushjen e misionit të UMSH-së dhe mbarëvajtjen financiare dhe administrative të institucionit duke garantuar dhe qëndrueshmërinë financiare. Projektbuxheti vjetor, çdo vit përgatitet nga Administratori dhe miratohet nga Bordi i Administrimit, dhe bazohet në planifikimet e kryera në programimin financiar dhe propozimet e njësive kryesore dhe bazë. Sipas raportit të planit financiar të programit të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” dëshmohej një qëndrueshmëri financiare dhe evidentohen kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të veprimtarive akademike të programit dhe ka garanci siguri për institucionin.			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme, institucioni i arsimit të lartë UMSH-ja garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, dhe rrjedhimisht dhe mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve, ndaj gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <u>përbushet plotësisht</u>.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

⁴⁰³ Evidenca 16.1 16.2 16.3, Tabela e raportit financiar.pdf

⁴⁰⁴ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 15

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UMSH ka hartuar statutin⁴⁰⁵ dhe rregulloren e universitetit⁴⁰⁶, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik⁴⁰⁷⁴⁰⁸ të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore⁴⁰⁹⁴¹⁰⁴¹¹. Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin⁴¹² dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Ky program studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Dhe të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret⁴¹³ dhe kuotat e pranimit, dokumentacionin⁴¹⁴ dhe organizimi i programit të studimit⁴¹⁵, procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve dhe aktiviteteve të Departamentit⁴¹⁶. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto

⁴⁰⁵ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

⁴⁰⁶ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

⁴⁰⁷ Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.pdf

⁴⁰⁸ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf

⁴⁰⁹ <https://uamd.edu.al/procedura-per-pajisjen-e-studenteve-me-program-studimi-2/>

⁴¹⁰ Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf

⁴¹¹ Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

⁴¹² Evidenca 27. Kalendar Akademik.pdf

⁴¹³ <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

⁴¹⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni>

⁴¹⁵ <https://www.umsh.edu.al/media/65188ddf8ef23.pdf>

⁴¹⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/217/formulare-aplikimi>

	akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për regjistrimet në këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së miratuara nga MAS.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe vizitës në insitucion GJV konstaton se institucioni mbështetet në rregulloren e tij ⁴¹⁷ , procedurën e transferimit (neni 56), për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me rregulloren e programit të studimit ⁴¹⁸ duke siguruar të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme ⁴¹⁹ të këtij institucioni. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve ⁴²⁰ .
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të	Referuar Udhëzimit ⁴²¹ të MAS kriteret dhe procedura e pranimit në universitet realizohet nëpërmjet QSHA-së dhe portalit përkatës. Në faqen zyrtare të institucionit ⁴²² janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Institucioni publikon informacionet edhe mbi fituesit ⁴²³ . Referuar rregullores së fakultetit, për tu pranuar në programin e studimit duhet të vërtetohet përfundimi i arsimit të ciklit të mëparshëm, të plotësohen kërkesat konform dhe akteve rregullative në fuqi dhe përzgjedhja e studentëve për pranim në këtë institucion bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në

⁴¹⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, Kreu II, Kreu VII, dhe Kreu VIII.

⁴¹⁸ Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf, Kreu IV

⁴¹⁹ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, Kreu VII dhe Kreu IX

⁴²⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet>

⁴²¹ <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-10-date-15-05-2019-per-procedurat-e-aplikimit-dhe-te-regjistrimit-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-studimeve-ne-programet-e-studimeve-me-karakter-profesional-si-dhe-ne-programet-e-integr/>

⁴²² <https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet> & <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6Wmo4Op-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/viewform>

⁴²³ <https://www.umsh.edu.al/c/152/fituesit>

huaj.	dokumentacionin e paraqitur dhe shqyrtimi i dosjes personale të kandidatit ⁴²⁴ . Kriteret parashikojnë pranime edhe për shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe konform akteve normative në fuqi.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit⁴²⁵ për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë janë të pasqyruara si informacione specifike edhe në faqen zyrtare, po ashtu dhe duke dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim⁴²⁶ në programet e studimit, si dhe procesi i transferimit⁴²⁷, si një e drejtë e ligjshme e çdo studenti; duke lehtësuar kështu praktikën e çdo studenti në këtë institucion. Në DVV- nuk gjenden vendime (të senatit) mbi miratimin e kuotave të pranimeve për vitet respektive akademike për programin Bachelor në “Studime Psikolosociale” ndaj e kemi të pundur të vlerësojmë mbi plotësimin e kuotave apo mbi lehtësimet mbi kuotat për kategori të veçanta të ndryshme (për shtetas shqiptar brenda vendit, për aplikantë për program të dytë studimi, për transferimet, për minoritetin Romë dhe Egjiptian, kouta për personat AK apo për aplikantët nga trojet shqipfolëse). Në rregulloret e institucionit⁴²⁸ dhe në ato mësimore të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ka të specifikuaraforën e organizimit të studimeve (neni 47), kalimin në vitin pasardhës (neni 48), kohëzgjatja, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve (neni 49), forma e mësimi dhe konrolli i dijeve (neni 62) si dhe transferimi i studimeve (neni 69) Procedurat e mësipërme i mundësojnë aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë dhe në institucionet e varësisë⁴²⁹, në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet rregullative të institucionit. Kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit, informacione të cilat janë dhe lehtësisht të aksesueshme⁴³⁰. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së

⁴²⁴ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, neni 30, 31 dhe 34.

⁴²⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

⁴²⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni>

⁴²⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet>

⁴²⁸ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

⁴²⁹ <https://www.asc.al/en/hei-list/hei/shkolla-e-larte-private-mesdhetare-e-shqiperise-2>

⁴³⁰ <https://www.umsh.edu.al/media/5f6c48a037f4b.pdf>

	studentëve janë në përputhje me VKM-të në fuqi. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të përcaktuara qartë dhe ë kuptueshme në rregulloret e institucionit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ edhe gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimin për informimin publik dhe atë të të maturantëve të shkollave të mesme në veçanëri, në faqet publike dedikuar studentëve ⁴³¹ , dhe në faqen zyrtare të institucionit ⁴³² . Gjithashtu maturantët informohen për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar edhe nga mediat sociale shumë lehtësisht të aksesueshme nga të rinjtë ⁴³³ . Maturantëve ju jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes gjatë vizitave në institucion. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet ⁴³⁴ . Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin e programit dhe realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UMSH: Format ⁴³⁵ me të cilat realizohen informimi në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin e "Studimeve Psikosociale", janë të shumta, përveç atyre të kërkesës për informim zyrtarë edhe në forma të tjera si këshillimi në ambjentet e universitetit ⁴³⁶ , dërgimi i ftesave në email, rrjete sociale ⁴³⁷ etj.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të	Institucioni, referuar ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati shqyrton dhe miraton kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe institucioni ka të miratuara kriteret edhe për kandidatët e kategorive të marginalizuara si dhe atyre me aftësi të veçanta apo pakicave e trojeve. Kuotat për vitin akademik pasardhës

⁴³¹ <https://www.portalistudentor.al/lista-universiteteve/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise/>

⁴³² <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

⁴³³ <https://m.facebook.com/mesdhetari/posts/10158594125948449/>

⁴³⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni>

⁴³⁵ <http://www.panorama.com.al/ne-6-dite-aplikime-ja-deget-me-te-kerkuara-ne-universitetin-mesdhetar-te-shqiperise/>

⁴³⁶ <https://telegraf.al/arsim/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-gjithmone-perballe-sfidave-te-reja/>

⁴³⁷ https://www.facebook.com/mesdhetari/posts/mund%C3%ABsia-e-fundit-p%C3%ABr-maturant%C3%ABt-apliko-p%C3%ABr-n%C3%AB-universitet-deri-n%C3%AB-2-n%C3%ABntor-zgji/10156584204613449/?locale=es_LA ; <https://mediadesk.al/mesdhetari/>; <https://www.instagram.com/p/CpctyLzqsv9/>; <https://www.facebook.com/mesdhetari/videos/zgjidh-universitetin-mesdhetar-t%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB/473032110154330/>; <https://fastnewseconomy.com/2019/08/infrastruktura-moderne-dhe-pagesat-e-tarifes-me-keste-mbeshtetje-per-studentet-e-universitetit-mesdhetar-te-shqiperise/>

margjinalizuara.	hartohen nga Departamenti dhe Fakulteti dhe miratohen nga Senati Akdemik. Gjithashtu në mbështetje të kategorisë PAK, ky institucion ka të miratuar edhe një rregullore specifike ⁴³⁸ .
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni është një universitet privat dhe për këtë program studimi nuk ka parashikur kriteret të dedikuara për kandidatët nga shtete të tjera. Gjithashtu nga vizita në institucion informohemi se nuk ka interes nga studentët të ardhur nga shtete të tjera dhe nuk kanë pasur asnjë rast të tillë, por cilido student që shpreh interes qoftë edhe me kërkesa online ⁴³⁹ trajtohet me profesionalizëm si dhe asistohet në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për përzgjedhjen e drejtimit të studimeve që dëshiron.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMSH-ja ka të përfshirë në rregulloren e tij edhe politikat për ndihmimin e studentëve (bursat) ⁴⁴⁰ për shtresat e marginalizuara ekonomikisht për përfitimin e ndihmës së tyre për të rritur cilësinë e pranimin në programin e BA në “Studime psikosociale” për zhvillimin ekonomik të vendit ⁴⁴¹ . Ky institucion ofron një sërë bursësh si: bursë e plotë sociale i akordohet aplikantëve nga grupet në nevojë (familje me ndihmë ekonomike dhe mesatare shumë të lartë, status jetimi, fëmijë dëshmorësh në polici, në forca të armatosura, me aftësi ndryshe, komunitetet e marginalizuara, etj të ngjashëm).; bursë ekselence i akordohet studentëve të regjistruar për herë të parë me mesataren 9.7-10 nga shkolla e mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore; bursë për studentë shumë të mirë e përfitojnë deri në 2% e të gjithë studentëve të regjistruar për herë të parë kur mesatarja e shkollës së mesme është nga 9,3 deri në 9,6 dhe me kushte ekonomike jo të favorshme.; bursë talenti akordohet për një numër aplikantësh deri në 2% e numrit të studentëve të regjistruar për herë të parë për aplikantë të spikatur në konkurse, gara ose organizata të ndryshme të artit, shkencës, sportit & përfaqësues të shquar të organizatave rinore; bursë mbështetëse i akordohet deri në 3% e numrit të studentëve të rinjë të regjistruar për aplikantë me të ardhura relativisht të ulëta, grupime që nuk përfshihen në kategorinë e tjera të këtij vendimi. Në DVV gjenden dokumente ⁴⁴² për rimbursim tarifash dhe ulje pagesash dhe rastet që përfitojnë ulje nga tarifa vjetore e shkollimit si student të shkëlqyer,

⁴³⁸ Evidenca 18. Rregullore për studentet me aftësi ndryshe.pdf

⁴³⁹ <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6Wmo4Qp-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/viewform>

⁴⁴⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat>

⁴⁴¹ <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfptPtXKFXauEJO8YRA1Q3PCcaANjVpLg86qNHgDgi2eRsdw/viewform>

⁴⁴² Evidenca 16.1 16.2 16.3. Tabela e raportit financiar.pdf

	student me rezultate dhe kërkesave me kritere të tjera. Nga vizita në institucion u informuam se studentët asistoheshin me bursa, dhe një të pranishmet konfirmoi se përveç mbështetjes klasike, kishte dhe tarifë të reduktuar nëse nga e njëjta familje studionin 2 persona në këtë universitet.			
Konkluzione	GVJ bazuar në evidencat e mësipërme dhe disa aspekteve që lidhen me komponentë mësimorë UMSH-ja ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve, mbështetjen financiare dhe diplomimin në programin e studimit, si dhe nisur nga angazhimi i njësisë bazë, gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <u>përmbushet plotësisht</u> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit⁴⁴³. Në faqen web⁴⁴⁴ dhe në aktet rregullative të universitetit gjendet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. (Neni 48 i Rregullores së Organizimit të Universitetit normon se studenti kalon në vitin e dytë pasi ka fituar të paktën 30 kredite nga viti i parë i studimeve, 60 kredite për kë kaluar në vitin e tretë, dhe është i detyruar të shlyejë të gjithë detyrimet përkatëse para paraqitjes në provim). Gjithashtu në fillim të çdo lënde pedagogu informon jo vetëm mbi detyrimet e lëndës, por dhe çdo informacion në lidhje me kriteret e përparimit akademik të dhe të kalimit në vitin pasardhës. GVJ konfirmion se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.

⁴⁴³ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, neni 27-29; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf, Kreu III dhe Kreu IV

⁴⁴⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>




Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Për të gjithë studentët⁴⁴⁵ edhe ata të rinj të regjistruar realizohet procesi i pritjes dhe orientimit të kandidatëve, i cili është i përvitshëm në UMSH⁴⁴⁶. Në hollin e institucionit gjenden kënde pritjeje dhe stenda informuese ku realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të institucionit. Në aktet normative gjenden dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme⁴⁴⁷. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit⁴⁴⁸.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve⁴⁴⁹ dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në të gjithë tërësinë e rregulloreve të UMSH-së, dhe specifikisht gjenden edhe në rregulloren e programit të studimit⁴⁵⁰, kreu V “Kontrolli i Dijes”, gjithashtu edhe në rregulloret e tjera të IAL-së⁴⁵¹, si dhe në syllabusin e çdo lënde⁴⁵² studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në çdo lëndë. Pedagogu i lëndës, por edhe njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit të studimit përgjatë fazës së parë të regjistrimit, fillimit të semestrit, në javën orientues në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve. GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Ky informim është i vijueshëm edhe gjatë lëndëve të veçanta, gjithashtu ata konfirmojnë se edhe procesi i adresimit të shqetësimeve të ndryshme mbi vlerësimin ishte shumë i qartë për ta.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe	Kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e studimeve të UMSH⁴⁵³-së, konkretisht në nenet 73-77 si dhe në korpusin tjetër rregullativ, deri në atë të programit (Kreu IV), gjithashtu ato janë lehtësisht të aksesueshme edhe në faqen web⁴⁵⁴. Departamenti gjithashtu

⁴⁴⁵ Evidenca 21. Udhezues i studentit.pdf

⁴⁴⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>

⁴⁴⁷ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, neni 44-45

⁴⁴⁸ Evidenca 13.2. Syllabuse 2.pdf; Evidenca 13.2. Syllabuse 3.pdf & Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf

⁴⁴⁹ Evidenca 22. Udhezues mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve.pdf

⁴⁵⁰ Evidenca 7. Rregullore SPS.pdf Kreu IV dhe V.

⁴⁵¹ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, Kreu IX

⁴⁵² Evidenca 13.2. Syllabuse 2.pdf; Evidenca 13.2. Syllabuse 3.pdf & Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf

⁴⁵³ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, Kreu X

⁴⁵⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit>

diplomimit në programin e studimit.	ka miratuar dhe mbështetet në rregulloren e tij, Kreu X, “Diplomimi” ⁴⁵⁵ ku specifikohen edhe modalitetet e miratimit të personelit akademik që do të udhëheqë temat e diplomave, për ata studentë që diplomohen me diploma, dhe pjesa tjetër e cila diplomohet me provim përfundimtar formimi ⁴⁵⁶ . Udhëzimi në lidhje me stukturën e temës së diplomës gjendet online ⁴⁵⁷ dhe iu vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit të tretë. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim ose verbalish bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik ⁴⁵⁸ . Studetëve ju vihen në dispozicion dhe pyetjet orientuese për provimin e formimit të këtë program ⁴⁵⁹ .			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi ⁴⁶⁰ . Në lidhje me tërheqjen e studentëve të ardhshëm çdo fillim vitit akademik UMSH organizon grupe pune, të cilët informojnë studentët mbi programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t’i ndihmuar ata në vendimarrje. Format si; panairët me shkollat e mesme, njoftimet në faqen zyrtare të web ⁴⁶¹ , rrjetet sociale, stendat e Universitetit dhe guidës së studentit ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar UMSH ka hartar dhe broshura informimi ⁴⁶² . Gjithashtu zyra e këshillimit të karrierës ⁴⁶³ ka detyrë të organizojë dhe drejojë këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik.			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se UMSH ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimeve psikosociale të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në formatin e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të

⁴⁵⁵ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf

⁴⁵⁶ ⁴⁵⁶ <https://www.umsh.edu.al/media/5ee210c8c94d4.pdf>

⁴⁵⁷ <https://www.umsh.edu.al/media/5ee210ca5f24f.pdf>

⁴⁵⁸ Evidenca 37 dhe Evidenca 38 Modeli i Diplomes _ SUPlementi.pdf

⁴⁵⁹ Evidenca 17. Pyetjet orientuese.pdf

⁴⁶⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/13/pse-mesdhetarin>

⁴⁶¹ <https://www.umsh.edu.al/media/65188ddf8ef23.pdf>

⁴⁶² Evidenca 32. Broshura e programeve Bachelor.pdf

⁴⁶³ <https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres>

hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, listën e programeve dhe të lëndëve, tarifat e studimit, si dhe parakushtet e lëndëve gjenden në faqen web ⁴⁶⁴ të universitetit. Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës së parë mbi kërkesat dhe kriteret universitare ⁴⁶⁵ , kohëzgjatjen maksimale të periudhës së studimeve; ndërsa në fillim të çdo viti akademik të tre vitet e studimit informohen hollësisht mbi detyrimet akademike, kohëzgjatjen e programit të studimit dhe periudhën e provimeve ⁴⁶⁶ . Ndërsa informacioni mbi organogramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqet në internet të institucionit. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet faqes web ⁴⁶⁷ , gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit, takimeve informuese me stafin dhe pedagogët, studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje kurrikulën dhe programin e studimit (lëndët), regjistrimet, orarin dhe provimet, regjistrimi për provime dhe vlerësimet e notat përkatëse. Informacion i detajuar për çdo lëndë ju jepet nga pedagogu i lëndës nëpërmjet komunikimit me e-mail ose dhe formafin hard-copy në ditën e parë të prezantimit të syllabusit ⁴⁶⁸ me informacione specifike për temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. GVJ e konfirmoi këtë gjatë takimeve që realizoi me stafin dhe studentët.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Institucioni ka në dispozicion të nevojave profesionale të studentëve një sër zyrash që bashkërendojnë punën me njëra tjetrën si, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ⁴⁶⁹ e

⁴⁶⁴ <https://www.umsh.edu.al/>

⁴⁶⁵ Evidenca 32. Broshura e programeve Bachelor.pdf

⁴⁶⁶ Evidenca 27. Kalendar Akademik 2022-2023.pdf

⁴⁶⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/213/orari-mesimor>

⁴⁶⁸ Evidenca 13.2. Syllabuse 2.pdf; Evidenca 13.2. Syllabuse 3.pdf & Evidenca 13.2. Syllabuse 4.pdf

⁴⁶⁹ <https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres>




dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	cila ka mision të sajën që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe t'i orientojë dhe këshillojë ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve ⁴⁷⁰ . Gjithashtu, kjo zyrë organizon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik; këshillon dhe udhëzon ata në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale; mbështet Këshillin Studentor, i cili është një organizëm i pavarur në UMSH që përfaqëson dhe mbron interesat e studenteve; si dhe mbështet njësitë bazë përgjatë procesit të Praktikave mësimore dhe profesionale. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, dhe për këtë është përfshirë ⁴⁷¹ në studim të treguesve dhe aftësive që kërkohen për punësim dhe orienton drejt studentët e tij dhe në tregun e punës ⁴⁷² . Të dhënat referojnë se nga 131 studentë të diplomuar 83 janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 28 të tjerë jo në përputhje me diplomën (Tabela 23, Aneks Tabela Pëmbledhëse)
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në dispozicion të studentëve është një nga sistemet IT më të mira përse i përket të gjithë procesit të menaxhimit universitar, ⁴⁷³ i cili i siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në informacionin, detyrimet dhe literaturën ⁴⁷⁴ e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe kështu mund të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë procesin akademik. Akses i këtyre platform bëhet nëpërmjet kredencialeve të cilat ju jepen studentëve sapo fitojnë status student nga Zyra IT ⁴⁷⁵ . Informacion mbi organizimin e procesit mësimor gjendet lehtësisht edhe në faqen Web ⁴⁷⁶ të UMSH-së.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit përmes që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, staf i akademik, degët e studimit, lëndët, syllabusët e lëndëve, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, komunikime e njoftime të ndryshme etj. Gjithashtu edhe platforma Google classroom me të gjithë aplikacionet e saj është gjithashtu e aplikueshme nga pedagogët, si një platformë e cila mundëson me shumë mundësi ndërveprimi. Vlen të theksohet se aksesit në internet por edhe në sistemet e sipërcituara është i garantuar

⁴⁷⁰ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁴⁷¹ Evidenca 15. Përmblendhëse e Tabelave.pdf, Tabela 23

⁴⁷² Evidenca 14. Analize e tregut të punës.pdf

⁴⁷³ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformës elektronike.pdf

⁴⁷⁴ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

⁴⁷⁵ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformës elektronike.pdf

⁴⁷⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/214/kalendari-akademik>

	nga interneti në mjediset e universitetit dhe nga aksesit në kompjuterat e vënë në dispozicion të studentëve në bibliotekën, e cila ndohet gjithashtu në mjediset e fakultetit. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me stafin akademik por edhe me grupin e punës na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në institucion. Për të rritur kanalet e komunikimit, për të qënë sa më praktikë dhe bashkëkohor, përveç kanaleve zyrtare si faqja web e institucionit⁴⁷⁷ dhe komunikimet zyrtare, edhe platformat sociale⁴⁷⁸ gjithashtu janë përdorur si platforma të aksesueshme e transparente mbi publikimin e informacionit.			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat formues të secilës lëndë; kishin informacion të plotë e të hollësishëm për strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës, si dhe informacione përsa i përket studimeve mbi tregun dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁴⁷⁷ <https://www.umsh.edu.al/> & <https://www.umsh.edu.al/c/146/te-reja>

⁴⁷⁸ <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6Wmo4Qp-g6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/viewform>; <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfptPtXKFXauEJO8YRA1Q3PCcaANjVpLg86qNHgDgi2eRxdw/viewform>; <https://m.facebook.com/mesdhetari/posts/10158594125948449/>; <http://www.panorama.com.al/ne-6-dite-aplikime-ja-deget-me-te-kerkuara-ne-universitetin-mesdhetar-te-shqiperise/>; <https://telegraf.al/arsim/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-gjithmone-perballe-sfidave-te-reja/>; https://www.facebook.com/mesdhetari/posts/mund%C3%ABsia-e-fundit-p%C3%ABr-maturant%C3%ABt-apliko-p%C3%ABr-n%C3%AB-universitet-deri-n%C3%AB-2-n%C3%ABntor-zgji/10156584204613449/?locale=es_LA; <https://mediadesk.al/mesdhetari/>; <https://www.instagram.com/p/CpctyLzqsv9/>; <https://www.facebook.com/mesdhetari/videos/zgjidh-universitetin-mesdhetar-t%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB/473032110154330/>; <https://fastnewseconomy.com/2019/08/infrastruktura-moderne-dhe-pagesat-e-tarifës-me-kestë-mbeshtetje-per-studentet-e-universitetit-mesdhetar-te-shqiperise/>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore edhe mbi numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Referuar <i>tab.nr.21 të RVB</i> ⁴⁷⁹ për 3 vitet e fundit akademike konstatohet se numri i studentëve të regjistruar është relativisht me rregjistrime konstante për dy vitet e para dhe në zbritje (39 studentë) për vitin aktual, kjo në analizë të situatës së përgjithshme të rënies së numrit të studentëve që vijojnë studimet në universitetet në vend. GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ⁴⁸⁰ ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kapacitetet pritëse të institucionit. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjishme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni. Ndërkohë mesatarja në hyrje ka qënë mbi 7.5 në të tre vitet e fundit akademike. Gjatë vizitës në institucion u vërejtën se sekretaria mësimore administronte, rregjistrin themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejti rubrika të paplotësuara apo parregullësi në administrimin e tyre.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i	Institucioni disponon statistika ⁴⁸¹ për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në Bachelor në “Studime Psikosociale” ⁴⁸² , në respektim të kuadrit ligjor e rregullativ. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte: Viti 2022-2023 37 studentë, (Nota mesatare H 7.6) ⁴⁸³ ; me 15 studentë të transferuar; Viti 2021-2022 53 studentë, (Nota mesatare H 7.5); me 16

⁴⁷⁹ Evidenca 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

⁴⁸⁰ Evidenca 46. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf

⁴⁸¹ Evidenca 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

⁴⁸² Evidenca 46. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf

⁴⁸³ Evidenca 15. Permbledhese e Tabelave.pdf

studimeve.	studentë të transferuar; Viti 2020-2021 52 studentë, (Nota mesatare H 7.5); me 13 studentë të transferuar; Numri total i studentëve të regjistruar në programin “Studime Psikosociale” për 3 vitet e fundit akademike është 142. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Zyra që merret me regjistrimin e studentëve dhe sekretaria mësimore⁴⁸⁴ janë strukturat e posaçme që merren me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre kryejnë edhe përmes Portalit studentor që përdoret për menaxhimin e rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik të rregjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota, kjo referuar dhe kuadrit rregullativ të përdorimit të platformave elektronike⁴⁸⁵. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e universitetit dhe janë të sigurt, pasi sistemi është pjesë e RASH, i cili garanton sigurinë, si dhe në të kanë akses vetëm personat e autorizuar. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre	Institucioni ka hartuar një sërë dokumentesh që favorizojnë kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin e sekretarive mësimore si dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit si dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtaritë e tyre⁴⁸⁶. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme vetëm nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njëjësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.

⁴⁸⁴ Evidenca 46. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf

⁴⁸⁵ Evidenca 31. Manual i perdorimit te platformes elektronikt.pdf

⁴⁸⁶ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf & Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf & Evidenca 46. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf & Evidenca 31. Manual i perdorimit te platformes elektronikt.pdf & Evidenca 31. Manual i perdorimit te platformes elektronikt.pdf

përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në Raportin e GVB-së informohemi se njësia bazë harton raporte analitike dhe periodike vjetore ku ndër të tjera pika trajton edhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Nga verifikimi i DVV nuk u evidentuan raporte të tilla, ndaj <u>GVJ sygjeron</u> që Departamenti në fokusin vjetor të punës të tij të ketë edhe raportimet analitike të studimeve në programin “Studime Psikosociale” dhe të informojë edhe studentët e interesuar kryesisht për masat e marra në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve dhe për këtë të ketë dhe politika dhe rregullore se si do të monitorohen përmirësimet. Të dhënat statistikore mbi mesataren janë lehtësisht të aksesueshme nga sistemi i menaxhimit dhe vëmendje e shtuar duhet të tregohet në nivel institucional ndaj masave që duhet të merren për përmirësimin e treguesve. GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave dhe sekretaria mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit “Studime Psikosociale”. Të dhënat ruhen edhe në regjistra të posaçëm nga pranimi dhe regjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre, gjithashtu institucioni disponon të dhëna edhe për punësimin e studentëve.			
Konkluzione	GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme, UMSH-ja mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, ndaj gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <u>përmbushet plotësisht</u>.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre ⁴⁸⁷ në organet vendimmarrëse ⁴⁸⁸ si Senatin Akademik, komisionin për garantimin e standarteve dhe cilësisë, GVB ⁴⁸⁹ , këshillin e etikës, si dhe në këshillin e studentëve ⁴⁹⁰ , i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH-së dhe në vlerësimet e ndryshme të procesit mësimor ⁴⁹¹ . Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e përcaktuar konform akteve ligjore dhe atyre rregullatore, në statusin ⁴⁹² e vetë institucionit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në të gjitha strukturat dhe sektorët apo zyrat në të cilat përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve ⁴⁹³ . Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë ⁴⁹⁴ , dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari ⁴⁹⁵ . <i>GVJ sygjeron që studentët të jenë pjesë edhe e Këshillit të Etikës, neni 51 i Statutit, si një mundësi për përfshirje dhe vendimarrje, Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Studentët janë të përfshirë në klube të ndryshme studentore⁴⁹⁶. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve⁴⁹⁷ dhe përmes takimeve në grup⁴⁹⁸.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit,	Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe është e gatshme të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre ⁴⁹⁹ . Është në praktikën

⁴⁸⁷ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf– Kreu X; Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf – Kreu VIII; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf- Kreu IX; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf . Sesiioni IV.

⁴⁸⁸ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁴⁸⁹ Mendimi i Dekanit.pdf -Vendim për Krijimin e GVB me student.

⁴⁹⁰ Evidenca 48. rregullore e Funksionimit të Këshillit Studentor.pdf

⁴⁹¹ Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

⁴⁹² Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, neni 11 përfshirja në senat,

⁴⁹³ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise> ; Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf;

⁴⁹⁴ Mendimi i Dekanit.pdf - Vendimi për Krijimin e GVB me pjesëmarrje dhe student.

; <https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor>

⁴⁹⁵ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, neni 11 përfshirja në senat,

⁴⁹⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/112/klubet-studentore>

⁴⁹⁷ Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

⁴⁹⁸ Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf

⁴⁹⁹ Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	e kërrij departamenti dhe në përvojën e deritanishme të realizojë takime dhe fokus grupe ⁵⁰⁰ me studentët për të nxitur përfshirjen e tyre si në proceset akademike, ashtu dhe në ato ekstrakurrikulare. Nëpërmjet pedagogëve mentorë studentëve ju është dhënë një mundësi me tepër për t'u shprehur dhe për të dhënë sygjierimet dhe kontributin e tyre për përmirësimin e e programit të studimit, dhe stradegjia e zhvillimit të programit është një mundësi tjetër përfshirjeje ⁵⁰¹ . Vlen të theksohet fakti se ky program studimi nuk ka shumë vite që është hapur dhe në përgjithësi drejtimi psikosocial është relativisht i ri në vendin tonë, ndaj gjykohet se është herët për të vlerësuar këtë aspekt edhe pse takimi me kordinatoren e programit nxit dhe sygjierimet dhe mundësitë për përmirësim ⁵⁰² . Një tjetër aspekt që lidhet me përfshirjen e tyre janë dhe ftesat për takime për aktivitetet të ndryshme, të cilat gjithashtu një forum i hapur kontributi i të gjithë aktorëve ⁵⁰³ .			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregulloret e brendshme të programit të studimit "Studime Psikosociale" ⁵⁰⁴ si dhe ato të Fakultetit ⁵⁰⁵ dhe IAL-së ju mundësojnë studentëve një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve duke shtuar përdorimin e teknologjisë edhe në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve ⁵⁰⁶ . Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim. Studentët kanë mundësi të parashtrojnë ankesat e tyre, ndaj Dekanit mbi vlerësimet për të cilat nuk është dakord, Dekani ngre një komision i cili bën rivlerësimin e tezës së provimit të dorëzuar, ose e ri merr studentin në provim ⁵⁰⁷ .			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se institucioni kishte ndërtuar kuadrin rregullator për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, dhe nga takimi me studentë u evidentuan raste kur ata ishin të përfshirë në procesin e hartimit, miratimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit "Studime Psikosociale" bazuar në evidencat e mësipërme, ky standard përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

⁵⁰⁰ Evidenca 30. Procedura e punes me focus grupet.pdf

⁵⁰¹ Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit te programit SPS.pdf

⁵⁰² Evidencë-133-Përcaktimi koordinatorëve të programeve të studimit Departamenti Psikologji.pdf

⁵⁰³ <https://www.umsh.edu.al/c/122/jeta-studentore>

⁵⁰⁴ Evidenca 7. Rregullore SPS.pdf, Kreu V, Kontrolli i Dijes

⁵⁰⁵ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, Kreu VIII, Forma e Mesimit dhe Kontrollit te Dijes

⁵⁰⁶ Evidenca 21. Udhezues i studentit.pdf

⁵⁰⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 67

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UMSH-ja ka krijuar strukturën e vet ⁵⁰⁸ , e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, duke vënë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritë, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës). Statuti ⁵⁰⁹ dhe rregulloret ⁵¹⁰ e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore. Në godinën e universitetit ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit ndaj studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve siç është Njësia Bazë, Zyra e çështjeve studentore dhe ajo Alumni, apo dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës ⁵¹¹ . Këto struktura ofrojnë një sër shërbimesh për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në UMSH dhe vijnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj ⁵¹² . Strukturat në shërbim të studentëve nga hyrja në dalje, të informimit, trajnimit dhe mbështetjes në punësim janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe kjo konfirmohet edhe nga vetë studentët në takimin që u realizuar me ta.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve	Njësia Bazë ⁵¹³ , dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ⁵¹⁴ janë zyra të posaçme që mbulojnë shërbimet që ju nevojiten studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. UMSH-ja funksionon mbi një strategji të miratuar ⁵¹⁵ duke aplikuar dhe standartet më të lartë të informimit e transparencës ⁵¹⁶ . Megjithatë Zyra e

⁵⁰⁸ Evidenca 3. Organigrama.pdf; <https://www.umsh.edu.al/media/64590637c8d80.pdf>

⁵⁰⁹ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

⁵¹⁰ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf; Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf

⁵¹¹ <https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres>

⁵¹² <https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni>

⁵¹³ Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf

⁵¹⁴ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁵¹⁵ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

⁵¹⁶ <https://www.umsh.edu.al/>

dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës është përgjegjëse specifike për komunikimin, informimin, mbështetjen, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe vijnë bashkëpunimet e mëtejshme me ta përmes orientimit dhe këshimit të tyre me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjes. Ajo gjithashtu mbështet Këshillin Studentor dhe ofron udhëzime në lidhje me zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës ⁵¹⁷ , nëpërmjet sektorit të këshillimit të studentëve dhe atij të karrierës, i cili jo vetëm mban kontakte dhe krijon rrjetin alumni ⁵¹⁸ të UMSH-së, por organizon edhe aktivitetet dhe krijon bashkëpunimet e duhura për të diplomuarit e këtij institucioni. Punonjësit e kësaj zyre mirëpresin studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra ⁵¹⁹ është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Zyra ⁵²⁰ organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, ëorkshop-e, takime periodike për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Këto aktivitete ⁵²¹ orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura, lektorë të ftuar janë pjesë e promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e saj ⁵²² .
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ⁵²³ është një strukturë e ngritur, e cila funksionon në bazë të statutit të UMSH-së, që ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë orientimit të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të

⁵¹⁷ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁵¹⁸ <https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni>

⁵¹⁹ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁵²⁰ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁵²¹ Evidenca 47. Formular i Studentit Alumni.pdf

⁵²² Evidenca 19. Leksione të hapura DPS.pdf

⁵²³ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	punësimi, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektiv të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë vendos kontakte me Alumnit ⁵²⁴ e UMSH-së me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre e duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash ⁵²⁵ si dhe Ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme ⁵²⁶ .			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH-ja ka të sanksionuara procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Specifikisht procedurat për asistimin e studentëve të sanksionuara në rregulloret e institucionit janë orientuar tek Sektori i Kominikimit, Alumnit dhe Karrierës, i cili është duke vijuar punën, për orientimin dhe këshillimin e studentëve, ndaj GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni	Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm

⁵²⁴ Evidenca 47. Formular i Studentit Alumni.pdf

⁵²⁵ <https://www.umsh.edu.al/d/177/mbledhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private>

⁵²⁶ <https://www.umsh.edu.al/d/127/alumni>





harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit evidentojmë disa elementë të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si strukturë mbështetëse e UMSH-së. Institucioni ka miratur Njësien e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), e cila është një njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Kjo njësi përbëhet nga drejtuesi i zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve⁵²⁷. Metodologjia e punës së kësaj njësie bazohet në Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, Manualin e saj, Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Rregulloren e UMSH, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it⁵²⁸. Gjithashtu, institucioni ka hartuar edhe disa dokumente të tjera, të cilat qartësojnë dhe rritin procesin e cilësisë së mësimdhënies⁵²⁹.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka në vëmendje parësore sigurimin e cilësisë, realizon vlerësimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet dhe format që ofron, ndaj operon për rritjen e saj në bashkëpunim me Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave-NJSBCZHK. Me vlerësimin e programeve të studimit, përmes procedurave të qarta bëhet vlerësimi i cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor. Qëllimi kryesor është që të vlerësohet nëse programi i studimit i përgjigjet standardeve shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve të Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. NJSBCZHK është njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë, drejtuesi i zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Metodologjia e punës së kësaj njësie: Bazohet në Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, Manualin e saj, Ligjin e Arsimit

⁵²⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

⁵²⁸ Evidenca 34. Plani punes NJSBCZHK.pdf

⁵²⁹ Evidenca 24. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga studenti.pdf & Evidenca 28. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf & Evidenca 29. Plani i Monitorimit DPS.pdf




	të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Rregulloren e UMSH, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it. Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë⁵³⁰ synon kryesisht vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit (UMSH), vlerësimin të cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së studentëve, vlerësimin e cilësisë së personelit që për këto qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët dhe senati akademik⁵³¹. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i plotëson raportin e vlerësimin të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve, etj⁵³², një pjesë e të cilave bëhen publike në faqen web të institucionit.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë lidhur me këtë standard realizon çdo semestër, apo çdo fundviti akademik⁵³³, një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti⁵³⁴, trajtimi i ankesave të studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik si nga kolegët edhe nga drejtuesit⁵³⁵. Rezultatet e këtyre sondazheve iu vihen në dispozicion drejtuesit të IAL-së, të njësisë kryesore dhe përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe ai i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor

⁵³⁰ Evidenca 34. Plani punes NJSBCZHK.pdf

⁵³¹ Evidenca 28. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf & Evidenca 24. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga studenti.pdf

⁵³² <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>

⁵³³ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 77

⁵³⁴ Evidenca 24. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga studenti.pdf

⁵³⁵ Evidenca 28. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf; <https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor>

	metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët⁵³⁶. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlerësohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim⁵³⁷. Kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë⁵³⁸: drejtuesi i njësive emërohet dhe sjkarkohet nga Rektori, ndërsa anëtarë të tjerë të kësaj zyre janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave për programin e studimit janë transparente. Kuadri rregullator dhe politikat e institucionit⁵³⁹ në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Mekanizmat monitorues dhe kontrollues janë transparente dhe bëhen publike Gjithashtu GVJ duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar, informacioneve në faqen Web të institucionit, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të vlerësojë cilësinë, ta raportojë atë por dhe të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente⁵⁴⁰ dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e IAL-së. Raportet janë të pasqyruara në hapësirën e dedikuar sigurimit të cilësisë së UMSH-së, dhe vërtetohet periodiciteti⁵⁴¹.

⁵³⁶ Evidenca 30. Procedura e punes me focus grupet.pdf

⁵³⁷ <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>;
<https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>;

⁵³⁸ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵³⁹ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, neni 84

⁵⁴⁰ <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>;
<https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>;

⁵⁴¹ Shënime të mbajtura në vizitën në institucion

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Universiteti ka arritur të ngrerë një sërë mekanizmesh për të promovuar shembujt më të mirë të studentëve që kanë studiuar në programe të ndryshme studimi në UMSH. Për këtë është përdorur faqja e ëeb si dhe publikimet në media sociale dhe aktivitete që Departamenti ka realizuar. Në to paraqiten rastet e studentëve më ekselentë në programe të ndryshme studimi ⁵⁴² . Nga ana tjetër, institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupe përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni edhe për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Nga vizitat në institucion kërkuam të na vihej në dispozicion preiodiciteti i vlerësimeve, takimet apo mbledhjet e realizuara në departament për të adresuar problematikat e evidentuara dhe si ishin marrë masat dhe cila ishte situata aktuale; ku na u vunë në dispozicion materialet dhe përmirësimet e realizuara.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UMSH-ja ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave dhe ka ndërtuar një praktikë disavjeçare duke zhvilluar metodat e monitorimit dhe publikuar raportet e monitorimit në mënyrë periodike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në	Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë në zbatim të politikave të institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin ⁵⁴³ dhe rregulloren e institucionit ka ndërtuar disa element të dallueshëm lidhur me korrektësinë e

⁵⁴² <https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni>

⁵⁴³ Evidenca 3. Organigrama.pdf

përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë⁵⁴⁴ si strukturë mbështetëse e UMSH-së. Gjithashtu universiteti ka miratuar edhe planin e zhvillimit strategjik për zhvillimin sa më të strukturuar e transparent të tij⁵⁴⁵. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja e UMSH-së neni 28⁵⁴⁶, si dhe në të gjitha dokumentet e ASCAL-it
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Misioni i Universiteti Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit⁵⁴⁷. Filozofia e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, është ndërtimi i një komuniteti, mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës⁵⁴⁸. Plani strategjik i zhvillimit të UMSH-së evidenton se universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit⁵⁴⁹. UMSH ka ndërtuar strukturën përbërëse të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave dhe përgjegjësitë e saj, në nivel institucional, por jo në atë të njesisë kryesore⁵⁵⁰. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: - Senati Akademik - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK)⁵⁵¹. Ligji për Arsimin e Lartë përcakton krijimin e një Njësie për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e kërkesave arsimore dhe kjo njësi në këtë IAL është funksionale. Në nivele të tjera nuk ka njësi përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ndaj <i>GVJ sygjeron</i> që në politikat që ndjek e zbaton UMSH për sigurimin e cilësisë së brendshme të ndërtohen njësi edhe në nivel njësis kryesore

⁵⁴⁴ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 53 dhe 84

⁵⁴⁵ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

⁵⁴⁶ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵⁴⁷ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4

⁵⁴⁸ <https://www.umsh.edu.al/c/14/misioni-dhe-filozofia>

⁵⁴⁹ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

⁵⁵⁰ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 53 dhe 84

⁵⁵¹ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, Kreu XI




	(fakulteti) apo dhe në nivel njësie bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore (departamenti), si dhe të shihet mundësia e vlerësimit nga ekspertë të jashtëm për cilësinë e këtij programi studimi.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni ka aplikuar për (ri)akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë ⁵⁵² . Ka ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për përmbushjen dhe plotësimin e procedurave të akreditimit ⁵⁵³ . ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm ⁵⁵⁴ . Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion ⁵⁵⁵ , konstatohet se UMSH i ka kushtuar një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik dhe është duke i mbështetur ata me financime për avancimin në arritje me tituj e grada shkencore ⁵⁵⁶ . Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë ⁵⁵⁷ nëse është e nevojshme.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes organizimit të saj ⁵⁵⁸ të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin ⁵⁵⁹ përmes programeve të mobilitetit për stafin ⁵⁶⁰ dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët dhe senati akademik ⁵⁶¹ . Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ⁵⁶² ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit.

⁵⁵² Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Studime Psikosociale.pdf

⁵⁵³ Mendimi i Dekanit.pdf

⁵⁵⁴ <http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/arkivaview.php?id=41626> Urdhër Për përcaktimim e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë".

⁵⁵⁵ Shënime gjatë vizitës në institucion

⁵⁵⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore>

⁵⁵⁷ Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf

⁵⁵⁸ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

⁵⁵⁹ Evidenca 44. Strategjia e Ndekrombetarizimit.pdf

⁵⁶⁰ Evidenca 33. Levizja e stafit akademik.pdf

⁵⁶¹ Evidenca 29. Plani i Monitorimit DPS.pdf

⁵⁶² Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit SPS.pdf

	Në këto raport paraqiten të dhëna për veprimtaritë e kryera dhe aktivitete e vlerësuara nga NJSBCZHK për vitet respektive, analiza e këtyre veprimtarive, bashkëpunimet, vlerësimet e studentëve për pedagogët, etj ⁵⁶³			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë UAMSH harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, por për të rritur më tej cilësinë dhe duke pasur në komnsideratë ekperiencën disavjeçare të institucionet dhe të programit të studimit, janë kapacitetet e strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë për ndërtimin e strukturave respektive deri në nivel departamenti në mënyrë që të vijojë garantimi i rritjes së cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për	GVJ evidenton se komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, një komision që ngrihet e funksionon në nivel institucional dhe funksionon si organ kolegjal ⁵⁶⁴ , e përbërë nga 9 anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga secila prej njësive kryesore të Universitetit. NJSBCZHK në bashkëpunim me njësitë kryesore ngre grupe punë të cilat verifikojnë veprimtarinë mësimore, mësimdhënien e mësimnxënien ⁵⁶⁵ për lëndët që zhvilloheshin në programet e studimit. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, por edhe në një sër dokumentash që tregojnë anagazhimin e institucionit ⁵⁶⁶ në hartimin e një plani strategjik ⁵⁶⁷ , i cili bazohet në investimin në cilësinë e mësimdhënies, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara

⁵⁶³ <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>;

⁵⁶⁴ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵⁶⁵ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵⁶⁶ Evidenca 34. Plani punes NJSBCZHK.pdf

⁵⁶⁷ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	kombëtare dhe ndërkombëtare; në favorizimin e metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog; si dhe në krijimin e një modeli të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies. Në dokumentacionet e bëra publike në faqen zyrtare të institucionit (https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise) gjenden raportet periodike ku dokumentohet se rezultatet e vlerësimit dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Theksohet se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë⁵⁶⁸ përmes NJSBCZHK pas realizimit të procesit monitorues, i përcjell Rektorit dhe drejtuesve të tjerë të universitetit raportin me gjetjet. Gjithashtu përpilohet dhe formati i raportit pa të dhëna konfidenciale për publikimin e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit⁵⁶⁹. Ky raport hartohet pas aplikimit të disa instrumenteve, ku ndër të dhënat e zyrave përkatëse aplikohen dhe vlerësimi i pedagogëve nga studentët⁵⁷⁰, vlerësimi i pedagogut nga autoritetet drejtuese⁵⁷¹ si dhe fokus grupet përkatëse⁵⁷²; të gjitha sipas miratimeve të drejtuesve të IAL-së. Edhe plani i punës së NJSBCZHK⁵⁷³ miratohet nga Rektori në rang universitetit dhe Dekani në rang të aktiviteteve monitoruese të fakultetit. Këto raporte diskutohen deri në nivele departamenti, dhe aty mund të argumentohen dhe qartësohen disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve⁵⁷⁴; gjithashtu evidentohet se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, rezultatet e arritura të studentëve, marrëveshjet e

⁵⁶⁸ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵⁶⁹ <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>;

⁵⁷⁰ Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

⁵⁷¹ Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf

⁵⁷² Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf

⁵⁷³ Evidenca 34. Plani punës NJSBCZHK.pdf

⁵⁷⁴ ⁵⁷⁴ <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>;

<https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>;

<https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>;

	bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, etj.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion por dhe atë të aksesueshëm lehtësisht nga faqja Web e institucionit⁵⁷⁵ në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, IAL përdor metoda të drejtpërdrejta⁵⁷⁶, rishikim të raporteve të akreditimit të programeve të mëparshme⁵⁷⁷, shkrimi i raporteve të programeve të reja, raportet vjetore periodike të UMSH-së⁵⁷⁸. Grupi i punës në kryerjen e vlerësimit bazohet në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të syllabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve⁵⁷⁹, studentëve⁵⁸⁰ si dhe përmes vlerësimeve paralele⁵⁸¹ të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: Vëzhgime dhe dëgjime në auditor si gjatë kryerjes së procesit mësimor ashtu dhe gjatë testimeve, pyetësi i studentëve⁵⁸², mentorimet e studentëve, takimet në grup⁵⁸³ që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit. Për të realizuar vlerësimin e programit “Studime Psikosociale” përdoren disa metoda të drejtpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së programit e provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, apo në dokumentacionin e shqyrtuar në DVV konstaton se ndër metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshihen vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare⁵⁸⁴, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi,

⁵⁷⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

⁵⁷⁶ Evidenca-59-Mbi Organizimin e Tutorialit të Mentorimit në UAMD_.pdf

• ⁵⁷⁷ Bachelor në Studime Psikosociale me vendim Bordin Akreditimit Nr. 61/1 Dt. 05.10.2019.

⁵⁷⁸ <https://www.umsh.edu.al/media/64ba73a87246c.pdf>

⁵⁷⁹ Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

⁵⁸⁰ Evidenca 23. Model format teze.pdf

⁵⁸¹ Evidenca 29. Plani i Monitorimit DPS.pdf

⁵⁸² Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

⁵⁸³ Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf

⁵⁸⁴ Evidenca 15. Permbledhje e Tabelave.pdf

	kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendëshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	UMSH në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit “Studime Psikosociale” realizon çdo semestër një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti, relacioni për monitorimin e silabuseve, ankesat e studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik⁵⁸⁵. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët⁵⁸⁶, të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe fokus grupe. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuarve (alumni⁵⁸⁷), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet⁵⁸⁸ që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlerësohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim.
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se UMSH monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme programin e studimit “Studime Psikosociale”, në mënyrë periodike, duke garantuar kështu arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.</i>

⁵⁸⁵ Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf; Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf; Evidenca 45. Udhëzues për praktikant.pdf; Evidenca 47. Formular i Studentit Alumni.pdf; Evidenca 39. Aneksi A_vetëvlerësimi individual.pdf; Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf; Evidenca 19. Leksione të hapura DPS.pdf.

⁵⁸⁶ Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf

⁵⁸⁷ <https://www.umsh.edu.al/d/127/alumni>

⁵⁸⁸ <https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni arsimit të lartë, konform detyrimeve ligjore bën përpjekje që të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë ⁵⁸⁹ , kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit ⁵⁹⁰ . Nga informacioni i paraqitur në DVV dhe në raportin e GVB-së, si dhe në atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrevë të cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	UMSH është e angazhuar në ruajtjen e standardeve dhe cilësisë dhe në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, për këtë ajo bazohet tek indikatorët që përcillen nga njësitë, ku edhe NJSBCZHK ⁵⁹¹ ka si indikatorë parësorë monitorimin semestral dhe respektimin e Kalendarit Akademik; vlerësimin e pedagogut dhe lëndës nga studenti; fokus grupet e studentëve të të gjitha viteve dhe programeve, takimet me Këshillin studentor si dhe kontakti i vazhdueshëm me ta. Këta indikatorë përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve dhe cilësisë dhe gjithashtu miratohen nga rektorati si dhe zhvillohen në bazë të udhëzimeve të miratuara prej tij. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ të përfshirë nga institucioni për sigurimin e cilësisë bëhen të qarta në aktet rregullative të NJSBCZHK dhe udhëzimet për procese të caktuara. Individët dhe secila nga njësitë e angazhuar në Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka të përcaktuar përgjegjësitë sipas strukturës hierarkike organizative të UMSH-s, dhe udhëzimeve të Rektoratit, të cilët për procese të ndryshme vlerësimi

⁵⁸⁹ Evidenca 3. Organigrama.pdf; Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4, Neni 53 dhe 84; Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf; Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵⁹⁰ Evidenca 10. Lista e Marreveshjeve të bashkëpunimit.pdf

⁵⁹¹ <https://www.umsh.edu.al/media/64ba73a87246c.pdf>




	planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të cilësisë. GVJ konkludon se referuar planit të zhvillimit strategjik⁵⁹² dhe rregullores për funksionimin e brendshëm të cilësisë (NJSBCZHK) dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga informacioni i paraqitur në DVV dhe atë të siguruar në takimet gjatë vizitës në institucion, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në kuadrin rregullor⁵⁹³ të cilësisë.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit “Studime Psikosociale”⁵⁹⁴, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë, kjo sipas planit të punës⁵⁹⁵, i cili hartohet në nisjen e vitit akademik dhe planifikon aktivitete monitoruese e vlerësuese përgjatë gjithë vitit. Kështu nga analiza e raportit të fundit⁵⁹⁶ ne informohemi se është realizuar monitorimi i syllabuseve në të dy semestrat; monitorimi i takimeve të studentëve me tutorët akademik; njësia ka qenë prezente edhe në takimet me Këshillin studentor, nga i cili ka marrë shumë të dhëna mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor; monitorimi i procesit mësimor nga anëtari i NJSBCZHK si dhe dhe përgjegjësi i departamentit; në javën e 13-të të tyre është zhvilluar edhe vlerësimi i studentit për pedagogun dhe lëndën; realizimi i focus grupeve në fund të dy semestrave; Njësia ka kërkuar bashkëpunimin e përfaqësuesëve të studentëve për pjesëmarrje të lartë në takimet e tutoriatit si dhe sensibilizim të studentëve për të qenë sa më aktiv në jetën studentore. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmës akademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin. Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, administrativ, studentë, ata konfirmojnë se vetë ata realizojnë dhe janë pjesëmarrës në hartimin dhe plotësimin e pyetësorve

⁵⁹² Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

⁵⁹³ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4, Neni 53 dhe 84; Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf; Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28

⁵⁹⁴ Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit SPS.pdf

⁵⁹⁵ Evidenca 34. Plani punës NJSBCZHK.pdf

⁵⁹⁶ <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>

	dhe takime me studentët, ndërkohë që kjo evidentohet edhe në vlerësimin e strukturuar ⁵⁹⁷ .
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në vlerësimet kuadrit rregullator dhe të cilësisë së këtij institucioni, dhe takimeve të realizuara në institucion konfirmojmë se ky institucion respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, duke garantuar pjesëmarrje të drejtë dhe sigurisht duke ju mundësuar instrument të adresimit të shqetësimeve. Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit ⁵⁹⁸ nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Ky institucion i kushton vëmendje edhe diferencave gjinore ⁵⁹⁹ duke shprehur angazhim në shmangien e pabarazive dhe diskriminimit edhe në këtë fushë. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve të nivelit bachelor në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit Bachelor në “ Studime Psikosociale” janë punonjës të UMSH-së. Në përbërjen e GVB janë vetëm anëtar të brendshëm të departamentit ⁶⁰⁰ . Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët institucioni bashkëpunon është realizuar për procese të veçanta, siç janë aktivitetet dhe praktika e punës së institucionit ⁶⁰¹ , apo bashkëpunimet me universitete dhe kolegë të bashkëpunimeve të huaja, ⁶⁰²⁶⁰³ dhe kjo shihet si një mundësi e mirë e vlerësimit, por dhe e përmirësimit dhe përshtatsjes me kërkesat e bashkëpunëtorëve të huaj, duke mundësuar realizimin e vlerësimit tërësor të programeve nga ekspertë të jashtëm. Vijueshmëria e bashkëpunimeve shihet si një standard i cilësisë dhe marrja e mendimeve dhe e vlerësimeve nga ana e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë edhe të këtij programi studimi.
Konkluzione	<i>GVJ referuar aspektit të përfshirjes së njësitë akademike, personelit akademik e studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë së programit të studimit “Studime Psikosociale”, si dhe</i>

⁵⁹⁷ <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>;

⁵⁹⁸ Mendimi i Dekanit.pdf

⁵⁹⁹ <https://www.umsh.edu.al/media/654762b051791.pdf>

⁶⁰⁰ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Studime Psikosociale.pdf

⁶⁰¹ <https://www.umsh.edu.al/c/224/aktivitete-2023>

⁶⁰² Evidenca 10. Lista e Marreveshjeve të bashkëpunimit.pdf;

<https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore>

⁶⁰³ <https://www.umsh.edu.al/c/148/nderkombetarizimi>

	informomimit të palëve të interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe të drejtuara nga Kodi i Cilësisë ⁶⁰⁴ . Politikat e institucionit ⁶⁰⁵ në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm ⁶⁰⁶ . Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e UMSH-së ⁶⁰⁷ .
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB ⁶⁰⁸ , si dhe vizitës në institucion, konstaton se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raportet periodike janë transparente ⁶⁰⁹ dhe bëhen publike, dhe është lehtësisht e mundur që të evidentohen dhe të aksesohen raportet periodike në faqen eeb të UMSH-së, nga të gjithë të interesuarit. Raportet janë të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë, nuk evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi cënimin e lirisë për të dhënat

⁶⁰⁴ Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021

⁶⁰⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

⁶⁰⁶ Evidenca 34. Plani punes NJSBCZHK.pdf

⁶⁰⁷ <https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/645905eb0e8d7.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/61545848e58f6.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/60ab6e496a530.pdf>; <https://www.umsh.edu.al/media/60ab6e4969b1f.pdf>

⁶⁰⁸ <https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore> (kryesisht raportet vjetore institucionale)

⁶⁰⁹ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

	personale. <i>GVJ sygjeron që meqë ky program akreditohet për herë të dytë, të shihet mundësia e hartimit të raporteve të cilësisë vetëm për këtë program “Studime Psikosociale”, të jenë periodike dhe të shihet mundësia e publikimit të tyre, sigurisht duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që aktorët e interesuar të kanë mundësi të njihen me këto raporte.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstaton se UMSH sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit të përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e marra⁶¹⁰, mbështetur kjo në dokumentacionin e dorëzuar si RVB⁶¹¹ dhe gjatë vizitës në institucion. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar⁶¹². Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t’u fokusuar në evidentimet e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përsa i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mendojmë se mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë⁶¹³, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni⁶¹⁴ për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për	Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret⁶¹⁵ e UMSH-së dhe statuti⁶¹⁶, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (NJSBCZHK). Të gjitha këto struktura që

⁶¹⁰ Evidenca 26. Programi i Trajnimeve.pdf

⁶¹¹ Evidenca 29. Plani i Monitorimit DPS.pdf

⁶¹² <https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore> (kryesisht raportet vjetore institucionale)

⁶¹³ Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021

⁶¹⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

⁶¹⁵ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf; Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 28; Evidenca 3. Organigrama.pdf; Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4, Neni 53 dhe 84; Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf; Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit te programit SPS.pdf

⁶¹⁶ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4, Neni 53 dhe 84;

sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre, i ndajnë me strukturat e tjera me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit ⁶¹⁷ .			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në evidencat e mësipërme konstaton se UMSH-ja ka hartuar politika, procese dhe një sër veprimtarish për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë bërë publike, janë transparente në faqen web të institucionit dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁶¹⁷ Evidenca 34. Plani punes NJSBCZHK.pdf

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Studime Psikosociale" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë"

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe ofrimit të mundësive ndaj studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Rritja e ndërveprimeve dhe shumëfishimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në drejtim të praktikave profesionale të studentëve në një numër të gjerë fushash dhe drejtimesh edhe për këtë program studimi.
3. Abonimi në bibliotekat online dhe në platformat elektronike në funksion të procesit të mësimdhënies.
4. Klima pozitive në komunikimin midis stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi dhe mbështetja e tyre në një sër aktivitetesh ekstrakurrikulare.

Pika të dobta:

1. Personeli akademik i programit Bachelor në "Studime Psikosociale" edhe pse ka tituj akademikë dhe grade shkencore në përputhje me ligjet aktuale, megjithatë duke qenë nga profile të ndërmjetme, mund të ndodhin kufizime në ekspertizën e tyre në disiplinën e psiko-sociale, që mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave programore; (Standardi III 1 kriteri 4)
2. Literatura bazë për një pjesë të lëndëve mësimore është e aksesueshme nga studentët online apo pranë bibliotekës së njesisë kryesore në çdo kohë, por konstatohet se ajo nuk është e përditësuar si dhe ka mungesë të literaturës në këtë disiplinë. ; (Standardi II 3 kriteri 4)
3. Hartimi i një pjese të moduleve dhe lëndëve mësimore nga titullarë që i përkasin kategorisë Lektor i parë (Dr) dhe Asistent Lektor (Msc) mund të cënojë cilësinë në mësimdhënies, si dhe të hartohen kritere mbi përzgjedhjen e koordinorit të programit të studimit. ; (Standardi II 1 kriteri 2)

Rekomandime:

1. Përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë në një profil kualifikimi në psikologji, sociologji si dhe punë sociale në një raport të përafërt dhe kualifikimet e shkencave të tjera të jenë në raporte më të ulta. Kjo me qëllim që të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe shprehi pune tek studentët në linjë me profilin për të cilin po studiojnë.
2. Titullarët e angazhuar në hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor," në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë Ky fakt sugjerohet me qëllim që të ndihmojë në sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe në përmbushjen e detyrimeve ligjore për një kornizë akademike cilësore në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Studime Psikosociale" në UMSH.



3. Njësia bazë të rrisë vëmendjen në drejtim të monitorimit të syllabuseve mësimore duke treguar kujdes në mënyrën sesi harmonizohen temat mësimore të trajtuara në lëndë të ndryshme. Këto duhet të jenë në linjë me emërtimin e lëndës dhe fokusin e saj. Përdorimi i literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përditësuar të përfshijë disa element sigurie që ruajnë standardet e cilësisë së njohurive akademike që u ofrohen studentëve.
4. Të punohet mbi përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme si në elementët e planit mësimor të programit të studimit edhe në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve dhe moduleve të ofruara në programin e studimit me fokus drejt balancimit të fushës psikologjike me atë sociale.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Psychosocial Studies" provided by the Higher Education Institution "Mediterranean University of Albania"

Strengths and affirmations

1. Good practices undertaken by the institution in terms of involving academic staff and providing opportunities to students in national and international projects.
2. The increase of interactions and the multiplication of cooperation agreements in terms of professional practices of students in a wide number of fields and directions also for this study program.
3. Subscription to online libraries and electronic platforms in function of the teaching process.
4. Positive climate in communication between academic staff and students of this study program and their support in a series of extracurricular activities

Weaknesses

1. The academic staff of the Bachelor program in "Psychosocial Studies" even though they have academic titles and scientific degrees in accordance with current laws, however, being from intermediate profiles, limitations may occur in their expertise in the psycho-social discipline, which can affect the quality of teaching and the fulfillment of programmatic objectives.
2. The basic literature for a part of the teaching subjects is accessible by students online or at the library of the main unit at any time, but it is found that it is not updated and there is a lack of literature in this discipline.
3. The drafting and approving of a part of the modules and teaching subjects by holders belonging to the category of First Lecturer (Dr) may affect the quality of teaching.

Recommendation

1. The selection of the academic staff engaged in this study program should be based on a qualification profile in psychology and sociology and social work in an approximate ratio, and the qualifications of other sciences should be in lower ratios, in order to be




able to develop professional competencies and work habits in students in line with the profile for which they are studying.

2. Holders engaged in the drafting of syllabuses of teaching subjects must belong to the "Professor" category, in accordance with Law 80/2015 on Higher Education, to help ensure the high quality of teaching and fulfill of legal obligations for a quality academic framework in the first cycle bachelor's study program in "Psychosocial Studies" at UMSH. Also, the department must draw up criteria for the selection of the coordinator of the study program.
3. The basic unit should increase attention in the direction of monitoring the teaching syllabuses, showing care in how the teaching topics treated in different subjects are harmonized in line with the name of the subject and its focus, also the use of literature in Albanian and foreign languages, updated to include several security elements that maintain the quality standards of academic knowledge offered to students in social and psychological aspects.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (0 1) 222-43 423



Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



